

2023



Raporti Vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Tabela e përmbajtjes

I.	MESAZHI I TITULLARIT.....	4
II.	HYRJE.....	5
III.	KUADRI LIGJOR MBI BARAZINË DHE ANTIDISKRIMINIMIN	6
1.	Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.	6
	Instrumentet në kuadrin e OKB-së.....	6
	Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës	10
	Standardet e Bashkimit Evropian.....	11
2.	Kuadri Ligjor Shqiptar	13
3.	Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funkcionimin e KMD	27
	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative	27
	Zyra e KMD.....	28
	Kompetencat e Komisionerit.....	29
IV.	VEPRIMTARIA NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE PROMOVIMI I BARAZISË.....	31
1.	Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit	31
2.	Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	31
3.	Procedura e shqyrtimit të ankesave.....	31
	Çështjet e trajtuara nga KMD.....	35
	Ankuesit	36
	Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së).....	37
	Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive.....	38
	Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara.....	38
	Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.....	40
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.	41
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit	43
	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.....	44
	Gjuha e urrejtjes	44
4.	Vendimet sipas fushave, në të cilat janë paraqitur ankesat.	45
5.	Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve.....	46
	Vendimet e çështjeve me shkak racën	46
	Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar	47
	Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike.	48
	Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike	49

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore.	50
Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.....	51
Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.	52
Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.	53
Vendimet për konstatimin e formës së rëndë të diskriminimit dhe diskriminimit ndërsektorial.....	54
6. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara	55
7. Proçeset Gjyqësore.....	57
Pjesëmarrja e KMD në proçeset gjyqësore	57
Vendime Gjyqësore.....	59
8. Rekomandime të Kmd	72
Rekomandime për Akte Ligjore	72
9. Ndërgjegjësimi	77
Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media	77
10. Veprimtaria monitoruese e KMD.....	85
Projekte.....	85
Raportime të KMD.....	88
Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstucionale.....	90
KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë.....	91
Trajnime dhe Webinare.....	93
11. Programi i transparencës.....	95
V. ZYRAT RAJONALE	96
1. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë	96
2. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër	103
3. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier	110
VI. ASPEKTE TË SHËRBIMEVE	118
1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2023	118
2. Menaxhimi i burimeve financiare 2023	119

I. MESAZHI I TITULLARIT

Në muajin simbolikë të Marsit që korrespondon me Ditën Ndërkombëtare të Diskriminimit Zero, veshur me funksionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, po Ju dërgoj përmbledhjen vjetore të veprimtarisë së Institucionit e cila reflekton edhe gjëndjen e diskriminimit në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga përpjekjet e vazhdueshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe vullnetit pozitiv të treguar në përforcimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim garantimin sa më efektiv të Parimit të Barazisë dhe mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi individual dhe i strukturuar, uroj një vazhdimësi të përherëshme dhe të përditshme të këtij impenjimi të Kuvendit me të gjitha institucionet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sfidat janë të gjithanshme dhe kërkojnë një aktivizëm të të gjithë aktorëve publikë dhe shoqërorë në promovimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, si instrumente vitale në gëzimin me dinjitet të të gjitha të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventave Ndërkombëtare.

Shpreh besimin e plotë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjithë subjekteve në ndreqjen e pabarazive dhe luftën kundër diskriminimit, duke garantuar përfshirjen pa rezerva të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë sfidë dhe detyrë publike dhe qytetare.

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA

II. HYRJE

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Referuar nenit 26, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit, si dhe përgatit raporte mbi aktivitetet e 6 mujorit të parë të vitit të veprimtarisë institucionale.

Raporti përfshin analizë të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përgjithësi, si dhe puna e Komisionerit dhe Zyrës janë reflektuar me qëllim njohjen dhe informimin me veprimtarin konkrete të ushtruar, sipas fushës së kompetencës që mbulon.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Vlerësimet dhe Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2022”, janë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

III. KUADRI LIGJOR MBI BARAZINË DHE ANTIDISKRIMINIMIN

1. Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.

Ka standarde të shumta në këtë fushë të krijuara dhe zbatuara në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Bashkimit Evropian, të cilat mund të shërbejnë si bazë e dobishme për çdo vlerësim të pjesëve të kuadrit ligjor të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të instrumenteve të legjislacionit ndërkombëtar që merren me të drejtat e njeriut dhe pas ndalimit të instrumenteve të diskriminimit, Shqipëria i ka bërë ato pjesë të rendit të brendshëm ligjor.

Instrumentet në kuadrin e OKB-së

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, ndonëse ka karakter thjesht deklarativ, pra konsiderohet si një dokument “soft law”, ka një vlerë kolosale për formulimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, formulimin e ligjeve të çdo shteti, të politikave, veprimeve të autoriteteve dhe individëve si edhe vendimeve të gjykatave. DUDNJ, në nenin 1, nënvizon se: *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta ...”*. Neni 2/1 parashikon se secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Në nenin 7 kemi *“të drejtën për barazi përpara ligjit”*, ku parashikohet shprehimisht se: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ky pakt, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹, parashikon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë nga ligji, pa asnjë diskriminim. Ky pakt ka sanksionuar në përmbajtjen e tij se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin

¹ Ligji Nr. 7510 date 08.08.1991.

Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991². Ky pakt ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të garantuar ushtrimin e të drejtave të shprehura në të, pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes, ose ndonjë statusi tjetër.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³ (KDKPAK) është miratuar në 13 Dhjetor 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 3 Maj 2008. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012⁴. Bashkimi Evropian e ka ratifikuar këtë Konventë në Dhjetor të vitit 2010.

KDKPAK ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të.

Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë. Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Po kështu, kuadri kundër diskriminimit plotësohet edhe nga Nenet 6 dhe 7, që kanë të bëjnë me masat anti diskriminuese për fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁵ (CEDAW), u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 18 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981. Shqipëria ka ratifikuar CEDAW-n në vitin 1993⁶. Ndërsa Protokollin Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh., në vitin 2003⁷. Në preambulën e saj, Konventa ka përcaktuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit “*diskriminim ndaj grave*” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë,

² Ligji Nr. 7511 date 08.08.1991.

³ Convention on the Rights of Persons with Disabilities.

⁴ Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012.

⁵ Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women.

⁶ Ligji Nr. 1769, date 09.11.1993.

⁷ Ligji Nr. 9052, date 17.04.2003.

pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshejtimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t'i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t'u siguruar, mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa për dhunën dhe ngacmimin, 190, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me Ligjin Nr. 13/2022. Qëllimi i kësaj Konvente është të mbrojë punëtorët dhe personat e tjerë në botën e punës, duke përfshirë punonjësit, siç përcaktohen në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, si dhe personat që punojnë pavarësisht nga statusi i tyre kontraktues, personat në trajnim, duke përfshirë praktikantët dhe fillestarët, punëtorët, punësimi i të cilëve ka përfunduar, vullnetarë, punëkërkues dhe aplikantë për punë dhe individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat ose përgjegjësitë e një punëdhënësi. Kjo Konventë zbatohet për të gjithë sektorët, qoftë privatë apo publikë, si në ekonominë formale, edhe në atë joformale, dhe qoftë në zonat urbane apo rurale.

Me ratifikimin e saj shteti shqiptar, merr përsipër detyrimin për të miratuar ligje, rregullore dhe politika që garantojnë të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim në punësim dhe profesion, duke përfshirë për punëtoret femra, si dhe për punëtorët dhe personat e tjerë që i përkasin një ose më shumë grupeve të prekshme ose grupeve në situata të prekshmërisë që preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës. Njëkohësisht duhet të garantojë që dispozitat mbi dhunën dhe ngacmimin në ligjet, rregulloret dhe politikat kombëtare, marrin parasysh instrumentet e barazisë dhe mosdiskriminimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke përfshirë Konventën për Shpërblimin e Barabartë (Nr. 100) dhe Rekomandimin (Nr. 90), 1951 dhe Konventën për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesionet) (Nr. 111) dhe Rekomandimin (Nr. 111), 1958, si edhe instrumente të tjera përkatëse.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993⁸, ka përcaktuar në Preambulën e saj se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit*

⁸ Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993.

dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim”.

Sipas kësaj Konvente, “*diskriminimi racial*” nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërroje ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1).

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore.

Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj. (neni 5).

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)⁹, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989, ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992¹⁰.

Konventa garanton parimin e barazisë dhe përcakton detyrimin e shteteve pale që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij.

Gjithashtu, Konventa përmban edhe 2 Protokolle Opsional, të ratifikuar nga R.Sh. Protokollin Opsional i Konventës së OKB-së “Për Të Drejtat e Fëmijëve”, Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikte të Armatosur¹¹ dhe Protokollin Opsional i Konventës Së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve”, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë¹².

⁹Convention on the Rights of the Child.

¹⁰Ligji datë 27.02.1992.

¹¹Ratifikuar me Ligj Nr. 9833, datë 22.11.2007.

¹²Ratifikuar me Ligj Nr. 9834, datë 22.11.2007.

Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, legjislacioni për trajtimin e barabartë duhet të ndalojë diskriminimin, ngacmimin dhe viktimizimin për shkaqe të tilla, si gjinia ose seksi, origjina racore ose etnike, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha dhe feja ose besimi, midis të tjerash, të ofrojë të drejta të zbatueshme në këto fusha, dhe të krijojë struktura kombëtare për promovimin e barazisë.

Të njëjtat standarde identifikojnë që fusha e legjislacionit të trajtimit të barabartë mbulon më së shumti punësimin, trajnimin dhe formimin profesional, por mund të përfshijë gjithashtu edhe fusha jashtë punës, si aksesimi në mallra dhe shërbime, strehimi, arsimit, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor ose përparësi të tjera sociale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³ është nënshkruar në Romë me 4 Nëntor 1950 dhe hyri në fuqi me 3 Shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996¹⁴.

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, "*ndalimi i diskriminimit*", në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: "*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*". Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollet e saj shtesë.

Protokolli 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, i cili është ratifikuar nga Shqipëria në Nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 Prill 2005i, e zgjeron fushën e ndalimit të diskriminimit duke garantuar trajtim të barabartë lidhur me gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj (përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar).

Në nenin 1 "*ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit*", sanksionohet në mënyrë të shprehur se: "*Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*" dhe se "*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1*".

Karta Sociale Evropiane e rishikuar¹⁵, e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 2002, sanksionon parimin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit. Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe plotëson

¹³KEDNJ u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut.

¹⁴Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", i ndryshuar.

¹⁵Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002.

Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Karta Sociale Evropiane e rishikuar, e nënshkruar në vitin 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2002, po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 1999¹⁶, ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin e shteteve nënshkruese të kësaj Konvente për t'u garantuar personave që i përkasin pakicave, të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje¹⁷ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Qëllimi i kësaj konvente është të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; duke kontribuar ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimit të barazisë thelbësore midis burrave dhe grave; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përjasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje. Konventa garanton të drejtat themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin e grave nëpërmjet parashikimit të masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legislative, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legislative për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.

¹⁶Ligji Nr. 8496, date 03.06.1999.

¹⁷Ligji Nr. 104 date 11.08.2012 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje".

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) i dedikon një kre/titull të tërë "barazisë". Neni 20 parashikon barazinë përpara ligjit dhe Neni 21 i saj kërkon ndalimin e çdo diskriminimi për çdo shkak, të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinioni politik apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, moshë ose orientimi seksual.

Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

- Legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi).
- Legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyt me të drejtën e BE-së.
- Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

Neni 19 i **Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian** (TFEU) i ka mundësuar Bashkimit Evropian të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

- Direktivës 2000/43/KE "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike"; (Direktiva për racën)
- Direktivës 2000/78/KE "Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës"; (Direktivën për barazinë në punësim)
- Direktivave 2004/113/KE "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime"; 2006/54/KE "Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës" 2010/41/BE (Direktivat për barazinë gjinore).

Direktivat për Trajtim të Barabartë e Bashkimit Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim dhe profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fesë ose besimit dhe aftësisë së kufizuar; dhe në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.

Direktiva për Racën ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe **identiteti gjinor**.

2. Kuadri Ligjor Shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, në pjesën e dytë të saj, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta dhe liri janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”* dhe në nenin 18/2, *“Parimi i mosdiskriminimit”*, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”* dhe se *“Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*.

Në vitin 2016, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, një nga të cilët paraqet ndryshim në kompetencat e KMD. Konkretisht, është amendimi Kushtetutës i cili sanksionon të drejtën e KMD për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përmes Ligjit Nr. 76/2016, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”*, duke sanksionuar, në nenin 134, se: *“Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”*.

Ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010. Ky ligj erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përafëruar plotësisht me: Direktivën 2000/43/KE për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”*, Direktivën 2000/78/KE për *“Përcaktimin e një kuadri të 12 përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, Direktivën 2004/113/KE për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”* dhe

Direktivën 2006/54/KE për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji, është themeluar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shtrin kompetencat jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat. Në nenin 39, ligji ka parashikuar detyrimin e Këshillit të Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji. Ligji Nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, ka 9 vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tij dhe këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë¹⁸, ndalon çdo formë diskriminimi, të parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion. Neni 9/2, përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët¹⁹.

Përshtatja e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera, të përmendura në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar si detyrim për punëdhënësin. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim.

Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:

- a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë;
- b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritrajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë;

¹⁸Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar në vitin 2015.

¹⁹Ndryshuar me Ligjin Nr. 136/2015, datë 05.12.2015.

- c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;
- a) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga këto organizata.

Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, referojnë në ndjekjen e procedurave të ankimit, të përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion dhe në të gjitha procedurat e ankimit lidhur me sa më lart, zbatohet parimi i zhvendosjes së barrës së provës.

Në Kodin e Punës, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parashikohet edhe në dispozita të tjera si: Ndalimi i përdorimi të punës së detyruar si masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar (neni 8, prg. 2, germa (e); Barazia në shpërbllim (neni 115); Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme (neni 146) ku konkretisht parashikohet se: *“1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”;*

Ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesve të sindikatës (neni 181/3) dhe mos dhënia e pëlqimit nga përfaqësuesit e organizatës sindikale për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë (neni 181/4); Ndalimi i diskriminimit për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë (neni 197/4); Trajtimi i barabartë (neni 149/2) lidhur me përfundimin e kontratave me afat të caktuar, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të caktuar nuk mund të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, lidhur me kushtet e punësimit, trajnimit dhe mundësi të karrierës në punë. Punëmarrësit me kontratë pune me afat të caktuar gëzojnë të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht, si punëmarrësit me kontratë me afat të pacaktuar.”* etj.

Kodi Penal²⁰ ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2013 lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBTI. Konkretisht, Parlamenti shqiptar miratoi, si rrethanë rënduese për dënimin e një krimi, përfshirjen e orientimit seksual si shkak të ri, kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me këtë shkak, (neni 50/j). Konkretisht, është parashikuar se: *“Rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë: j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”*

Shkelja e barazisë së shtetasve (neni 253) parashikon dënimin e kryerjes për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve

²⁰Ndryshuar nga Ligji Nr. 144/2013; ndryshuar në vitin 2017.

të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji. Me amendimet e vitit 2013, u shtua orientimi seksual dhe identiteti gjinor²¹.

Dispozita në lidhje me nxitjen e urrejtjes ose grindjeve (neni 265) u ndryshua gjithashtu në vitin 2013 duke shtuar orientimin seksual si shkak të mbrojtur nga diskriminimi, si dhe duke zgjeruar fushëveprimin e tij me aktin e përhapjes dhe shpërndarjes së çdo përmbajtjeje që nxit urrejtje ose grindje. Sipas kësaj dispozite, *“Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”*. Nevoja për ndryshime në Kodin Penal është ende prezente, Komisioneri ndër vite ka rekomanduar heqjen e termit *“marrëdhënie homoseksuale”* që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale. Shprehja *“marrëdhënie homoseksuale”* përfshin si marrëdhëniet seksuale midis individëve të të njëjtës gjini ashtu edhe atyre të gjinive të ndryshme. Për këtë arsye, marrëdhënia juridike apo vlera shoqërore që kërkohet të mbrohet nga legjislacioni penal nëpërmjet këtyre veprave penale, garantohet më së miri pa referuar në përmbajtjen e neneve të mësipërme termin *“marrëdhënie homoseksuale”*.

Kodi i Familjes²². Statusi ligjor i një çifti lidhet me një sërë implikimesh ligjore në fusha të ndryshme të jetës. Në Shqipëri, martesat është ende e kufizuar tek një burrë dhe një grua të moshës 18 vjeç e sipër. Martesat e të njëjtit seks nuk janë ende të pranuar. Megjithatë, në jetën e përditshme, të drejtat që rrjedhin nga bashkëjetesa janë të rëndësishme për dhënien me qira të një banese, për kontratat e sigurimit, për përfitimet sociale etj. Megjithatë, bashkëjetesa në Kodin e Familjes që është në fuqi në Shqipëri, përkufizohet si një bashkim faktik midis një burri dhe një gruaje që jetojnë si çift, të cilët jetojnë përbashkërisht në një jetë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Kodi i Procedurave Administrative²³ parashikon si një nga parimet e përgjithshme parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 17), sipas të cilit: *“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë” dhe “3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”*.

Lidhur me mjetet e kërkimit të provës në kuadër të hetimit administrativ, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit (neni 82, paragrafi 2). Konkretisht, ky Kod ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit, duke sanksionuar

²¹Në këtë dispozitë janë shtuar fjalë, me Ligjin Nr. 144/2013, datë 02.05.2013.

²²Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligji Nr. 9062, miratuar në maj, 2003.

²³Miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, Fletore Zyrtare Nr. 87/2015.

shprehimisht se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Kodi i Procedurës Civile. Ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të miratuara përmes Ligjit Nr. 38/2017, datë 30.03.2017 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 98, datë 5 Maj 2017, kanë hyrë në fuqi në Nëntor 2017. KMD konstaton se edhe me këto ndryshime, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për të ndryshuar barrën provës gjatë procesit civil, në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me to, Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, në Kreun VI “Procedurat përpara gjykatës”, ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Bazuar në këto standarte, KMD në mënyrë të përsëritur ka dërguar rekomandime për zhvendosjen e barrës së provës në procesin civil, kur një çështje ka të bëjë me pretendim diskriminimi, të cilat nuk janë marrë parasysh. Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: “Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj”. Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t’ a kishte paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin prima facie -“në pamje të parë”²⁴, atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin privat, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Kodi i Procedurës Civile, duke qenë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë

²⁴ Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.

këtu Ligjin Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e bën problematike zbatimin e këtij standarti. Kështu, gjykatat gjenden midis kërkesave të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës, në përputhje me legjislacionin e BE, dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me Ligjin Nr. 37/2017, datë 30 Mars 2017, ka hyrë në fuqi me 1 Janar 2018. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta (neni 1).

Në Kreun II të Kodit parashikohen Parime të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku, ndër të tjerë, sanksionohet “*Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi*”, neni 11, i cili parashikon shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërore ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit”, dhe “2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni”.

Kështu, mbrojtja nga diskriminimi i çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit, garantohet për të gjitha shkaqet e diskriminimit të listuara me ligj por jo shteruese, ç’ka është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Gjithashtu, kjo mbrojtje garantohet për të gjitha format e diskriminimit, citohet në Kod, duke referuar në parashikimet e nenit 3 të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohen ato, sipas përkufizimeve përkatëse.

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, është miratuar në Shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në Qershor të vitit 2017.

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1).

Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.

2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
 3. **Barazia dhe mosdiskriminimi.**
 4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
 5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
 6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
 7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.
 8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
 9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
 10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
 11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, "parime të përgjithshme").
- Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuara (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).

Ligji Nr. 129/2021 "Për statusin "Fëmijë në përkujdesje të Republikës", rregullon kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit "*Fëmijë në përkujdesje të Republikës*", si dhe i të drejtave e përfitimeve që rrjedhin nga ky status.

Qëllimi i këtij ligji është marrja në mbrojtje dhe në përkujdesjen e shtetit të fëmijës, njëri ose të dy prindërit e të cilit apo, në mungesë të tyre, personi i ngarkuar ligjërisht me kujdestarinë e tij kanë humbur jetën në kushtet e përcaktuara nga Ligji "*Për statusin 'Dëshmor i Atdheut'*", në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike apo mbrojtjen e jetës së individit, si rezultat i një akti vetëmohimi ose patriotizmi, për shkak të plagëve të marra apo të sëmundjeve të shkaktuara si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore. Ky ligj garanton mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri", rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. (neni 1). Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë dhe të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të

eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet. (neni 2). Ndër të tjera, ky ligj bazohet edhe në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit.

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit: *“1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet”.*

Gjithashtu, ky ligj parashikon në pjesë të veçanta, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës; në arsim dhe kualifikim; dhe në media. Organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore, të parashikuar me këtë ligj bashkë me detyrat përkatëse janë: Këshilli i Ministrave; Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore; Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore (ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore); dhe organet e qeverisjes vendore.

Ligji Nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 32, pika dh), monitorimin e zbatimit e Ligjit Nr. 9970, datë 24.07.2008 *“Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”*.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”*, Konventën e Këshillit të Evropës, *“Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”* dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar me datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në Nëntor 2017.

Sipas objektit të tij, të parashikuar në nenin 1, ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me Ligjin Nr. 8496, datë 03.06.1999, dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të

pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. (neni 2, pika 1).

Në nenin 8, thuhet se:

1. *“Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare.*
2. *Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme:*
 - a) *për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;*
 - b) *për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;*
 - c) *për të forcuar dialogun ndërkulturor;*
 - d) *për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.*
3. *Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi”.*

Ky ligj parashikon gjithashtu njohjen e pakicave kombëtare, sipas një procedure të caktuar dhe liston të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në R.Sh. Bazuar në këtë ligj, është ngritur Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislationit në fuqi. Lidhur me këtë ligj janë miratuar vetëm një pjesë e akteve nënligjore, të parashikuara nga vetë Ligji. Mos miratimi i plotë i akteve nënligjore i bën disa nga segmentet e ligjit jo efektiv, duke lënë të pa zbatuara një numër të drejtash të rëndësishme të pakicave.

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Parimet e ndihmës juridike, sipas nenit 4 të këtij ligji, përcaktojnë se, dhënia e ndihmës juridike bazohet, ndër të tjera, në parime si: akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike; barazi dhe mosdiskriminim i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave vulnerabël.

Ky ligj, ka parashikuar, në nenin 11, kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas të cilit: Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror;

- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes.

Në këtë ligj jepen përkufizime të termave si “*Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara*”, “*Mohim i përshtatjes së arsyeshme*” apo edhe “*Përshtatje e arsyeshme*” të cilat janë në përputhje me përkufizimet e Ligjit Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Në nenin 4 përcaktohet shprehimisht se, parimet bazë të këtij ligji, janë, ndër të tjera: a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.

Në nenin 16, “*Monitorimi*”, paragrafi 2, parashikon se: “*Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.*

Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, sipas objektit të tij në nenin 2, përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të

shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në nenin 3 jepen përkufizimet, ku termi “*diskriminim*” përkufizohet në përputhje me Ligjin Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar. Ndër parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor parashikohet, sipas nenit 5/1, germa (a), trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

Neni 8 parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilit “*Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë*”.

Ky ligj është në përgjithësi në përputhje me nenin 25 dhe nene të tjera të KPDAK përsa i përket shërbimeve që parashikon për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përjashtim bën neni 9 që parashikon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe nenet 21-25 mbi trajtimin e pavullnetshëm, të cilat nuk janë në përputhje me KPDAK.

Ligji Nr. 7889/1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, parashikon se Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t’u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoz, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t’u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese (neni 2). Ky ligj parashikon disa lehtësi për individët që gëzojnë statusin e invalidit të punës, si: pajisjen me

- a) mjete lëvizëse përfshi edhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike.
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiake etj;

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas; Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas ndërsa udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 përqind të vlerës së biletës; Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar. Bazuar në nenin 1 të tij, përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesëshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë në kushte normale. Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta (neni 3).

Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar. Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. (neni 1). Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive (neni 3). Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes (neni 4). Edhe ky ligj parashikon disa lehtësi dhe përfitime për personat që gëzojnë këtë status.

Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;
- b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;
- c) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Ligji parashikon se një ndër parimet bazë, në bazë të të cilit funksionojnë programet e asistencës sociale është edhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (neni 1).

Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit e të përfitimit të të

drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij. (neni 2)

Ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (neni 3, pika 19).

Gjithashtu, ligji parashikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera, edhe parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj të fundit, në nenin 4 pika (ë) përcaktohet se, ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj Nr. 22/2018 “Për strehimin social”. Ky ligj është miratuar rishtazi në maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2018. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 10, ligji ka parashikuar parimin e mosdiskriminimit, si një ndër parimet e politikave të strehimit, duke theksuar shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2. Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t’i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.”

Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës. Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punë, janë përballur me situata diskriminuese.

Për këtë arsye, vlerësojmë se rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe “orientimin seksual”. Neni 5/1 ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor parauniversitar²⁵.

Në nenin 5, ku parashikohet e drejta për arsimim, thuhet shprehimisht se: “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.”

Ligji parashikon edhe parimet e përgjithshme, ku në Nenin 6/3, thuhet se: “Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”.

Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Sipas këtij ligji, të burgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. Të burgosurit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre kryhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtimi pa diskriminim i çdo forme për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh standardet e legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

²⁵ KMD, Raport i Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”

Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë transferimit dhe pas lirit.

Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, në nenin 32 parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42 paragrafi 3/b parashikon se komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual.

Gjithashtu, sipas Seksionit 4/10 të Kodit të Udhëzimeve Etike për Transmetimet Audiovizuale të miratuara nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), *informacioni i transmetimit nuk duhet të përmbajë përmbajtje diskriminuese në lidhje me shkaqe të tilla si raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, ose për ndonjë shkak tjetër.*

3. Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksonimin e KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin Nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15, datë 25 Shkurt 2010.

Në datë 15.10.2020, me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020, u miratuan ndryshimet ligjore në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi me 18 Nëntor 2020.

Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD ushtron kompetencat në tre sfera kryesore: (I) ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit përmes shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, vendosjes së sanksioneve administrative dhe pjesëmarrje në gjykatë për çështjet civile; (II) monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe (III) rritjen e ndërgjegjësimit.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.


Zyra e KMD

Bazuar në nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit. Me këtë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 4 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion deri në vitin 2018.

Me Vendimin Nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit”, KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Kompetencat e Komisionerit

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me organet e barazisë, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve.

Në këtë nen parashikohen, gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përfshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

- kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;
- monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe Ligjit “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Kompetenca të KMD-së që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

- adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- kontribuimin në raportimet dhe, sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

- nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

IV. VEPRIMTARIA NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE PROMOVIMI I BARAZISË

1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

- Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
- Pjesëmarrje e çështjeve të diskriminimit në gjykatë.

2. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë:

- Të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.
- Të bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues.
- Të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

3. Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese.

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar).

Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim, si dhe shpjegime dhe fakte që ankuesi disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar, si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri.

Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektive apo seanca dëgjimore mes palëve.

Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim brenda 90 ditëve dita e regjistrimit të ankesës. Nëse gjatë procedurës administrative është zhvilluar seancë dëgjimore, atëherë vendimmarrja e KMD zgjatet me 90 ditë të tjera.

Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.


Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik privat nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për çështjet me objekt gjuhën e urrejtjes, operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, detyrim ky i bërë me ndryshimet e LMD-së në vitin 2020.

Procedura e regjistrimit të ankesave

Gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2023 pranë Drejtorisë së Pritjes së Ankesave (në vijim DPA) janë verifikuar paraprakisht dhe më pas regjistruar 276 ankesa nga të cilat:


- 42 (dyzet e dy) janë paraqitur pranë DPA-së, duke u asistuar nga specialistët për plotësimin e formularit tip dhe dokumentacionit përkatës.
- 98 (nëntëdhjetë e tetë) kanë ardhur me postë dhe janë menaxhuar më tej nga DPA, duke i shqyrtuara paraprakisht dhe kontaktuar ankuesin, kur nevojitet plotësimi i dokumentacionit, apo sqarime e ndihmë në lidhje me rubrikat e formularit të ankesës.
- 58 (pesëdhjetë e tetë) kanë ardhur nga info@kmd.al, për të cilat është ndjekur e njëjta procedurë: shqyrtim paraprak për plotësim dokumentacioni dhe vijim i procedurës së regjistrimit²⁶.
- 29 (njëzet e nëntë) ankesa nga Zyra Rajonale Shkodër.
- 26 (njëzet e gjashtë) ankesa nga Zyra Rajonale Korçë
- 23 (njëzet e tre) ankesa nga Zyra Rajonale Fier.



Grafiku 1. Procedura e regjistrimit të ankesave të vitit 2023.

Bazuar në numrin total të ankesave të regjistruara nga DPA, rezulton se 28% e tyre kanë ardhur nga Zyrat Rajonale të KMD, që janë në varësi të kësaj drejtorie.

²⁶ Për çdo ankesë të regjistruar pranë DPA, ankuesit janë njoftuar me email ose telefon, duke i bërë me dije numrin e ankesës, datën dhe vijimin e mëtejshëm të procedurës në Drejtorinë e Hetimit Administrativ.



Grafiku 2. Zyrat Rajonale për vitit 2023.

Numri i çështjeve të referuara dhe ndërmejtësuar nga Zyrat Rajonale për zgjidhje në bashkëpunim me pushtetin lokal, OSHC-të dhe sektorin e biznesit zë 36% në raport me numrin e ankesave të këtij viti. Çështjet e adresuara kanë qenë në fushën e arsimit, shëndetësisë, strehimit, punësimit dhe shërbimeve online.

Nga numri total i ankesave (276) konstatohet se 7.08% janë shtetas migrantë brenda vendit (39), ndërsa 1.38% janë emigrantë. Një (1) shtetase e huaj ka qenë subjekt ankues kundrejt organeve shtetërore shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe kanë mbetur në pritje për t'u regjistruar 15 (pesëmbëdhjetë) ankesa, kjo për shkak se subjektet ankuese nuk i janë përgjigjur kërkesës për plotësim të dokumentacionit, ankesa të cilat më pas janë arkivuar.

Ianë përcjellë për kompetencë kundrejt institucioneve:

- Avokatit të Popullit, 6 ankesa.

Ianë dërguar për kompetencë nga institucionet kundrejt KMD-së:

- Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, 3 (tri) ankesa.


Stafi i DPA ka pritur 223 (dyqind e njëzet e tre) qytetarë të interesuar për të marrë informacion kryesisht:

- për mënyrën e ngritjes së një ankese pranë KMD;
- për t'u njohur me kriteret ligjore që duhen plotësuar për të paraqitur një ankesë;
- për vijimin e procedurës nga KMD deri në daljen e vendimit;
- për të marrë kontakt me inspektorin e çështjes, nëpunës të Drejtorisë Juridike apo/dhe drejtorive të tjera në KMD;
- për të rezervuar takim me titullarin e institucionit, etj.


Gjatë këtij viti janë pritur mesatarisht 780 (shtatëqind e tetëdhjetë) telefonata të ndryshme, kryesisht nga subjekte ankues, institucione publike ose private, si dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme të interesuar për marrjen e informacionit në kuadër të një ankese, plotësim të dokumentacionit, vijueshmërinë e saj nga Drejtoria e Hetimit Administrativ, apo rreth procedurave të ndjekura për çështjet në Gjykatë.

Çështjet e trajtuara²⁷ nga KMD

Në periudhën nga 1 Janar 2023 deri në 31 Dhjetor 2023, KMD ka trajtuar gjithsej 359 çështje, (344 ankesa dhe 15 çështje ex-officio). Nga këto, 280 çështje (276 ankesa dhe 4 çështje ex-officio) janë të regjistruara në vitin 2023 dhe 79 çështje (68 ankesa dhe 11 çështje ex-officio) janë të regjistruara nga viti 2022.



Grafiku 3. Çështje të vitit 2023.




Grafiku 4. Të dhëna krahasimore 2022-2023.

²⁷Çështjet e mbyllura me vendim dhe ato në proces gjatë vitit 2023.

Ankuesit


Mbështetur në nenin 32, pika 1, germat a dhe b, të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ankuesit janë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.

Nga 359 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2023, për **344 çështje** ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në **283 raste** ankesat janë paraqitur nga individë (235 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe 48 ankesa të regjistruara në vitin 2022), në **55 raste**, ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (36 ankesa të regjistruara në vitin 2023 dhe 19 ankesa të trashëguara në vitin 2022), në **6 raste** ankesat janë paraqitur nga grup personash (5 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe 1 ankesë e regjistruar në vitin 2022).




Grafikët 5 & 6. Ankesat e regjistruara sipas subjekteve ankuese.

Gjatë 2023, konstatohet një rënie e numrit të ankesave të organizatave me interesa legjitime, në krahasim me vitin 2022, por rezulton të ketë një rritje prej 79 ankesash të depozituara nga individ, krahasuar me një vit më parë. Organizatat me interesa legjitime, kryesisht gjatë vitit 2023, kanë paraqitur ankesa, të cilat kanë patur në objekt të tyre mbrojtjen e një kategorie të veçantë, si p.sh.: personat me aftësi të kufizuara apo pakicat e ndryshme kombëtare në Republikën e Shqipërisë.



Grafiku 7. Ankesat e paraqitura nga OJF për vitet 2019-2023.



Grafiku 8. Ndarja sipas subjekteve për çështjet e trajtuara gjatë vitit 2023.

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2023 përveç ankesave individuale, janë shqyrtuar edhe 55 ankesa nga organizata me interes legjitim (19 ankesa të regjistruara në vitin 2022 dhe 36 ankesa të regjistruara në vitin 2023). Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara, pakicave kombëtare Rome/Egjiptian, etj. Në çështjet e regjistruara gjatë vitit 2022, 12 ankues janë mbështetur nga OJF të ndryshme për të depozituar ankesë pranë KMD-së, ndërkohë që në vitin 2023, në 28 raste ankuesit janë asistuar nga organizata të shoqërisë civile, për të depozituar ankesë.


Gjithashtu, në disa raste informacioni i dhënë nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe medias, ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen e shqyrtimit kryesisht të çështjeve.

Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)

Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, gjatë vitit 2023, janë trajtuar gjithsej 15 çështje ex-officio, nga të cilat 11 çështje janë të regjistruara në vitin 2022. Gjatë vitit 2023, KMD ka filluar hetimin administrativ për 4 raste, pas marrjes së informacionit të besueshëm. 2 (dy) çështje janë shqyrtuar kryesisht nga KMD, në bazë të informacionit të marrë nga dy organizata të shoqërisë civile dhe 1 (një) është trajtuar mbështetur në informacionin e marrë nga media. Ndërkohë që, 1 (një) çështje është filluar kryesisht mbështetur në problematika të evidentuara nga vetë Komisioneri.

Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive

Gjatë vitit 2023, ka pasur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminimi, të paraqitura pranë KMD-së. Bashkitë, nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tiranë, Shkodër, Korçë, Durrës, Vlorë, etj. Është për tu theksuar fakti që gjatë vitit 2023, janë paraqitur ankesa edhe nga disa Bashki si p.sh.: Kolonjë dhe Dimal, nga të cilat Komisioneri nuk ka pasur ankesa më parë.



Grafiku 9. Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2023, sipas Bashkive.


Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 të tij, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.


Mbështetur në LMD, është parashikuar një listë e hapur shkaqesh, duke përfshirë dhe rastet për “çdo shkak tjetër”, duke patur parasysh se, **shkaku i mbrojtur** mund të jetë një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri, i cili nuk parashikohet shprehimisht nga neni 1, të LMD-së.

Gjatë vitit 2023, janë depozituar 101 ankesa, në raport me 100 ankesa të paraqitura gjatë 2022, në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi. Pra, shihet që pavarësisht rritjes së numrit të ankesave të depozituara gjatë vitit 2023, numri i ankesave në të cilat është pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi, ka mbetur thuajse i njëjtë.

Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe atyre të regjistruara në vitin 2022, të ndara sipas shkaqeve:



Grafiku 10. Shkaqet e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2023





Grafiku 11. Shkaqet e ankesave të regjistruara në vitin 2022

Gjatë vitit 2023 vazhdojnë të mbeten mbizotëruese pretendimet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, bindjeve politike, përkatësisë në një grup të veçantë, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike, racës, etnisë, moshës dhe gjendjes shëndetësore.


Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, ofron mbrojtje në 3 (tre) fusha: fusha e punësimit, fusha e arsimit dhe fusha e të mirave dhe shërbimeve. Gjatë vitit 2023, nga totali prej 359 çështje të trajtuara gjithsej, (344 ankesa dhe 15 çështje ex-officio), nga këto **14 çështje** në fushën e arsimit, **144 çështje në fushën e punësimit** dhe **201 çështje në fushën e të mirave dhe shërbimeve** (280 çështje të regjistruara në 2023 dhe 79 çështje të mbartura nga 2022).



Grafikët 12 & 13. Çështjet e trajtuara dhe të regjistruara gjatë vitit 2023, të ndara sipas fushave.


Gjatë vitit 2023, shpërndarja e çështjeve të trajtuara sipas 3 fushave, punësim, arsim, të mira shërbime, vazhdon të jetë e ngjashme me atë të vitit 2022, gjatë të cilit rezulton se, çështjet në fushën e arsimit zënë 3.9 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti me një rënie të lehtë prej 0.8 % krahasuar me vitin paraardhës, çështjet në fushën e punësimit zënë 40 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti me një zbritje të lehtë prej 7 % krahasuar me 2022, çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve zënë 56.1% të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti me një rritje të lehtë prej 7.8 % krahasuar me 2022.



Grafiku 14. Shpërndarja e çështjeve sipas fushave për vitet 2022-2023.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Numri total i çështjeve të trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve është **201**, nga të cilat 159 çështje janë regjistruar në vitin 2023 dhe 42 çështje të mbartura nga 2022. Në total 156 ankesa drejtohen kundër subjekteve publike dhe 48 ankesa drejtohen kundër subjekteve private. (në tre nga çështjet ankuesit janë drejtuar kundër më shumë se një subjekti). Raporti i ankesave drejtuar subjekteve publike dhe atyre private gjatë këtij viti vijon të jetë thuajse i njëjtë me vitin 2022.



Grafiku 15 & 16. Çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve, gjatë 2022 dhe 2023.

Nga 156 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 40 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 116 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.

Në krahasim me vitin 2022, shpërndarja e çështjeve në këtë fushë drejtuar pushtetit qendror dhe atij vendor nuk ka pësuar ndryshim thelbësor. Në vitin 2022, janë paraqitur 36 % e totalit të çështjeve kundër pushtetit qendror dhe 64 % kundër subjekteve publike vendore.

Gjatë vitit 2023, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 25.6 % të totalit të çështjeve në këtë fushë, ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 74.4% të totalit të çështjeve në këtë fushë. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 ka një zbritje prej 10 % të çështjeve që drejtohen kundër pushtetit qendror.

Ankesat e paraqitura në këtë fushë, kanë të bëjnë kryesisht me mos ofrimin e shërbimeve të nevojshme nga njësitë e qeverisjes vendore, si: trajtimi me strehim të përshtatshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; aksesueshmëria dhe mungesa e lehtësirave në linjat e transportit publik dhe privat; mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë etj.


Një pjesë e mirë e ankesave drejtohen edhe kundër institucioneve të administratës qendrore, ku objekti i ankesave konsiston në mosofrimin apo garantimin e një serie shërbimesh si, mungesa e medikamenteve në shërbimin shëndetësor, mos ofrimi i transportit publik qytetas pa pagesë, mos ofrimi i bursave për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë etj. Shkaqet kryesore, për të cilat janë paraqitur ankesat në fushën e shërbimeve kanë qenë: aftësia e kufizuar, raca dhe gjendja ekonomike.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.

Ankesat e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të depozituara si kundër institucioneve publike, ashtu edhe kundër subjekteve private. Objekti i ankesave të trajtuara në këtë fushë konsiston kryesisht në problematika të shfaqura rilidhur me aksesin në punësim dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Numri i përgjithshëm i ankesave, në fushën e punësimit, që janë trajtuar gjatë vitit 2023, është 144, nga të cilat 32 çështje të regjistruara gjatë vitit 2022 dhe 112 çështje të regjistruara në vitin 2023.

Nga të gjithë çështjet e trajtuara në këtë fushë gjatë vitit 2023, 107 çështje drejtohen kundër subjekteve publike dhe 37 të tilla kundër subjekteve private.



Grafiku 17. Çështjet në fushën e punësimit.

Krahasuar me vitin 2022, ku numri i çështjeve në këtë fushë kundër subjekteve publike ka qenë 104 ndërsa kundër subjekteve private 36, rezulton një shpërndarje e ngjashme në numër dhe përqindje, e çështjeve në këtë fushë midis subjekteve publike dhe atyre private, edhe gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 ka patur një rritje me 3 ankesa të totalit të çështjeve të kësaj fushe që drejtohen kundër subjekteve publike, dhe një rritje me 1 ankesë të numrit të çështjeve kundër sektorit privat.


Nga 107 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 40 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 67 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Ankesat e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt institucioneve të administratës publike, me objekt kundërshtimi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Në krahasim me vitin 2022, shpërndarja e çështjeve në këtë fushë drejtuar pushtetit qendror dhe atij vendor nuk ka pësuar ndryshime domethënëse. Në vitin 2022, janë paraqitur kundër pushtetit qendror 29 raste ose 27.9 % e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike dhe 75 raste kundër subjekteve publike vendore ose 72.1 % e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike.

Gjatë vitit 2023, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 37.4 % të totalit të çështjeve në këtë fushë, ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 62.6 % të totalit të çështjeve në këtë fushë. Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, gjendjen arsimore, përkatësinë në një grup të veçantë, aftësinë e kufizuar, etj.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 14 çështje, në fushën e arsimit, nga të cilat 5 çështje janë të regjistruara në vitin 2022 dhe 9 çështje janë të regjistruara gjatë vitit 2023. Në të gjitha çështjet e trajtuara në fushën e arsimit, ankuesit janë drejtuar kundër subjekteve publike, ndër të cilat në 7 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve qendrore të arsimit dhe në 7 raste kundër institucioneve vendore të arsimit.



Grafiku 18. Çështjet në fushën e arsimit.

Objekti i ankesave të paraqitura në fushën e arsimit ka qenë vendosja e kriterëve përjashtuese për një kategori studentësh nga institucionet e arsimit të lartë, vendosja e mësuesit ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara, përjashtimi nga pagesa e regjistrimit të fëmijëve të pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane në kopshte dhe çerdhe, etj. Shkaqet kryesore të pretenduara në këto ankesa janë aftësia e kufizuar, gjendja arsimore, gjendja ekonomike, raca, etj.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është anëtar për shkak të detyrës, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri ka përfunduar shqyrtimin e 8 çështjeve ku janë trajtuar problematikat e fëmijëve. Për këto 8 çështje, Komisioneri është shprehur si vijon:

- 1 vendim me konstatim diskriminimi. Problematika e kësaj ankese lidhet me përfitimin e bursës për të gjithë nxënësit, prindërit e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, me qëllim uljen e braktisjes shkollore.
- 3 vendime është konstatuar mosdiskriminim i subjekteve ankues.
- Në 4 raste, problematika e adresuar është zgjidhur gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës para Komisionerit dhe çështja është mbyllur pa një vendim përfundimtar pasi është arritur qëllimi për të cilin ishin paraqitur ankesat. Në këto raste problematika lidhet me faktin e caktimit të mësuesit ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara, përfitimin e bursës për të gjithë nxënësit, prindërit e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, etj.

Gjuha e urrejtjes.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri ka shqyrtuar në total 6 çështje me objekt përdorimin e gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 5 ankesa dhe 1 çështje ex-officio. Në 3 (tre) raste është pretenduar përdorimi i gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, në 1 (një) rast për shkak të gjinisë, në 1 (një) rast për shkak të vendbanimit dhe në 1 (një) rast për shkak të etnisë.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me vendim për 5 ankesa dhe 1 çështje ex-officio.

Komisioneri ka konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes në dy raste. Në një rast ka konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të gjinisë nga një person i cili merr pjesë aktive në jetën publike dhe atë televizive, për shkak se mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, ishin në tejkalim të lirisë së shprehjes.

Në një rast tjetër, Komisioneri konstatoi përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga ana e një person i cili merr pjesë në jetën publike të vendit. Përmes thirrjeve të bëra në rrjete sociale, ai kërkonte ndalimin e shfaqjes së një filmi për fëmijë në kinema, me arsyetimin se personazhet e tij ishin homoseksual dhe i mësonin atyre që të qenin të tillë u sjell pasoja të rënda psiko-sociale.

4. Vendimet sipas fushave, në të cilat janë paraqitur ankesat.

Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, KMD ka dhënë gjithsej **152 vendime dhe 2 rekomandime**²⁸, nga të cilat, 37 vendime dhe 2 rekomandime për çështjet e regjistruara në vitin 2022 dhe 117 vendime për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2023. Nga 154 vendimet e rekomandimet, 111 vendime dhe 1 rekomandim janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 41 vendime dhe 1 rekomandim janë dhënë kundër subjekteve private.

Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 26 raste, ndër të cilat 18 vendime kundër subjekteve publikë dhe 8 vendime kundër subjekteve private. KMD është shprehur gjithashtu me 25 vendime mosdiskriminimi, 59 vendime për mospranim të ankesës, 33 vendime për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore, 9 vendime për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri, si dhe janë dhënë dhe 2 Rekomandime.

Gjithashtu, është vendosur 1 sanksion me gjobë për shkak se subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar.

Në fushën e punësimit, KMD ka dhënë gjithsej **86 vendime**, nga të cilat, 24 vendime për çështjet e regjistruara në vitin 2022 dhe 62 vendime për çështje të regjistruara gjatë vitit 2023. 62 vendime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 24 vendime kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në **14 raste**, ku në **10 raste** kundër subjekteve publike dhe **4 raste** kundër subjekteve private. Në vendimet ku është konstatuar diskriminim dhe në pjesën më të madhe të tyre Komisioneri ka kërkuar nga subjektet përkatëse, rregullimin e situatave diskriminuese, si dhe rikthimin në punë të individit të diskriminuar. Komisioneri është shprehur me mosdiskriminim në **28 raste**, në **27 raste** është shprehur për mospranimin e ankesës, në **2 raste** është shprehur për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore, në **6 raste** është shprehur për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri, në **8 raste** Komisioneri është shprehur me vendim për pushimin e çështjeve, për shkak se subjektet ankuese i janë drejtuar organeve gjyqësore me ankim për diskriminim dhe janë dhënë 2 rekomandime, 1 në kuadër të një çështje të filluar kryesisht nga Komisioneri dhe 1 rekomandim në bashkëpunim me Avokatin e Popullit (jo në kuadër ankese).

Në fushën e arsimit, KMD ka dhënë gjithsej **7 vendime**, të cilat, janë të gjitha të drejtuara kundër subjekteve publike. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në **1 rast**. Komisioneri është shprehur me **2 vendime** mosdiskriminimi, **2 vendime** për mospranimin e ankesës dhe me **2 vendim** për ndërprerjen e procedurave, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore.

²⁸ Dy rekomandime të dhëna në kuadër të shqyrtimit të çështjeve ex-officio.


5. Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve²⁹

Vendimet e çështjeve me shkak racën³⁰

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 32 vendime, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi;
- 7 vendime mospranimi;
- 6 vendime mosdiskriminimi;
- 17 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.

Gjithashtu, është marrë edhe 1 sanksion me gjobë për shkak të moszbatimit të vendimit me diskriminim.



Grafiku 19. Vendimet e vitit 2023 me shkak racën

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, janë si vijojnë:

²⁹ Komisioneri shprehet me vendim për çështje ku pretendohet diskriminim për një ose më shumë shkaqe të përcaktuara në nenin 1, të LMD. Në këtë kontekst, Komisioneri shprehet në të njëjtin vendim, për 2 ose më shumë shkaqe diskriminimi. Për këtë arsye, numri total i vendimeve të miratuara nga KMD, mund të mos përputhet me numrin e vendimeve të dhëna sipas shkaqeve të raportuara në këtë pjesë të Raportit Vjetor.


³⁰ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 "Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash".

- Pamundësia e përdorimit të portalit e-albania, nga anëtarët e pakicave egjiptiane dhe atyre rome, për të marrë shërbime nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Mospërfitimi i bursave në arsimin parauniversitar publik, për familjet në nevojë dhe atyre që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri;
- Përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme në media ndaj anëtarëve të pakicave kombëtare në Shqipëri;

Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 61 vendime dhe 5 vendime me gjobë për moszbatim vendimi, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 19 vendime diskriminimi;
- 7 vendime mosdiskriminimi;
- 17 vendime mospranimi;
- 16 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.



Grafiku 20. Vendimet e vitit 2023 me shkak aftësinë e kufizuar

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:

- Mungesa e aksesueshmërisë në godina dhe ambiente ku ofrohen të mira dhe shërbime, si p.sh.: Zyrat e Postës Shqiptare, institucione kulturore apo arsimore, institucione private dhe rrugë apo trotuare;

- Aksesueshmëria dhe mungesa e lehtësirave në linjat e transportit publik dhe privat;
- Ankimi kundër vendimeve të KMCAp-së;
- Përfitimi i pagesës së invaliditetit;


Referuar subjekteve ankues në çështjet e shqyrtuara, rezulton se subjekti ankues është grua në 12 raste, në 22 raste subjekti ankues është burrë, në 26 raste subjektet ankues janë organizata me interesa legjitime dhe në 1 rast Komisioneri ka marrë informacionin nga ana e medias për të nisur shqyrtimin e çështjes me iniciativën e tij.

Vlen të theksohet fakti që numri më i lartë i vendimeve të mospranimit, ka ardhur si rezultat i ankesave me objekt jashtë kompetencave të Komisionerit, si p.sh: mos përfitimi i pagesës së invaliditetit për një diagnozë apo sëmundje të caktuar, etj.

Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 22 vendime për ankesat ku është pretenduar diskriminim për shkak të bindjes politike dhe 1 vendim me gjobë për moszbatimin e vendimit të dhënë nga KMD. Disa prej vendimeve të sipërpërmendura janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi;
- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 13 vendime mospranimi;
- 2 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.




Grafiku 21. Vendimet e vitit 2023 me shkak bindjen politike

Çështjet me pretendim diskriminimi për shkak të bindjes politike kanë konsistuar kryesisht problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione të administratës shtetërore qendrore ose vendore, për këtë shkak.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 23 vendime, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendim diskriminimi;
- 3 vendim mosdiskriminimi;
- 4 vendime mospranimi;
- 8 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 3 vendime për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështjet kanë qenë në proces në gjykatë.



Grafiku 22. Vendimet e vitit 2023 me shkak gjendjen ekonomike


Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, janë si vijojnë:

- Mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë, nga ana e institucioneve të pushtetit vendor;
- Vonesat në procesin e legalizimit të banesave të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, ku gjendja ekonomike ndërthuret me shkakun e racës;
- Braktisja e shkollës për shkak të gjendjes ekonomike.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 16 vendime për ankesat ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi;
- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendime mospranimi;
- 3 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.



Grafiku 23. Vendimet e vitit 2023 me shkak gjendjen shëndetësore


Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat drejtohen kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore, në fushën e punësimit dhe shërbimeve. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, janë si vijojnë:

- Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes shëndetësore;
- Përfitimi me rimbursim i medikamenteve për pacientë të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda;
- Përlllogaritje e masës së pensionit nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë, nga ana e institucioneve të pushtetit vendor.

Vendimet e çështjeve me shkak moshën.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 26 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të moshës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi;
- 12 vendime mosdiskriminimi;
- 4 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 9 vendime mospranimi.



Grafiku 24. Vendimet e vitit 2023 me shkak moshën


Çështjet me pretendim diskriminim për shkak të moshës kanë konsistuar kryesisht në problematika që lidhen me vendosjen e një moshe limit për të patur akses në punësim dhe profesion, largim nga puna për shkak të moshës, faturimit të lartë të energjisë elektrike dhe mospërfitimin e masës së plotë të pensionit të pleqërisë.

Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 26 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 2 vendime mospranimi;

- 13 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 6 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 1 vendim për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështjet kanë qenë në proces në gjykatë.



Grafiku 25. Vendimet e vitit 2023 me shkak përkatësinë në një grup të veçantë

Çështjet me pretendim diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë kanë konsistuar kryesisht në problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione private dhe të administratës shtetërore qendrore ose vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjet ku pretendohet diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, janë si vijojnë:


- Largimet nga puna nga ana e punëdhënësve, pikërisht pasi ata kanë marrë dijeni për veprimtarinë e ankuesve si pjesë e këtyre grupeve të veçanta, psh. qenia në një grupim sindikal në mbrojtje të të drejtave të punonjësve;
- Legalizimi i banesave për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë;
- Trajtimi i pafavorshëm i një grupi sportistësh nga ana e Federatës në të cilën bëjnë pjesë;
- Trajtimi i pafavorshëm i një grupi mjekësh nga ana e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 11 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjininë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi;

- 5 vendime mosdiskriminimi;
- 4 vendime mospranimi.



Grafiku 26. Vendimet e vitit 2023 me shkak gjininë


Pretendimet e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve lidhen kryesisht me diskriminimin në punësim dhe kryesisht:

- Largim nga puna për shkak të gjinisë;
- Trajtimi i pafavorshëm i punonjësve gjatë marrëdhënieve të punësimit;
- Trajtimin me strehim të përshtatshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Trajtimin e qytetarëve nga forcat e policisë gjatë marrjes së kallëzimeve penale;
- Përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri është shprehur me 58 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim në kuadër të termit “për çdo shkak tjetër”. Shumica e vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në çështjet respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 8 vendime diskriminimi;
- 12 vendime mosdiskriminimi;
- 3 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 33 vendime mospranimi;
- 2 vendim pushimi pasi çështja po trajtohet në gjykatë.



Grafiku 27. Vendimet e vitit 2023 për "çdo shkak tjetër"

Çështjet me pretendim diskriminimi për "çdo shkak tjetër" konsistojnë kryesisht në fushën e punësimit, në lidhje me trajtimin në vendin e punës dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, si pasojë e ankimeve ose denoncimeve kundër punëdhënësve, prononcimeve publike dhe qëndrimeve kritike të korrupsionit, të cilët në pjesën kryesore i përkasin punëdhënësve të sektorit publik.

Nga analiza e vendimeve të mospranimit të çështjeve me pretendim diskriminimi në kuadër të parashikimit për "çdo shkak tjetër", rezulton se këto çështje kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk i ka marrë ato në shqyrtim. LMD ka pajisur Komisionerin me kompetencën për të shqyrtuar ankesat me pretendim diskriminimi, sipas parashikimeve të këtij ligji. Sipas, LMD jo çdo pretendim për trajtim të pafavorshëm dhe të pabarabartë përbën diskriminim, por vetëm ato diferenca në trajtim që bazohen në një shkak që konsiderohet i mbrojtur sipas ligjit. Ankuesit i drejtohen Komisionerit duke pretenduar se sjellja e padrejtë që i janë nënshtruar përbën diskriminim, duke mos identifikuar asnjë shkak. Në mënyrë të vazhdueshme në vendimet e tij Komisioneri thekson se, çdo sjellje diskriminuese është një sjellje e paligjshme, por jo çdo pretendim për paligjshmëri përbën diskriminim, për sa kohë nuk bazohet në një shkak i cili konsiderohet shkak i mbrojtur sipas ligjit.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se rritja e numrit të ankesave, "për çdo shkak tjetër" pavarësisht numrit të vendimeve për mospranimin e tyre pasi kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD, për arsyet e mësipërme, tregon një rritje të besimit të qytetare tek institucioni i Komisionerit, të cilit i drejtohen për të zgjidhur problematikat e tyre.

Vendimet për konstatimin e formës së rëndë të diskriminimit dhe diskriminimit ndërsektorial.

Diskriminimi për më shumë se një shkak, gjen pasqyrim në disa forma diskriminimi të parashikuara nga LMD dhe konkretisht, diskriminimi ndërsektorial, diskriminimi i shumëfishtë, si dhe diskriminimi në formën e rëndë.

Gjatë vitit 2023, Komisioneri ka konstatuar në 2 raste, konsumimin e formës së rëndë të diskriminimit dhe në 5 raste diskriminim ndërsektorial, të cilat kryesisht kanë patur të bëjnë me konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak, kryesisht për shkaqet e gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në sindikatë, racës, gjendjes shëndetësore, gjendjes ekonomike dhe ankimit në gjykatë të punëmarrësit.

Këto forma diskriminimi janë konstatuar si rezultat i mungesës së aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuar në mjediset e zyrave postare, në fushën e punësimit si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, që kanë të bëjnë me garantimin e një strehimi të përshtatshëm nga ana e pushtetit vendor.

6. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, me regjistrimin e ankesës, Komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, kur e çmon të nevojshme, Komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.

Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit, ose ka patur mungesë të informacionit, që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që brenda 10 ditëve pune nga dita që ka marrë njoftimin të plotësojë kriteret e kërkuara nga KMD, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me përfaqësuesit e KMD-së, në Zyrat Rajonale të Korçës, Fierit dhe Shkodrës, si dhe organizatave të shoqërisë civile, subjekteve ankues u është ofruar asistencë, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2023, është shprehur me **244 Vendime, 3 Rekomandime**³¹ dhe **1 Rekomandim jo në kuadër ankese**. Nga këto, 60 vendime dhe 3 rekomandime për ankesa/çështje ex-officio të regjistruara në vitin 2022 dhe 184 vendime, për ankesa të depozituara apo çështje ex-officio të iniciuara gjatë periudhës së vitit 2023.

Vendimet e dhëna nga KMD, klasifikohen si më poshtë:

- 41 vendime konstatim diskriminimi;
- 55 vendime konstatim mosdiskriminimi;
- 88 vendime për mospranim të ankesës;
- 38 vendime për ndërprerje të procedurave të hetimit, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave;
- 15 vendime pushimi për shkak se ankuesi është tërhequr nga procedura hetimore;
- 7 vendime pushimi për shkak se po ndiqet në gjykatë;


³¹ Këtu nuk përfshihen vendimet me gjobë për moszbatim vendimi apo mosdhënie informacioni nga subjektet përkatës, vendimet për bashkim ankesash, si dhe vendimet e pezullimit;

- 3 Rekomandime për çështje ex-officio dhe 1 Rekomandim jo në kuadër ankese.

Për vitin 2023, Komisioneri është shprehur me 9 (nëntë) vendime gjobë, në vlerën 1.380.000 lekë, si vijojnë:

- për 8 vendime me gjobë për moszbatim të vendimit në themel të Komisionerit;
- për 1 vendim me gjobë kundër subjektit, që nuk ka dhënë informacion, pas kërkesës zyrtare së KMD-së.

Në total, numri i vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit për vitin 2023, është 257 vendime (ku përfshihen edhe 9 vendimet me gjobë).



Grafiku 28. Vendimet e dhëna gjatë vitit 2023

Për sa më sipër, vlen të theksohet se për vendimet me diskriminim të dhëna gjatë vitit 2023, subjektet kanë zbatuar masat e vendosura nga KMD për rregullimin e situatës diskriminuese për 4 vendime, 19 vendime janë dërguar në gjykatë, 12 vendime janë në proces zbatimi, për 2 vendime është vendosur sanksion me gjobë, ndërsa në 4 vendime Komisioneri ka konstatuar diskriminim por nuk ka urdhëruar masa për subjektin.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesave ka dërguar 665 kërkesa për informacion ndaj palëve në proces dhe në vijim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të ankesave, ka zhvilluar 5 inspektime dhe 118 seanca dëgjimore publike, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre.

Nga 41 ankese/çështje ex-officio, për të cilat, KMD është shprehur me vendime diskriminimi gjatë vitit 2023, për 35 prej tyre janë zhvilluar seanca dëgjimore, fakt që dëshmon mbi rëndësinë e zhvillimit të seancave të tilla, për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, përgjatë kryerjes së hetimit administrativ. Referuar subjekteve ankues, rezulton se subjekti ankues ka qenë grua në 12 vendime diskriminimi, në 15 vendime diskriminimi subjekti ankues ka qenë burrë dhe në 14 vendime diskriminimi subjektet ankues kanë qenë pakica kombëtare apo grup vulnerabel.

7. Proçeset Gjyqësore

Pjesëmarrja e KMD në proçeset gjyqësore

Pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në proçeset gjyqësore sipas Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e vendos institucionin në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar kompetenca sa i takon pjesëmarrjes në proçese gjyqësore. Pozicioni procedural i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në gjykatë, rezulton si vijon:

I. KMD si palë paditëse në gjykim: Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar se Komisioneri ka kompetencë të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive (neni 32, pika 1, germa (i) dhe 34, pika 4).

II. KMD si palë e paditur në gjykim: Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë akte administrative të cilat ankimohen në Gjykatën kompetente sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (neni 33 pika 18).

III. KMD si person i tretë/palë e interesuar në gjykim: Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon detyrimin e Gjykatës për të njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t’i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen. KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, në çështje ku kërkohet drejtpërdrejtë konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë.

IV. KMD si kërkues në Gjykatë, i drejtohet me kërkesë për lëshim Urdhri Ekzekutimi, me qëllim ndjekjen e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve me gjobë.

Statistikat për vitin 2023, të ndara sipas pozicionit procedural të KMD në proçeset gjyqësore, paraqiten si vijon:

Gjatë vitit 2023, KMD është thirrur në **58 (pesëdhjetë e tete) proçeset gjyqësore** krahasuar me **99 (nëntëdhjetë e nëntë) proçese gjyqësore** të komunikuara gjatë vitit 2022. Nga këto **58 (pesëdhjetë e tetë) proçese gjyqësore**, pozita procedurale e Komisionerit, paraqitet si më poshtë:


A. Palë e paditur në 30 (tridhjetë) procese gjyqësore, ku kërkohet shfuqizimi/pavlefshmëria e vendimeve të KMD-së, nga subjektet e gjetur në shkelje të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me vendim të KMD-së:

- Në **20(njëzet)** procese KMD është paditur nga persona juridik, lidhur me vendime ku është konstatuar diskriminimi;
- Në **1(një)** proces Komisioneri është paditur nga individë, lidhur me vendim ku është vendosur diskriminim.
- Në **1(një)** proces Komisioneri është paditur nga një person juridik për vendim gjobe.
- Në **1(një)** proces Komisioneri është paditur nga individ për konstatim diskriminimi.
- Në **3(tre)** procese Komisioneri është paditur nga individë, për shkak se ka konkluduar me vendim mospranim ankese.
- Në **3(tre)** procese Komisioneri është paditur nga individë, për shkak se ka konkluduar me vendim mosdiskriminimi.
- Në **1(një)** proces Komisioneri është paditur nga individë, për shkak se ka konkluduar me vendim pezullimi.

B. Person i interesuar/palë e tretë në 23 (Njëzet e tre) procese gjyqësore, ku KMD është thirrur në gjykim nga Gjykata kompetente, në çështje ku kërkohet dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë. Në këto çështje, KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, dhe parashtron mendim me shkrim për gjykatën, sipas përcaktimeve ligjore. Person i interesuar është thirrur si më poshtë:

- Në **6 (gjashtë)** procese ku kërkohet dëmshpërblim nga Gjykata, KMD ka dhënë mendim me shkrim dhe janë raste të trajtuara(vendim mosdiskriminimi, pushimi) nga Komisioneri
- Në **6 (gjashtë)** procese ku kërkohet dëmshpërblim nga Gjykata, KMD ka dhënë mendim me shkrim dhe janë raste të trajtuara me një vendim diskriminimi nga Komisioneri.
- Në **11(njëmbëdhjetë)** procese të drejtuara gjykatës, ku KMD ka dhënë mendim me shkrim, kanë të bëjnë me raste të pa trajtuara nga KMD.

C. Kërkues Komisioneri për titujt ekzekutiv (gjobat) në 5 (pesë) procese, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është drejtuar me kërkesë për lëshim Urdhri Ekzekutimi, me qëllim Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për të vijuar me procedurat përmbarimore.



Grafiku 29: Pjesëmarrja në proceset gjyqësore tre vitet e fundit.

Vendime Gjyqësore

Gjatë vitit 2023, Gjykatat kompetente ka dalë me **53 (pesëdhjetë e tre) vendime**, për çështje ku KMD ka qenë palë, në raport me **100 (njëqind) vendime** të komunikuara gjatë vitit 2022.

A. Nga 33 vendime të dhëna nga gjykatat kompetente ku Komisioneri ka qenë palë e paditur, me objekt shfuqizimin e vendimmarrjes së KMD-së, është vendosur si më poshtë:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka dhënë **28 vendime** duke vendosur:
 - 11 vendime për *rrëzimin e padisë*, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për konstatimin e diskriminimit;
 - 5 vendime për *pranimin e padisë*, duke rrëzuar vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
 - 2 vendime për pranim të *pjes'shëm të padisë*, duke lënë diskriminimin e konstatuar në fuqi dhe duke rrëzuar vendimin KMD-së për rikthim në vendin e punës.
 - 5 vendime për *mospranim* padie;
 - 1 vendim për *kthimin e padisë* pa veprim
 - 1 vendim *pezullimi*.
 - 1 vendim *moskompetence*.
 - 1 vendim *për rrëzim sigurim padie*.
 - 1 vendim *pushimi çështje*.
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër **1 vendim**:
 - 1 vendim pushimi padie.

3. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **2 vendime** për lënien në fuqi të vendimit Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, duke lënë në fuqi vendimet e shkallës së pare, duke lene në fuqi vendimet e diskriminimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4. Gjykata e Lartë, ka dhënë **2 vendime**:

- Mospranim rekursi

B. Në 16 vendime të dhëna nga gjykatat kompetente ku Komisioneri ka qenë palë e tretë me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, Gjykata ka marrë vendimet si më poshtë:

1. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore kanë dhënë **7 vendime**, duke vendosur:

- vendime për rrëzimin e padisë
- 1 vendim për pranimin pjesëshëm të padisë
- 1 vendim për pushimin e gjykimit të çështjes civile
- 1 vendim moskompetence
- 1 vendim për pezullimin e gjykimit të çështjes derisa Gjykata Administrative e Apelit të shprehet me vendim të formës së prerë për vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë dhënë **5 vendime**, duke vendosur:

- 1 vendim për rrëzimin e padisë
- 1 vendim jo themeli (caktim ekspertesh)
- 1 vendim pranim i pjesëshëm.
- 1 moskompetence
- 1 vendim për *mosndreqje gabimi*.

3. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **1 vendim**, duke vendosur:

- 1 vendim i formës së prerë i Gjykatës Administrative të Apelit për pranimin e padisë dhe dëmshpërblimin pasuror në vlerën 1.000.000 lek.

4. Gjykata e Apelit ka dhënë **2 vendime**, duke vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke vendosur pranim e padisë për dëmshpërblim.
- Prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim.

5. Gjykatat e Lartë ka dhënë **1 vendim**, duke vendosur:

- 1 vendim për mospranim rekursi, ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ i cili vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.


Shënim: Totali i vlerës së dëmshpërblimit të dhënë për vitin 2023 nga gjykatat kompetente, si pasojë e diskriminimit të konstatuar, është përafërsisht 17.600.000 Lekë, nga kjo vlerë, vlera e dëmshpërblimit e dhënë me vendim të formës së prerë është 4.600.000 lekë.

C. Në 5 vendime të dhëna nga Gjykata ku KMD ka qenë kërkues me objekt lëshim urdhri ekzekutimi për titujt ekzekutive të KMD-së Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka marrë vendimet si më poshtë:

- Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendimin Nr. 182 datë 12.09.2023 (Debitor Bashkia Vorë)
- Lëshim Urdhri Ekzekutimi për titullin ekzekutiv vendimin Nr. 230 datë 22.12.2022 i KMD-se (Debitor Posta Shqipare sh.a).
- Lëshimin e UE për titullin ekzekutiv, Vendim gjobe Nr. 228 datë 22.12.2022 i KMD-së (Debitor Posta Shqipare sh.a).
- Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit të titullit ekzekutiv Vendimit Nr. 130 date 31.08.2016 te KMD-se (Debitor Drejtoria E Përgjithshme e Tatimeve)
- Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendimin Nr. 184 datë 30.09.2022 të KMD-së (Debitor Individ A.M).

Dëmshpërblimet e dhëna nga Gjykatat për rastet e diskriminimit.


Për vitin 2023 Gjykatat kanë akorduar për diskriminimin e konstatuar dëmshpërblim në vlerën 13.988.050 lek³². Dëmshpërblimet në vlerë monetare të dhëna nga Gjykatat në rastet e konstatimit të diskriminimit paraqitet në tabelat më poshtë³³:



Grafiku 30: Dëmshpërblimit tre vitet e fundit të akorduara nga Gjykatat.

³² Nga kjo shumë (per vitin 2023) afërsisht 4.600.000 janë me vendim të formës së prerë.

³³ Në këto tabela paraqiten vetëm vlerat fiske të përlogaritura nga Gjykatat në vendime gjyqësore, pasi ka raste kur gjykata pr diskriminimin e konstatuar shprehet edhe me forma te tjera dëmshpërblimi.



Grafiku 31: Dëshmipërblimet e akorduara nga Gjykatat kundrejt llojit të subjektit

Arsyet e shfuqizimit të vendimeve të KMD-së nga Gjykata

Arsyet e shfuqizimit të vendimeve të KMD-së (të komunikuar gjatë vitit 2023):

- Vendim Nr. 2210 datë 25.07.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë** (pranim padie): "... KMD duhet të kishte bërë një hetim më të thelluar, në referim të nenit 33, pika 7/2 të Ligjit Nr. 10 221/2010 ... Pra, Komisioneri, në kuadër të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, për të arritur në një vendim-marrje të drejtë, mund të kishte kërkuar mendim të specializuar me ekspertë të fushës, për të përcaktuar nëse, referuar rrethanave të vecanta që e karakterizojnë znj. Fjona Zeneli, kjo e fundit mund të ndiqte Shkollën në degën e kërkuar (Përpunim druri), pa asistencën e një mësuesi ndihmës, duke pasur në konsideratë dhe specifikat e praktikës profesionale ... referuar kompetencave që iu njeh legjislacioni në fuqi, iu takon organeve eprore të Shkollës, që të marrin masa konkrete për garantimin e aksesit në shkollat profesionale të personave me aftësi të kufizuara, qoftë duke miratuar aktet nënligjore siç ligjvënësi i ka ngarkuar, qoftë me shtimin e organikës me mësues ndihmës ... ndaj një shtetasi me aftësi të kufizuar, garantimi i të drejtës për arsim ... nuk mund të prevojë ndaj mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së personit."
- Vendim Nr. 1405 datë 05.06.2023 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë** (pranim i pjesshëm): "... Gjykata çmon se nuk është në kompetencën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masa për rregullimin e pasojave të diskriminimit për shkak të punësimit, për rikthimin e punëmarrësit në vendin e mëparshëm të punës dhe të të drejtave dhe privilegjeve që gëzon punëmarrësi viktimë e diskriminimit ...".

- **Vendim Nr. 1543, datë 13.06.2023 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë** nuk e ka vlerësuar drejtë vendim-marrjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke arsyetuar, ndër të tjera, se:

“ ...Gjykata ka vlerësuar se procesverballi i konstatimit të dëmit nuk është një akt zyrtar që duhet të miratojë pretendimet e të dëmtuarve për vlerësimin e dëmeve, por përpilohet në mënyrë të paanshme nga Komisioni i ngritur për të verifikuar vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesën e të dëmtuarit. Ndyshimet që mund të konstatohen nga kërkesa e të dëmtuarit me faktet e verifikuara në procesverbal nuk mund të paragjykojnë vërtetësinë e fakteve të pasqyruara në procesverbal. Në rastet kur i dëmtuari pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme duke mos pasqyruar të gjitha dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia, duhet domosdoshmerisht të provojë ekzistencën e të paktën njërit prej tyre.

Në rastin në gjykim KMD-ja është mjaftuar vetëm me kundërshtimin e ankuesit z. Seitaj ndaj përmbajtjes së procesverbalit, por nuk ka hetuar se konkretisht çfare dëmi të vërtetuar nuk është përfshirë në procesverbalin e konstatimit. Për këtë çështje KMD nuk mund ti kalojë barrën e provës Bashkisë Fier, sepse Komisionit të ngritur të kësaj Bashkie nuk mund ti kërkohej të vërtetojë KMD-së se banesës së djegur nuk i janë shkaktuar dëme të tjera përveç atyre të pasqyruara në procesverbal, sepse të mirat materiale që ndodheshin në banesë mund ti dijë vetëm ai që ka banuar në të dhe për rrjedhojë ka barrën e provës për të vërtetuar ekzistencën e tyre në kohën e rënies së zjarrit.

Përsa i përket argumentit tjetër të KMD-së se Komisioni i Bashkisë Fier duhet të kishte mbajtur procesverbalin e konstatimit të dëmit për vetë znj. Luljeta Seitaj, Gjykata vlerëson se kjo është një çështje që i përket znj. Luleta Seitaj dhe KMD nuk mund të konstatojë kryesisht trajtime të pafavorshme pa ankimin paraprak të personit të interesuar... Nga aktet e dosjes gjyqesore rezulton se z. Seitaj është ankuar në KMD për mos përfitimin e dëmshpërblimit financiar për materialet dhe objektet e shkatërruara nga zjarr, për të cilat vetë KMD gjykoi se nuk ka trajtim të diferencuar dhe është ankuar për mospasqyrim e të gjitha dëmeve në procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Emergjencave Civile për të cilën gjykat arsyetoi me lart se ndodhemipërpara një trajtimi diskriminues nga Bashkia Fier.

- **Vendimi Nr. 3432, datë 22.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë** ka arsyetuar se: “Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se kontrata e lidhur midis Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, dhe K.F. është e lidhur me vullnetin e plotë të palëve, çka do të thotë se para nënshkrimit të kësaj kontrate, secilëve prej palëve u janë bërë të qarta të drejtat dhe detyrimet që buronin nga kjo kontratë, ku ndërmjet të tjerave, në nenin 4 (të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Mbrojtjes), Ministria e Mbrojtjes nuk garanton asnjë lloj trajtimi financiar për studenët jashtë radhëve të FA-së, të cilët do të ndjekin specializimin afatgjatë në fushën e mjekësisë, për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes.”

“...sipas kategorive të lidhura nga secili nga specialistët me Ministrinë e Mbrojtjes, specialistët që vijnë nga radhët e FA, me përfundimin e studimeve, janë të lidhur me detyrimin

për të shërbyer si mjek në strukturat e FA, për të paktën 6 (gjashtë) vjet. Ndërsa, specializantët që nuk vijnë nga radhët e FA, sikurse ankuesja K.F, me përfundimin e studimeve, nuk është e lidhur me detyrimin për të shërbyer si mjek në FA, çka do të thotë se, me përfundimin e studimeve ajo është e lirë që të zgjedhë të punojë ku të dojë, pa asnjë lloj penalizimi. Duhet theksuar se, i njejti model kontrate, që nuk parashikon detyrimin për trajtim financiar për specializantët civil, janë miratuar edhe nga Ministria e Brendshme, për kuota që mbulohen nga kjo ministri, për specializantët jashtë radhëve të Ministrisë së Brendshme. Sa më sipër, për shkak të klauzolave të ndryshme të kontratave për personelin ushtarak/civil të FA-së, dhe të kontratave për kategorinë e civilëve jashtë radhëve të FA-së, Gjykata vlerëson së ankuesja K.F. si pjesë e kategorisë së studentëve specializantë, jashtë radhëve të FA-së, nuk është në kushte të ngjashme me kategorinë e studentëve specializantë të cilët vijnë nga radhët e FA-së, gjatë ndjekjes së specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në kuadër të kuotave të mbuluara nga MM dhe, për rrjedhojë nuk kemi trajtim të pabarabartë dhe të pafavorshëm, për ankuesen K.F. nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, në raport me specializantët e tjerë nga radhët e FA-së dhe për pasojë as diskriminim sipas parashikimeve të LMD. ”.

- **Vendimi nr. 1300, datë 26.05.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**, ka arsyetuar se: “Nuk provohet që seanca e planifikuar për tu zhvilluar me datë ..., ora ...të jetë zhvilluar. Normalisht pala e paditur që zhvillonte procedimin duhet të kishte çelur seancën në datën dhe oren e caktuar, të relatonte kërkesat procedurale të paditësit dhe të shprehej mbi arsyet përse këto kërkesa nuk merren parasysh, po kështu të relatonte dhe qëndrimin dhe provat në lidhje me themelin e çështjes, të paraqitura nga paditësi, ato të siguruara nga pala e paditur apo të paraqitura nga të tretët. Ky qëndrim i palës së paditur përbën shkelje procedurale. Gjykata çmon se kushtet kur procedimi kishte nisur kryesisht nga pala e paditur, kjo e fundit duhet të merrte masa të zhvillonte një proces të rregullt, ku ti jepte mundësi paditësit të paraqitet dhe të mbrohet efektivisht vetë apo nëpërmjet përfaqësuesit. Data e seancës dëgjimore i është komunikuar paditësit me e-mail-in e datës..., pra koha efektive në dispozicion ka qenë vetëm një javë, ndërkohë që paditësi ka bërë me dije se ka qenë i angazhuar në aktivitetet klerikale rrjedhimisht ky fakt duhet të ishte vlerësuar nga pala e paditur, duke i lënë kohë shtesë dhe duke caktuar një datë tjetër për seancë dëgjimore.”.

Gjykata i gjen të bazuara kërkesat e përsëritura të paditësit për të bërë bashkimin e dy procedimeve, konkretisht atij të filluar më parë mbi ankesën e Aleancës LGBT me procedimin e filluar më pas kryesisht nga pala e paditur, meqenëse kishin për bazë të njejtat argumenta dhe shkak ligjor të pretenduar të cënuar... Duke vendosur bashkimin e këtyre procedimeve në një të vetëm, duke zhvilluar një hetim të plotë dhe objektiv, bazuar në parimin e kontradiktoritetit, duke iu garantuar palëve pjesëmarrëse të drejtat bazë të një procesi të rregullt ligjor si ajo për të marrë pjesë në procedim, dëgjuar, mbrojtur etj, në këtë mënyrë pala e paditur do të garantonte një zgjidhje më efektive për këtë çështje, për më tepër kur ajo po bëhej çdo ditë e më sensitive... Procedimet janë zhvilluar në të njëjtën kohë dhe pala e paditur ka dalë me dy akte të ndryshme me një distancë kohore një ditore. Këto situata duhet të vlerësoheshin nga pala e paditur në drejtim të bashkimit të këtyre procedimeve përse kohë që bëhej fjalë për diskutime në publik, mes të njejtave subjekte dhe rreth të njejtës kauz, pra për të përcaktuar natyrën e tyre diskriminuese ose jo, duhej

analizuar dhe konteksti, kur e si janë thënë, në vijimësi, jo të shkëputura në procedime të ndara. Bashkimi i procedimeve dhe shqyrtimi i tyre në një të vetëm, duke u garantuar palëve pjesëmarrëse të gjitha të drejtat në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, do t'i shërbente zgjidhjes së drejtë në themel të çështjes dhe rrjedhimisht mund të kishte dhe efekt parandalues për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen mes palëve."

Gjykata ka arsyetuar se: "... për sa kohë që procedimi ka nisur kryesisht nga organi publik në lidhje e deklaratat e bëra nga paditësi në drejtim të komunitetit LGBTI, pala e paditur duhet që, në referim të nenit 33/3 të KPA siperciturar të therriste në cilësinë e palës së interesuar në proces përfaqësues të këtij komuniteti dhe që është person juridik (OJF) Aleanca LGBT." ...

... "rezulton se procedimi ka filluar kryesisht nga pala e paditur në bazë të këtyre deklarimeve të bëra nga paditësi si i ftuar në emisione televiziv dhe radiofonik, thelbi i hetimit administrativ ka qenë përmbajtja e tyre dhe vendimmarrja objekt gjykimi u referohet këtyre deklarimeve.... I gjithë debati gjyqësor u zhvillua në lidhje me saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre regjistrimeve. Gjykata çmon se, pala e paditur duhet t'i ishte drejtuar me shkresë që në fillim të procedimit administrativ këtyre mediave dhe të merrte materialin e regjistruar të plotë. Po kështu, duhet të vijohet më pas me transkriptimin e plotë të tyre, pasi përcaktimi i natyrës diskriminuese ose jo të këtyre deklarimeve nuk mund të ishte vetëm objekt analize i fjalëve apo fjalive të veçanta që mund të ketë thënë paditësi, por edhe i kontekstit në të cilin janë thënë, për më tepër kur që në fillim të procedimit është kontestuar nga paditësi kjo mënyrë të proceduarit nga pala e paditur, duke pretenduar që materiali nuk është i plotë por i shkëputur nga konteksti. ... Në kushtet kur këto regjistrime u paraqitën si e vetmja provë nga pala e paditur dhe mbi të cilën është regjistruar procedimi dhe është bazuar vendimi objekt gjykimi, për sa kohë që nuk u krijua bindja për vërtetësinë dhe saktësinë e tyre, gjykata çmon se akti objekt gjykimi është i pabazuar dhe duhet shfuqizuar".

Amicus Curiae Në Gjykatën Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje me kërkesë të KMD. Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2016 i kanë dhënë të drejtën KMD-së për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke sanksionuar, në nenin 134, se "Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të (e) çdo Komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta". Edhe Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", me ndryshimet e pësuara me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit dhe vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve (neni 32, pika 1, germa "i/1"). Gjatë vitit 2022, KMD nuk ka ushtruar të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Gjatë vitit 2023, KMD ka parashtruar tre mendime të specializuara me shkrim përpara Gjykatës Kushtetuese, si vijon:

- KMD ka parashtruar, me shkresë Nr. 1291/1 dt. 13.12.2023, mendim të specializuar *Amicus curiae* për Gjykatën Kushtetuese, sipas kërkesës së kësaj të fundit, në çështjen me kërkuar një grup studentesh dhe një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve), subjekte të interesuar: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me objekt: *“Shfuqizimin e nenit 4, paragrafët 1 (c), 2 (b), 3 (b); si dhe nenit 5, fjalia e parë të ligjit 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”*.

Në këtë mendim me shkrim KMD ka theksuar: *“Fakti nëse rregullimi i ri ligjor ka çenuar thelbin e barazisë do të duhet të vërtetohet duke vlerësuar mungesën e ekzistencës së një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm.*

Për të justifikuar trajtimin e ndryshëm duhet të demonstronhet se rregulli ose praktika në fjalë

- *ndjek një synim të ligjshëm dhe se*
- *mjetet e zgjedhura për arritjen e synimit (d.m.th. masa që ka çuar drejt trajtimit të ndryshëm) janë proporcionale dhe të domosdoshme për arritjen e atij synimi.*

Për të përcaktuar nëse trajtimi i ndryshëm është proporcional, gjykata duhet të bindet se:

- *Nuk ka asnjë mjet tjetër për arritjen e qëllimit që kërkon më pak ndërhyrje në të drejtën për trajtim të barabartë. E thënë ndryshe, që disavantazhi i pësuar të jetë minimumi i mundshëm i dëmit të nevojshëm për arritjen e qëllimit të synuar;*
- *Qëllimi për tu arritur është kaq i rëndësishëm saqë justifikon këtë nivel ndërhyrjeje.*

Dështimi për të trajtuar ndryshe subjektet të cilët nuk ndodhen në situata të njëjta, kur kjo bazohet në një shkak të mbrojtur, do të konsiderohet diskriminim, në mungesë të justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm.

Në lidhje me synimin e ligjshëm, në radhë të parë duhet të provohet ekzistenca faktike e këtij qëllimi të synuar përmes kësaj mase ligjore, pra a ekziston një synim i tillë referuar fakteve dhe rrethanave konkrete. Një qëllim i synuar mund të jetë parimisht një qëllim i ligjshëm por kjo është e pamjaftueshme, pasi duhet detyrimisht të provohet se synimi legjitim i pretenduar të ekzistojë në kushtet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi dhe jo bazuar në prezumime.”

- KMD ka parashtruar, me shkresë Nr. 1290/1 dt. 13.12.2023, mendim të specializuar *Amicus curiae* për Gjykatën Kushtetuese, sipas kërkesës së kësaj të fundit, në çështjen me kërkuar Elisabeta Cara, subjekte të interesuar: Posta Shqiptare sh.a., Filiali i Postës Fier, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3528, datë 07.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”*.

Në këtë mendim me shkrim KMD ka theksuar: “Çështja për të cilën është ngritur ankimi kushtetues individual, paraqitur nga znj Elisabeta Cara nuk ka qenë objekt shqyrtimi administrativ nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pra, kërkesja i është drejtuar drejtpërdrejtë gjykatës me padi për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Gjithashtu, Komisioneri nuk është njoftuar nga ana e gjykatës që ka shqyrtuar çështjen për paraqitjen e një padie me pretendime diskriminimi dhe rrjedhimisht nuk ka parashtruar një mendim me shkrim lidhur me të.

Për të trajtuar drejt pretendimin e kërkesit në lidhje me ankimin kushtetues individual me objekt shfuqizimin e Vendimit nr. 00-2022-3528, datë 07.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, do parashtrajmë në mënyrë të përgjithshme mendimin me shkrim, duke evidentuar gjatë analizës pretendimin në lidhje me cënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në referim të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa, paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive (shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.”

- **KMD ka parashtruar, me shkresë Nr. 181, dt. 30.01.2023, mendim të specializuar Amicus curiae për Gjykatën Kushtetuese, sipas kërkesës së kësaj të fundit, në çështjen me kërkuar 28 Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/5 Deputetëve), subjekte të interesuar: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me objekt: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e RSH i Vendimit Nr.589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.**

Në këtë mendim me shkrim me shkrim KMD ka theksuar: “Pikërisht nën dritën e këtyre standarteve, Komisioneri jep mendimin e tij sa i përket pretendimit për cënimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Me VKM Nr.589, datë 07.09.2022 objekt i këtij gjykimi, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar miratimin e rregullave dhe procedurave për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje me qëllim fitimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar. Ky akt parashikon nga pika 6 e më tej procedurën e konfiskimit të këtyre objekteve, ndërsa në pikat 2-4 parashikon mundësinë që zhvilluesi apo çdo subjekt i autorizuar prej tij, me akt noterial të kalojë në favor të shtetit, me kontratë premtim shitjeje me vlerë 1 euro, shprehimisht ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore, të drejtën e pronës të sipërfaqeve të ndërtuara pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit, me qëllim përdorimin

e tyre për nevoja të strehimit social apo për interes publik, duke i njohur së fundmi këtyre edhe një të drejtë parablerje me çmim tregu.

Për të vlerësuar nëse Akti normativ cënon barazinë përpara ligjit, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, do të duhet të konsiderohet nëse ky Akt ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se konstatohet ky fakt, do të duhet të vlerësohet nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjoënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (shih vendimet nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, duhet të shqyrtojë nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme (shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Parimisht është e drejta e ligjoënësit të zgjedhë se cilat rrethana do të kenë pasoja juridike të njëjta, me qëllim që t'i rregullojë ato juridikisht në mënyrë të njëjlojtë. Por këtë zgjedhje ligjoënësi duhet ta argumentojë në mënyrë të arsyeshme. Fakti nëse në raste të caktuara është respektuar ose jo në thelb parimi i barazisë, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por duhet të shihet në lidhje me veçoritë dhe karakteristikat e çështjes konkrete që synohet të rregullohet (shih vendimin nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

Konkretisht VKM Nr.589, datë 07.09.2022 objekt shqyrtimi, i referohet një kategorie të caktuar ndërtimi pa leje. Kjo do të thotë që objektet që do të preken nga efektet e këtij akti duhet të jenë ndërtuar për qëllime fitimi dhe jo për përdorim vetjak apo familjar në formën e banesës.

Pra, për këtë kategori ndërtimi, për të cilën paligjshmëria e veprimit është evidentuar nga organet përkatëse, dhe autoritetet nuk kanë vepruar konform dispozitave ligjore, akti normativ vendos miratimin e rregullave dhe procedurave për konfiskimin për një interes shumë të lartë, interesin publik.

Vetë Ligji nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, nuk bën ndonjë dallim thelbësor midis zhvillimit të pronës për qëllime personale apo ekonomike, edhe pse në llojet e ndërtimeve vendos një klasifikim midis ndërtimit për banesë dhe ndërtimit për veprimtari ekonomike (Neni 1 shkronja d, Neni 4 shkronja a dhe Neni 16 shkronja ç).

Më specifik është Kodi Penal i R.Sh, i ndryshuar, i cili për efekt të dallimit të subjekteve të ndryshme në bazë të llojit të ndërtimit dhe raportit me pronësinë e truallit, në Nenin 199/a (Ndërtimi i paligjshëm)³⁴ trajton efekte penale të ndryshme duke dalluar disa subjekte:

- Subjekti që ka kryer një ndërtim pa leje në tokën e tij/saj;

³⁴ Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

- Subjekti që ka kryer një ndërtim të paligjshëm për nevojë strehimi;
- Subjekti që ka kryer ndërtim të paligjshëm në tokë publike ose në tokën e një subjekti tjetër;
- Subjekti që ka kryer ndërtim të paligjshëm për qëllime fitimi.

Në këtë kuptim, në kuadër të parimit të barazisë si dhe trajtimit ndryshe të situatave të ndryshme, pavarësisht se sjellja e kryer është e njëjtë (ndërtim i paligjshëm), ekziston një dallim midis subjekteve që e kanë kryer atë sjellje dhe një nga kriteret dallues është pikërisht nëse qëllimi i ndërtimit është apo jo për përfitim ekonomik.

Nisur nga kjo, për aq kohë sa rendi juridik pranon që të ketë trajtime të diferencuara të subjekteve që kryejnë të njëjtin veprim por që ndodhen në situata të ndryshme në një juridiksion kaq të rëndësishëm siç është ai penal, në parim nuk mund të pengojë që edhe në juridiksione tjera të ketë diferencime por gjithmonë në situata të përligjura dhe objektivoisht të justifikueshme e në respekt të parimit të proporcionalitetit.”

Informacion mbi Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me Çështjen Avdiu dhe të tjerë kundër Shqipërisë.

Në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut u paraqit aplikimi nr. 495116/17 Mariglen AVDIU dhe të tjerë kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 12 korrik 2017 të cilët ishin përfaqësuar para Gjykatës nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (“ERRC”), një organizatë joqeveritare me qendër në Bruksel, Belgjikë dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë joqeveritare me qendër në Tiranë.

Çështja ka të bëjë me diskriminimin e pretenduar kundër kërkuësve si rezultat i dështimit të qeverisë për të zbatuar masat kundër segregimit në një shkollë fillore, e cila frekuentohej ekskluzivisht nga fëmijët e minoritetit rom. Aplikantët janë 15 familje me origjinë rome që jetojnë në Moravë, Berat, një fshat në Shqipëri, ku romët përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë. Kur aplikimi u dorëzua, fëmijët ndiqnin ose pritej të ndiqnin shkollën Avdyl Avdya, një shkollë fillore e ndërtuar në vitin 2002.

Shkolla ofronte arsimin fillor të detyrueshëm në klasa të grupuara. Numri i fëmijëve në këtë shkollë varionte nga 23 në 29 dhe ishin vetëm nxënës romë. Disa familje jo-rome që jetojnë në lagje i dërguan fëmijët e tyre në shkolla të tjera. Nxënësit e shkollës “Avdyl Avdya” kanë mundur të mbarojnë studimet e detyrueshme në shkollën Shaban Sollaku dhe të dyja shkollat kanë qenë në të njëjtën njësi administrative. Në vitet para aplikimit aktual, vetëm pesë deri në gjashtë nxënës nga shkolla Avdyl Avdya kishin vazhduar studimet në shkollën Shaban Sollaku. Sipas aplikantëve kjo ishte për shkak të cilësisë së dobët të arsimit që ata morën në shkollën Avdyl Avdya. Me një ankesë të paraqitur në 17 qershor 2015 nga ERRC, më 16 korrik 2015 Drejtoria Arsimore Rajonale e Beratit (Drejtoria Arsimore) pranoi ekzistencën e segregacionit të nxënësve romë në shkollën Avdyl Avdya

dhe nevojën për t'i dhënë fund. Mirëpo, Drejtoria pohoi se transporti falas i fëmijëve deri në shkollën Shaban Sollaku nuk ishte i mundur, sepse nuk ishte plotësuar distanca minimale për transport falas të nxënësve deri në shkollë. Pas një ankese të mëtejshme të paraqitur më 3 shtator 2015 nga ERRC, Komisioneri Shqiptar për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri) më 16 dhjetor 2015 miratoi një vendim që përcaktonte se aplikantët ishin diskriminuar nga Ministria dhe Departamenti i Arsimit, në bazë të të racës së tyre, në fushën e arsimit.

Komisioneri urdhëroi zbatimin e hapave të nevojshëm, duke përfshirë mbylljen e shkollës dhe transportin falas për fëmijët romë në një shkollë të integruar. Më 10 prill 2018, ankuesit informuan Gjykatën se nxënësit aplikues kishin filluar të ndiqnin shkollën Shaban Sollaku. Më 27 mars 2023, ankuesit informuan më tej Gjykatën se Ministria kishte miratuar mbylljen e shkollës Avdyl Avdya. Nxënësit aplikantë kishin vazhduar të ndiqnin shkollën e integruar, shkollimi i tyre kishte vazhduar rregullisht dhe ata ishin mirëpritur në shkollën e re. Transporti ishte rregulluar nga autoritetet publike dhe prindërve iu rimbursuan shpenzimet e transportit, fillimisht nga palë të treta dhe më pas nga Bashkia Berat. Kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë kërkesë në gjykatat vendase duke pohuar se nuk kishte mjete efektive juridike në rastin e tyre.

Kërkuesit u ankuan në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës se ata ishin diskriminuar në të drejtën e tyre për një arsim gjithëpërfshirës si rezultat i dështimit të autoriteteve për të zbatuar masa desegreguese për të adresuar mbipërfaqësimin e nxënësve romë në Shkollën Avdyl Avdia. Ata pohuan se kjo vendosje rezultoi në privimin e nxënësve aplikantë nga një arsimim i mirëfilltë.

Në çështjen X dhe të tjerët kundër Shqipërisë (nr. 73548/17 dhe 45521/19, § 63, 31 maj 2022), Gjykata ka theksuar se mjetet juridike të brendshme duhet të jenë "efektive" në kuptimin e parandalimit të shkeljeve të pretenduar ose vazhdimi i saj, ose sigurimi i kompensimit adekuat për çdo shkelje që kishte ndodhur tashmë (shih A.H. dhe të tjerët kundër Ruisë, nr. 6033/13 dhe 15 të tjerë, § 347, 17 janar 2017). Në atë rast, thelbi i ankesave të aplikantëve kishte të bënte me dështimin e autoriteteve për t'i dhënë fund një situatë të vazhdueshme, përkatësisht ndarjen e nxënësve romë/egjiptianë në një shkollë. Prandaj, Gjykata vendosi se mjeti juridik që ofronte vetëm mundësinë e kompensimit financiar, pa penguar vazhdimin e shkeljes së pretenduar, nuk mund të konsiderohej efektiv (shih, mutatis mutandis, Patranin kundër Ruisë, nr. 12983/14, § 86, 23 korrik 2015).

Megjithatë, situata e kërkuesve në rastin në fjalë ndryshon, jo vetëm sepse autoritetet pranuan se ankuesit ishin diskriminuar, por ata gjithashtu e korrigjuan atë situatë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në vendimin e sipërpërmendur të datës 15 dhjetor 2015, Komisioneri konstatoi se Ministria dhe Departamenti i Arsimit kishin diskriminuar nxënësit romë në fushën e arsimit, përfshirë kërkuesit, në bazë të racës së tyre, për shkak të ndarjes së tyre në shkollën Avdyl Avdya. Nisur nga këto gjetje, Gjykata vlerëson se

autoritetet kombëtare pranuan shprehimisht shkeljen e të drejtës së kërkuesve për të mos u diskriminuar. Për më tepër, ankuesit informuan Gjykatën se autoritetet kombëtare kishin ndërmarrë disa hapa për të adresuar ankesat e tyre. Shkolla Avdyl Avdya u mbyll zyrtarisht në vitin 2018. Që në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2017/2018 Bashkia Berat kishte siguruar transportin për fëmijët në shkollën e re dhe rimbursimin e shpenzimeve të transportit për familjet në fjalë. Aplikantët deklaruan se cilësia e arsimit në shkollën e re ishte adekuate.

Sipas mendimit të Gjykatës, autoritetet përkatëse kanë respektuar detyrimin e tyre pozitiv për të ndërmarrë hapa për të korrigjuar pabarazinë e pretenduar të aplikantëve dhe për të shmangur ndarjen e tyre në shkollën Avdyl Avdya.

Çështja tjetër për t'u vlerësuar është nëse aplikantët kanë marrë kompensim adekuat për shkeljen e pranuar të së drejtës së tyre për të mos u diskriminuar. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se detyrimi për të shterur mjetet juridike të brendshme kërkon që kërkuesit të përdorin normalisht mjetet juridike që janë të disponueshme dhe të mjaftueshme në lidhje me ankesat e tyre të Konventës. Për të qenë efektiv, një mjet juridik duhet të jetë në gjendje të korrigojë drejtpërdrejt gjendjen e kundërshtuar të çështjeve dhe duhet të ofrojë perspektiva të arsyeshme suksesi (shih, për shembull, Gherghina kundër Rumanisë [GC] (dek.), nr. 42219/07, § 84, 9 korrik 2015).

Vendimi përfundimtar i Komisionerit, duke pranuar shprehimisht diskriminimin e nxënësve aplikantë, u dha kërkuesve një mundësi të arsyeshme për të marrë dëmshpërblim sipas nenit 34 të Ligjit Kundër Diskriminimit (Ligji nr. 10221 i datës 4 shkurt 2010), i cili parashikon se kushdo që është diskriminuar ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit pranë një gjykate kompetente, pavarësisht nëse ka bërë ankesë pranë Komisionerit. Megjithatë, kërkuesit nuk kanë kërkuar kompensim në një padi civile kundër shtetit. Ndërkohë që vetë ngritja e procesit civil për dëmshpërblim nuk mund të korrigojë plotësisht shkeljen e vazhdueshme të së drejtës për të mos u diskriminuar, procese të tilla në kombinim me njohjen nga Komisioneri për shkeljen e të drejtës së tyre për të mos u diskriminuar dhe masat pozitive për të adresuar diskriminimin. Rrjedhimisht, kur Komisioneri vendosi se ishte shkelur e drejta e kërkuesve për të mos u diskriminuar, ankuesit duhej të ndiqnin mjetet juridike për të marrë kompensim për atë shkelje të mëparshme. Aplikantët nuk kanë arritur ta bëjnë këtë.

Rrjedhimisht, për aq sa ankesa e kërkuesve ka të bëjë me periudhën para prillit 2018, ajo duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme.

Për sa i përket pretendimit të ankuesve për periudhën pas prillit 2018, Gjykata tashmë ka vlerësuar se autoritetet kanë marrë masat e duhura për t'i dhënë fund situatës për të cilën ankoheshin (shih paragrafin 16 më lart). Prandaj, për aq sa ankesa e ankuesve ka të bëjë me

periudhën që nga prilli 2018, ajo është e papajtueshme racione personae me dispozitat e Konventës në kuptimin e nenit 35 § 3 (a) dhe për këtë arsye duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35. § 4.

URDHRAT E EKZEKUTIMIT

Gjatë vitit 2023, Komisioneri ka kërkuar nga Zyra Përmbartimore Tirane ekzekutimin e vendimeve të gjobës si më poshtë:

- Titullin ekzekutiv vendimi Nr. 228, datë 22.12.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të cilin është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendim Nr. 2317 datë 26.05.2023, ku palë debitore është Posta Shqiptare, me vlerë gjobe 200 000 leke.
- Titullin ekzekutiv vendimi Nr. 184, datë 30.09.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të cilin është lëshuar Urdhri I Ekzekutimit nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë vendim Nr. 1068, date 24.05.2023, ku palë debitore është individ A.M me vlerë e gjobe 30.000 lekë.
- Titullin ekzekutiv vendimi nr.130, datë 31.08.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të cilin është lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendim nr. 29, datë 24.02.2023 ku palë debitore është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me vlerë gjobe 100.000 lekë.
- Titullin ekzekutiv vendimin nr. 230 datë 22.12.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të cilin është lëshuar Urdhri I Ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë vendimi Nr. 3424, datë 05.10.2023 ku palë debitore është Posta Shqiptare sh.a me vlerë gjobe 200.000 lek.

Nga Zyrat Përmbartimore janë komunikuar në vitin 2023 vendimet e pushimit të ekzekutimit, për titujt ekzekutivë të KMD-së, si më poshtë:

- Vendim gjobë Nr. 140/2019 me debitor Bashkia Dibër me vlerë 100.000 lek.
- Vendim gjobe Nr. 256/2018 me debitor Bashkia Gjiokastër me vlerë 60.000 lek.
- Vendim gjobe Nr. 43/2021 me debitor Bashkia Durrës me vlerë 200.000 mijë lek.
- Vendim gjobe Nr. 227/2018 me debitor Spitali Rajonal Gjirokastër me vlerë 60.000 mijë lekë.

8. Rekomandime të Kmd

Rekomandime për Akte Ligjore

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik, të attributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga

diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; si dhe zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, **gjatë vitit 2023, me kërkesë, ka dhënë mendime, si më poshtë vijon:**

- **Mendime mbi Projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qershor 2023 në kuadër të bashkërendimit nga Ministria e Drejtësisë, lidhur me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ridergoi mendimet si më poshtë të cilat nuk ishin reflektuar:

Komisioneri ridërgoi rekomandimin si më poshtë:

Në nenin 9 të projektligjit “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave sensitive”, paragrafi 1, ku është parashikuar se: “Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, ndalohet përpunimi i të dhënave që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, përpunimi i të dhënave gjenetike ose të dhënave biometrike me qëllim për të identifikuar në mënyrë unike një person, si dhe i të dhënave në lidhje me shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandoi riformulimin e tij, sipas kësaj përmbajtje: “Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, ndalohet përpunimi i të dhënave që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, përpunimi i të dhënave gjenetike ose të dhënave biometrike me qëllim për të identifikuar në mënyrë unike një person, të dhënave në lidhje me shëndetin ose të dhënave në lidhje me jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi”. Ky rekomandim u hartua në përputhje me parashikimet e GDPR, përkundër parashikimit në projektligj.

Në nenin 9, paragrafi 2, germa “c” e projektligjit, ku është parashikuar se: “Me kusht që të zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të subjekteve të të dhënave, lejohet përpunimi i të dhënave sensitive në rastet kur: c) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të subjektit të të dhënave dhe ky i fundit është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e tij, si dhe, në rastet kur është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të një personi tjetër”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandoi heqjen e formulimit “fizikisht ose mendërisht i paaftë” dhe rishikimin e tij, sipas kësaj përmbajtje: “Me kusht që të zbatohen masa të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të subjekteve të të dhënave, lejohet përpunimi i të dhënave sensitive në rastet kur: c) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të subjektit të të dhënave dhe ky i fundit është në pamundësi fizike ose ligjore për të dhënë pëlqimin e tij, si dhe, në rastet kur është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetikë të një personi tjetër”. Ky rekomandim u hartua në përputhje me parashikimet e GDPR, përkundër parashikimit në projektligj.

- **Mendime për Strategjinë E Përfshirjes Sociale 2023-2027**

Drejtoria Juridike ka përgatitur propozime lidhur me Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2023-2027, ku ka propozuar si më poshtë:

Së pari, të dhënat e Komisionerit duhet të përfshihen në treguesit e këtij dokumenti, pasi është një nga organet që realizon monitorimin dhe vlerësimin e përfshirjes sociale.

Së dyti, e vlerësojmë të domosdoshëm përshirjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Grupin Ndërsektorial të Treguesve të Përfshirjes Sociale, për të garantuar mbledhjen e të dhënave për përfshirjen sociale sipas gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe grupeve të tjerë vulnerabël kyç, në tre fushat kryesore si arsim, punësim, të mira dhe shërbime.

Së treti, lidhur me treguesit, e parashikaur në draft dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale propozojmë shtesat si më poshtë:

Tabela Nr.2 *“Treguesit e punësimit dhe aftësive”* propozojmë të shtohen në këtë rubrikë edhe të dhënat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi vendimet e diskriminimit lidhur me fushën e punësimit për grupet vulnerabël, pasi përbën një tregues të situatës së diskriminimit në vend:

13. Numri i të papunëve që janë diskriminuar me vendim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Tabela Nr. 3 *“Shëndeti”* përfshin treguesit shëndetësor. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në çështjet e trajtuara ka konkluduar në mungesë të medikamenteve të cilat janë të kushtueshme, në institucionet spitalore publike, për trajtimin e fëmijëve që vuajnë nga leucemia. Komisioneri në vendimet e tij ka konstatuar gjithashtu mungesë medikamentesh për personat hemofilik. Propozojmë të shtohet një tregues i cili të identifikojë numrin e personave Hemofilik të trajtuar me barnat e posaçme (Faktor VIII). Për këtë arsye, vlerësojmë me rëndësi, të përfshihen edhe këto kategori si tregues:

6. Numri i personave Hemofilik të trajtuar me barnat e posaçme(Faktor VIII).

7. Numri i fëmijëve të trajtuar me medikamente në institucionet spitalore publike, që vuajnë nga leucemia.

Tabela nr. 6 *“Treguesit e të drejtave të njeriut”* si tregues të përjashtimit social, janë përfshirë disa grupe vulnerabël, me burime informacioni si Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Social Shtetëror, etj krahas këyre institucioneve propozojmë të shtohen edhe të dhënat e Komisionerit mbi numrin e çështjeve të trajtuara për grupet vulnerabel si:

15. Numri i çështjeve të trajtuara për romët, numri i ankesave të shqyrtuara nga Komisioneri;

16. Numri i ankesave të shqyrtuara nga personat me aftësi të kufizuar;

17. Numri i ankesave të shqyrtuara nga të moshuarit;

18. Numri i ankesave të shqyrtuara nga fëmijët(përfaqësuesit ligjore);

19. Numri i ankesave tëshqyrtuara nga gratë.

Rekomandime për Përmirësim Situate

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me iniciativen e tij mund të japë rekoamndime me qëllim përmirësimin e situatës. Për vitin 2023 ka dhënë rekomandim si më poshtë:

- **Rekomandim i përbashkët i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit “Për marrjen e masave dhe zbatimin e legjislacionit përkatës për sigurimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri”.**

Në vijim të përfundimit të zgjedhjeve vendore të vitit 2023 në Shqipëri dhe shpërndarjes së mandateve të kryetareve/kryetarëve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, Komisioneri adresoi në 61 Bashkitë e vendit rekomandimin për të sjellë në vëmendje të organeve të reja të vetëqeverisjes vendore, të dala nga këto zgjedhje, garantimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit inkurajojnë zbatimin e parimit të barazisë dhe në rastet e emërimeve nga kryetaret/kryetarët në funksione të tjera. Kjo bazuar dhe në parashikimin ligjor të nenit 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit: “ Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi; g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njëjësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil.”.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10221, datë 04.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, Ligjit nr. 9970/ 2008 “Për barazinë gjinore”, si dhe të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat mbështetëse të kësaj nisme,

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit, rekomanduan si më poshtë:

Marrjen e masave nga të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për sigurimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri, në zbatim të legjislacionit shqiptar, si edhe në përputhje me dokumentat ndërkombëtare të nënshkruara e ratifikuara nga Shqipëria dhe frymën e Konventës CEDAW, për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në përfaqësimin e secilës gjini në organet e emëruara të pushtetit vendor në Shqipëri.

Ndihma Juridike

- Kthim përgjigje drejtuar ankueses E.H., lidhur me kërkesën për informacion në lidhje me ecurinë e çështjes me e-mail të datës 23.01.2023.
- Kthim përgjigje drejtuar info@kmd.al, në lidhje me email-in e parashtruar nga ankuesi z. D.H, për ecurinë gjyqësore të vendimit të KMD-së, Nr. 181/2018.
- Kthim përgjigje drejtuar ankuesit B. N, lidhur me kërkesën e tij për informacion, të parashtruar përmes email-it, në lidhje me ecurinë e vendimit Nr. 17 datë 05.02.2019.³⁵
- Kthim përgjigje, me email dt. 06.09.2023, kërkesës për informacion, të administruar nga e-mail info i KMD, lidhur me trajimin me KMCPA ne vendin e punës.
- Kthim përgjigje, me e-mail dt. 20.09.2023 dhe dt. 22.09.2023, kërkesës për informacion, të administruar nga e-mail info i KMD, lidhur me çështjen gjyqësore të ankueses A.L. kundër DRAP Lezhë.
- Kthim përgjigje me e-mail datë 25.10.2023, “Kërkesës për informacion” te ankueses A.L. lidhur me vendimin e gjobës së KMD kundrejt DRAP Lezhë.
- Kthim përgjigje me e-mail datë datë 15.03.2023, “Kthim përgjigje” kërkesës së ankuese L.D, lidhur me çështjen gjyqësore me padites Shkolla Mekanike “Hasan D’Gina”.
- Kthim përgjigje me e-mail datë 05.04 2023 ankueses L.D lidhur me datën e gjyqit për çështjen me paditës Shkolla Mekanike “Hasan D’Gina”.
- Kthim përgjigje me e-mail datë 16.05.2023 ankueses L.D lidhur me mbarëvajtjen e seances gjyqësore për çështjen me paditës Shkolla Mekanike “Hasan D’Gina”.
- Kthim përgjigje me e-mail datë 15.06.2023 duke vendosur ne dispozicion ankuesit O.K aktet e kërkuara lidhur me procesin gjyqësor me plaë paditëse Spitali Universitar i Traumes.
- Kthim përgjigje me e-mail datë 03.10.2023 “Kërkohet vendim” lidhur me kërkesën për informacion të ankuesit Y.S, lidhur me vendosjen në dispozicion të vendimit nr. 157 date 24.08.2021 te KMD-së.
- Kthim përgjigje me e-mail datë 16.11.2023 ankueses L.D mbi dispozitivin e vendimit të Gjykatës lidhur me çështjen me padites Shkolla Mekanike “Hasan D’Gina”.
- Kthim përgjigje në e-mail datë 22.12.2023, ankuesit Admir Dine, në lidhje me procesin gjyqësor që po zhvillohet pranë Gj.Adm.Sh.I Tiranë, ku KMD është palë e paditur.

³⁵ Shkresë Nr. 972 Prot., datë 28.08.2023 e KMD-së.

9. Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjëimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë vitit 2023 KMD ka bashkëpunuar me median si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të luftuar dhe parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin etj, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me daljet në media vizuale dhe e shkruar si më poshtme:

Janar – Faxweb.al

Shkurt – A2 CNN, Zëri i Amerikës, Tv Skampa

Mars – Vizion+ Tv, Euronews Tv

Prill – Euronews Tv, MCN Tv

Maj – Report Tv, MCN Tv

Qershor – Euronews AL

Korrik – MCN TV, Vizion+ TV

Shtator – Zëri i Amerikës, A2 News

Tetor – A2 News, Top Channel, Ora News Tv, Shqiptarja.com, Euronews.al

Nëntor – Zëri i Amerikës, Top Albania Radio

Në total 22 raportim në media për promovimin e luftës kundër diskriminimit dhe të drejtave të njeriut.

Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media

Gjatë vitit 2023, Komisioneri dhe Zyra kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si takime, seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Janar

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim Komisionerin e Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare, amb. Kairat Abdrakhmanov. Biseda u përqendrua në rolin e institucionit të KMD për promovuar barazinë dhe mosdiskriminimin e pakicave Kombëtare.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në institucion studentët e Fakultetit Juridik në Universitetin Mesdhetar për një vizitë studimore. "Drejtësia sociale dhe të drejtat e Njeriut" ishin temë e bashkëbisedimit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim me Shërbimin Ligjor Falas (TLAS) zhvilloi eventin përmbyllës së projektit të përbashkët mbi: "Fuqizimi i mbrojtjes nga Diskriminimi në nivel lokal" - mbështetur nga ambasada e Holandës në Shqipëri.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në institucion studentët e Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës, posaçërisht "klubin studentor" mbi luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në eventin "Hajde për çaj", të organizuar nga Albanian Chevening Association in Albania (ACAA) për të biseduar mbi edukimin ligjor të publikut, për të kuptuar rëndësinë e krijimit të një standarti të munguar që ka në focus ndërgjegjësimin/edukimin e qytetarëve rreth politikave shtetërore me impakt në interesin publik.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të programit gjithpërfshirës "Zgjerimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" (EFLAS) dhe mbështetjen e UNDP Albania, zhvilloi sesionin e trajnimit me Drejtoritë e Ndihmës Ligjore Falas, avokatët e ndihmës ligjore falas nëpër rrethe, Organizata të shoqërisë civile të autorizuara për ofrimin e këtyre shërbimeve, Dhomën Kombëtare të Avokatisë për çështje të diskriminimit me bazë gjinor dhe parimit të barazisë, format e reja të diskriminimit si dhe padia kolektive si një nga format më të reja të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në institucion studentët Master në Administrim i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë, FSHS, UT.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda në kuadër të programit gjithpërfshirës "Zgjerimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" (EFLAS) dhe mbështetjen e UNDP Albania zhvilloi një tjetër sesion trajnimi me Drejtoritë e Ndihmës Ligjore Falas, avokatët e ndihmës ligjore falas nëpër rrethe, Organizata të shoqërisë civile të autorizuara për ofrimin e këtyre shërbimeve, Dhomën Kombëtare të Avokatisë për çështje të diskriminimit me bazë gjinor dhe parimit të barazisë, format e reja të diskriminimit si dhe padia kolektive si një nga format më të reja të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi trajnimin me temë: "Padia kolektive dhe format e reja të diskriminimit", ku pjesëmarrës janë

avokatët dhe operatorët e ndihmës ligjore dytësore që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe barazisë.

Shkurt

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një vizitë zyrtare në Bullgari, me ftesë të homologes znj. Anna Jumalieva, Komisioner për Antidiskriminimin. Gjatë vizitës, Komisioneri mori pjesë në disa dëgjesa publike për çështje të diskriminimit të komuniteteve.
- Gjatë vizitës zyrtare në Sofje, Komisioneri Gajda zhvilloi një takim me Këshillin Kombëtar të Komuniteteve Fetare në Bullgari.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Universiteti "Mesdhetar" nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi, në fokus të së cilës janë shkëmbimet akademike të programeve të përbashkëta të Kërkimit shkencor dhe praktikave profesionale të studentëve në institucionin që promovon barazinë dhe të drejtat e njeriut, duke luftuar diskriminimin dhe ndërgjegjësuar komunitet.
- Komisioneri Gajda zhvilloi një leksion të hapur për studentët e Akademisë së Sigurisë, që t'i informojmë dhe ndërgjegjësojmë për aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe rolin e rëndësishëm të Komisionerit në sigurimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave!
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi në partneritet me UNFPA Albania dhe Dhomën Ekonomike të Gruas një takim me qëllim informimin e sipërmarrësve të sektorit privat mbi rëndësinë dhe përfitimet për punëdhënësit dhe punëmarrësit, që burojnë nga njohja e mirë e ligjit kundër diskriminimit.
- Në kuadër të "Javës kundër Diskriminimit" - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda, në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Europës, po zhvillon një takim informues me qytetarë, OJF, punonjës socialë dhe punonjës së bashkisë së Malësisë së Madhe. Temat e takimit është promovimi i të drejtave të Njeriut dhe luftimi i Diskriminimit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim informues me stafin pedagogjik dhe nxënës të Gjimnazit "Sherif Hoxha", në Koplik, në kuadër të "Javës kundër të Diskriminimit".
- Në kuadër të Javës kundër diskriminimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim me zyrtarët më të lartë të Bashkisë Bilisht, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë aktivistë për të folur për rëndësinë e bashkëpunimit në ndreqjes së shkaqeve të diskriminimit dhe promovimin e barazisë.
- Në kuadër të Javës kundër diskriminimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një takim në gjimnazin "Jani Nushi" në Lushnje, me stafin pedagogjik dhe nxënës për të folur për rëndësinë e bashkëpunimit në ndreqjes së shkaqeve të diskriminimit dhe promovimin e barazisë. Gjatë diskutimit

të hapur u bisedua për aspektet kyçe që lidhen me mbrojtjen e grupeve të vulnerabël në komunitetet lokale, personave me aftësi ndryshe, bullizmi etj.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Inspektoriati Shtetëror i Punës nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi. Qëllimi i kësaj marrëveshje është rritja e ndërveprimit mes palëve si organe përgjegjëse që kanë tagrat dhe mandatin për kontrollin e çështjeve që lidhen me punën, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, me qëllim parandalimin, reduktimin dhe adresimin e këtyre fenomeneve. Gjithashtu sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit në kuadër të marrjes së masave për mbrojtjen nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në botën e punës.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin në Korçë me përfaqësues të Avokatura e Shtetit, ministrive përkatëse dhe autoriteteve vendore, u diskutuan masat konkrete për adresimin e një vendimi të fundit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për Shqipërinë, i cili konstatoi diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në lidhje me të drejtën e fëmijëve romë dhe egjiptianë për arsim gjithëpërfshirës.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda pati kënaqësinë të prezantonte broshurën "Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi - Përmbledhje për Fëmijë" në Gjimnazin "Petro Nini Luarasi" në Tiranë, në prani të mësuesve, nxënësve dhe Përfaqësuesit të UNICEF Shqipëri, Roberto De Bernardi.

Mars

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbajti një seancë trajnimi për biznesin për luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda do të mbajë një Leksion të Hapur në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike - Universiteti "Aleksandër Moisiu" - Durrës. Tema e trajtuar, "Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të promovuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimi".
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim dy përfaqësues të Dëshmitarëve të Jehovahit në Shqipëri. Z. Mënaj dhe Dërguti informuan Komisionerin Dr. Gajda për veprimtarinë e organizatës së tyre dhe për urat e bashkëpunimit mes palëve.
- Komisioneri Dr. Gajda mori pjesë në një event hiking, me misionin për të mbledhur fonde për një strehëz grash të dhunuara në Tiranë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mirëpriti në institucion një vizitë studimore nga Agjencia Suedeze për Zhvillim (SIDA) dhe fondacioni "The Kvinna till Kvinna" në lidhje me pjesëmarrjen e profesionistëve të programit të avancuar nga 5 vende: Ukraina, Moldavia, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria. Temë e bisedës ishin Mekanizmat e parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe roli i agjentëve të ndryshimit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim një delegacion i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të

Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në tryezën konsultuese me temë “Fushata Zgjedhore - Financimi, roli dhe përgjegjësia e medias, si dhe gjuha e urrejtjes dhe standardet etike gjatë fushatës zgjedhore” - organizuar nga KQZ Shqiperi në bashkëpunim me Këshillin e Europës, Delegacionin e Bashkimit European dhe Prezencën e OSBE-së në Tiranë.
- Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në eventin “Inkurajojmë të rinjtë për të promovuar barazinë gjinore, diversitetin dhe përfshirjen sociale” pranë universitetit Epoka, Tiranë.

Prill

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda ishte për një bisedë për të drejtat e Njeriut me studentët e Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në çeljen e ekspozitës “Muzg - Stacioni i Gjelbër” pranë godinës së KMD, organizuar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Çelja ekspozitës shënoi nisjen e aktiviteteve tona në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Rome.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mbajti një leksion trajnues në Shkollën e Magjistraturës, me temë: Pozicioni procedural i KMD në Gjykatë. Natyra e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Praktika e GJEDNJ, GJED dhe gjykatave të Republikës së Shqipërisë lidhur me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në takimin e përbashkët të mësuesve nga me institucionet dhe organizatat për të drejtat e fëmijëve për të bashkëbiseduar mbi gjithëpërfshirjen në arsim. Eventu ishte organizuar nga CRCA/ECPAT Shqipëri, EdGuard Institute dhe Center for Education and Development - CED.

Maj

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një trajnim në Shkollën e Magjistraturës në lidhje me Parimin e Barazisë dhe mos Diskriminimit, si dhe Padinë Kolektive. Komisioneri vlerëson se Magjistratët (gjyqtaret dhe prokurorët e ardhshëm) janë një potencial i sigurt për përmirësimin e përdorimit të këtyre koncepteve në praktikë
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në aktivitet vlerësoi mesazhet e dashurisë së pakushtëzuar të familjes, për pranimin familjar të personave LGBTIQ+, përfshirjen sociale, diversitetin, gjuhën e mos urrejtjes, mosdiskriminimin etj. që përcolli ekspozita "Jam fëmija yt" - kuruar nga OMSA. Gjatë ekspozitës u zhvillua një diskutim për anëtarët, aleatët dhe artistët mbështetës, me qëllim promovimin e

pranimi dhe dashuri brenda familjes dhe inkurajimin e prindërve që të pranojnë fëmijët e tyre LGBTIQ+.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një leksion të hapur në Universitetin e Korçës Fan S. Noli, Departamenti i Shkencave Sociale, në lidhje me Parimin e Barazisë dhe mos Diskriminimit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda në bashkëpunim me fondacionin "Pema e Jetës" organizuan një "Tryezë diskutimi mbi problemet dhe mbështetjen e pacientëve me Sklerozë Multiple". Në këtë takim u dëgjua zëri i pacientëve, përfaqësuesve të ojf-ve të ndryshme, si dhe ajo e specializuar si organizata "Për medikamente Multipleks Skleroza".

Qershor

- VLORE - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda zhvilloi një trajnim me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me Parimin e Barazisë dhe mos Diskriminimit, si dhe Padinë Kolektive. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda vlerëson se Magjistratët (gjyqtaret dhe prokurorët e ardhshëm) janë një potencial i sigurt për përmirësimin e përdorimit të këtyre koncepteve në praktikë.
- Viojnë leksionet e hapura në kontekstin e projektit me temë: "Mbeshtetje për forcimin e kapaciteteve institucionale të KMD-së në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të promovuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit me lente gjinore". Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe Fakulteti i Drejtësisë zhvilluan një bisedë dhe një debat të shëndetshëm në lidhje me konceptin e barazisë në aspektin gjinore. Fokus i veçantë u drejtua rreth praktikave të mbiemrit dhe identifikimit prinderor të individit.
- Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve organizuar në Vlorë dhe Shkodër në bashkëpunim të ngushtë me Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shkolla e Magjistraturës, përfshiu rreth 50 magjistratë shqiptarë, të cilët forcuan njohuritë e tyre mbi çështje specifike dhe zgjidhjet e mundshme ligjore për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve shqiptarë, viktimat e diskriminimit apo urrejtjes.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti një takim drejtoreshën e Agjencisë Ekzekutive për Bullgarët Jashtë Shtetit, znj. Rajna Manxhukova dhe ambasadorin e Bullgarisë në Shqipëri, z.Ivaylo Kirov.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda priti në një takim në Institucion përfaqësuesit e projektit "PërfshirjeXShkollat" - ku në fokus ishte bashkëveprimi për ndreqjen e situatave diskriminuese dhe segregimit. PërfshirjeXShkollat synon të promovojë barazinë për të gjithë dhe të luftojë për një sistem arsimor gjithëpërfshirës.

Korrik

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në një tryezë të organizuar nga Women's Democracy Network, mbi politikën gjinore dhe pushtetin lokal.

- Komisioneri Gajda zhvilloi një sesion informues me punonjës të bankës së nivelit të dytë "Reifessen bank" mbi të drejtat e Njeriut, rolin Institucionit të KMD dhe përgjegjësitë sociale të kompanive private.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim znj. Egla Bajrami, drejtore ekzekutive të Klubit kombëtar të Prindërve me fëmijë me Çrregullime të spektrit autik, znj. Anila Busho, Drejtore ekzekutive e EIPASS Balkans dhe regjizori i njohur Herion Mustafaraj ku biseduan për shfaqjen e komedisë "Uriturus" me 42 aktorë të ndryshëm për të sensibilizuar shoqërinë. Shfaqje të këtilla janë të mirëpritura dhe është mënyrë për të thyer barrierat.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konferencën finale të projektit "Rritja e aksesit të barabartë të minoritetit Rom në të drejtat publike dhe civile", të organizuar nga shoqata Rromano Kham.

Gusht

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në institucion një grup studentësh gjermanë të Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit "Humboldt" në Berlin. Komisioneri informoi studentët e drejtësisë për veprimtarinë e KMD në luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë.
- Komisioneri Gajda priti në një takim znj. Giulia Re, drejtuesja e re e zyrës së Këshillit të Europës në Shqipëri. Komisioneri e informoi kreun e KiE në Tiranë për veprimtarinë e KMD në luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë.

Shtator

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda dhe Fondacioni "Së Bashku", me mbështetjen e zyrës së Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian zhvilluan trajnimin për përgatitjen dhe dorëzimin e ankesave pranë KMD. Trajnimi synon të rrisë kapacitetet e organizatave të shoqërisë, aktivistëve dhe qytetarëve për të përdorur mekanizmin e Institucionit të KMD për ndreqjen e situatave diskriminuese dhe ndërgjegjësimin për të promovuar barazinë. Trajnimi vazhdojë edhe në qytetin e Durrësit dhe Shkodrës.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në konferencën rajonale me rastin e 20 vjetorit të Avokatit të Popullit të Malit të Zi, me mbështetjen e OSBE.

Tetor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin periodik të Komitetit Drejtues të subjekteve përfituese të Horizontal Facility III (Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë), si partner të KiE, në projektin, "Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe medias në Shqipëri", mbështetur nga BE përmes KiE.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me UNDP Albania prezantuan në prani të strukturave publike, shoqërisë civile dhe partnerëve të

zhvillimit, rezultatet e studimit mbi "Ndikimet e Kornizës Ligjore dhe Praktikave të Administratës Publike në Barazinë Gjinore të Elementet Familjare."

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda diskutoi me studentët e Punës Sociale mbi nevojat e shumëfishta të grave dhe vajzave vulnerabël në shërbimet e kujdesit social. Bashkë me Avokatin e Popullit dhe pedagogët e Departamenti të Punës Sociale dhe Politikës Sociale, studentët zgjeruan njohuritë mbi optikën e barazisë gjinore, sfidat e diverzitetit dhe përfshirjes për grupet në nevojë. Aktiviteti i mbështetur nga UN Women përmes programit të përbashkët të OKB-së "Askush të mos mbetet pas, financuar nga Swiss Development & Cooperation.

Nëntor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkroi me znj. Rudina Çollaku, kryetare e Women Center for Development and Culture, një Marrëveshje Bashkëpunimi në dobi të veprimtarisë së përbashkët për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë, veçanërisht në mbështetje të vajzave dhe grave.
- Në ditën Ndërkombëtare të fëmijëve, Komisioneri Gajda priti në institucion një përfaqësi të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë - UT, për të biseduar rreth Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; E drejta Sociale, parimi i barazisë, (Garantimi i të drejtave të barabarta është detyrë e tërë shoqërisë dhe nënkupton mënjanimin e pengesave në realizimin e barazisë gjinore); Hate speech (gjuha e urrejtjes) dhe liria e fjalës.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konferencën rajonale për Krimet e Urrejtjes në Europën Juglindore. Konferenca u fokusua në ndërlidhjen mes krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë adresimin e sfidave dhe gjetjen e zgjidhjeve, kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe sfidat në kontekstet kombëtare.
- Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori pjesë në sesionin e 2-të të programit të avancuar të trajnimit ndërkombëtar (ITP GBV), "Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës me bazë gjinore - Forcimi i agjentëve të ndryshimit", zhvilluar në Budva, Mali i Zi.

Dhjetor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në Kongresin e gruas Rome "Sot, vendosin gratë Rome" - organizuar nga organizata "Romano Khan".
- Përfaqësues nga Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi morën pjesë në tryezën "Promovojmë diversitetin në vendin e punës" - e cila bëri së bashku institucionet qendrore, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të mediave.

- Komisioneri Gajda priti në institucion një grup të rinjsh për aktivitetin: "Të drejtat e njeriut, nga koncepti në realitet" organizuar nga Woman Center for Development and Culture Albania (WCDCA). Në kuadër të Fushatës: "Promovo të drejtat e njeriut, vepro për paqen", takimi startoi me Podcastin e realizuar nga të rinjtë e networkut [#AlbanianYouthPeacebuildersNetwork](#).

10. Veprimtaria monitoruese e KMD

Projekte

Zgjerimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të programit gjithpërfshirës "Zgjerimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" (EFLAS) dhe mbështetjen e UNDP Albania, zhvilloi disa sesione trajnimi me temë: "Padia kolektive dhe format e reja të diskriminimit", ku pjesëmarrës janë Drejtoritë e Ndihmës Ligjore falas, avokatët e ndihmës ligjore falas nëpër rrethe, Organizata të shoqërisë civile të autorizuara për ofrimin e këtyre shërbimeve, Dhomën Kombëtare të Avokatisë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të promovuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht në perspektivën gjinore.

Projekti synon rritjen e njohurive të operatorëve të ndihmës juridike falas, organizatave të shoqërisë civile të autorizuara për ofrimin e këtyre shërbimeve me fokus çështje të diskriminimit me bazë gjinore dhe parimit të barazisë, format e reja të diskriminimit, si dhe padinë kolektive si një nga format më të reja të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe realizimin e një studimi mbi konceptin e kryefamiljarit, praktikën e mbiemrit dhe identitetit prindëror të personit.

Ky trajnim mundësohet në kornizën e Projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" (EFLAS), i cili zbatohet nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Javën kundër Diskriminimit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda në bashkëpunim me projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillin e Evropës "Përparimi i mbrojtjes nga Diskriminimi në Shqipëri" organizoi në Shqipëri "Javën kundër Diskriminimit", synimi i të cilës është të shpërndajë informacion dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi aspekte të ndryshme që kanë lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupet më vulnerabël, dhe rolit të rëndësishëm të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave themelore.

Në kuadër të 'Javës kundër diskriminimit' u mbajtën disa aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese në qytetet të ndryshme, si Malësi e Madhe, Bilisht, Lushnje dhe Tiranë. Këto aktivitete shërbejnë për të mbështetur zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përpjekjet e tyre për të rritur dukshmërinë dhe ndikimin e tyre në komunitetet e ndërlidhura, si në bashkitë ku ndodhen, ashtu edhe në zonat përreth tyre. Gjatë zbatimit të saj, 'Java kundër Diskriminimit' kontribuojë në rritjen e prezencës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkitë e vogla, ku nevoja për informacion dhe njohuri për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është më e madhe. Kjo nismë mbështetet nga programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal III" dhe projekti i tij "Përparimi i mbrojtjes nga diskriminimi në Shqipëri", i cili synon të forcojë kapacitetet e palëve të interesuara për të trajtuar mbrojtjen dhe promovimin e pakicave, mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI, dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes në përputhje me standardet dhe rekomandimet e vendosura nga Këshilli i Evropës.

Drejtësi gjinore

Studimit "Ndikimet e kornizës ligjore dhe praktikës së administratës publike tek barazia gjinore në elementët familjarë", në kuadër të Projektit: "Mbështetje për forcimin e kapaciteteve institucionale të KMD-së në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të promovuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit me lente gjinore". Ky studim u mundësua në kontekstin e Projektit: "Zgjerimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri", EFLAS, i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

- Përmes këtij studimi, në adresim të **Kuvendit të Shqipërisë** janë dhënë rekomandime për ndryshime legislative:
 - Së pari, ndryshime të Kodit të Familjes (neni 51) përsa i përket pamundësisë së bashkëshortëve që të mund të vendosin si mbiemër të përbashkët të familjes bashkësinë e mbiemrave të tyre. Ky realizim, jo vetëm do të bënte që Shqipëria të vendosej në linjë me standartet e vendosura nga organet politike dhe gjyqsore të Këshillit të Europës, por do të krijonte kushte më të drejta për vendosje të barazisë midis bashkëshortëve në projektimin e identitetit të tyre tek fëmijët.
 - Së dyti, ndryshime në Kodin e Familjes (neni 52) përsa i përket parashikimit sipas të cilit në rast mosdakordësie për mbiemrin e fëmijëve midis bashkëshortëve me mbiemra të ndryshëm, vendoset automatikisht mbiemri i babait. Kjo dispozitë duhet ndryshuar duke hequr atribuimin ex lege të mbiemrit të babait dhe duke parashikuar zgjidhjen gjyqsore të çështjes. Ky realizim do të shkëpuste përfundimisht parashikimin ligjor nga ndikimi i mendësisë patriarkale e cila dukshëm vendos në pozita të pabarabarta prindërit për shkak gjinie. Njëkohësisht, ndryshimi do ta vendoste dispozitën në rend logjik me parashikimet e vetë Kodit të Familjes, duke respektuar barazinë midis prindërve, si dhe duke e vendosur

- zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje në linjë me mënyrën më garantuese që kodi ka vendosur sidomos për garantimin i interesit më të lartë të fëmijës, që është zgjidhja gjyqsore.
- Së treti, ndryshimi i nenit 52 Kodi i Familjes të reflektohet edhe në dispozitat e Kodit që merren me rregullimin e mbiemrit për fëmijët e lindur jashtë martese (neni 171 KF) dhe fëmijëve të birësuar (neni 260 KF), pasi paraqesin të njejtën situatë dhe në përmbajtje identike.
 - Së katërti, në lidhje me konceptin e Kryefamiljarit në Ligjin Nr.10129, datë 11/05/2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, të ndryshohen nenet 16 dhe 17 që parashikojnë të drejtën për deklarimin e vendbanimit, në mënyrë që të përshtaten me nenin 55 të Kodit të Familjes i cili parashikon dakordësinë midis bashkëshortëve për zgjedhjen e vendbanimit.
 - Së pesti, rikonsiderimin e konceptit të Kryefamiljarit nëpër ligje të ndryshme që e përdorin duke e eliminuar atë.
- Në adresim të **Këshillit të Ministrave** janë dhënë rekomandime për rikonsiderim aktesh nënligjore sidomos në lidhje me konceptin e Kryefamiljarit dhe vendosjen e atësisë në dokumentat e identifikimit në marrëdhënie me administratën:
 - Së pari, rikonsiderim i konceptit të Kryefamiljarit duke e eliminuar atë, ose duke e njohur ekspresivisht në shumës dhe në vlerë të njejtë e të barabartë për të dy bashkëshortët, në të gjitha aktet nënligjore ku ky koncept figuron.
 - Së dyti, heqja e këtij koncepti nga dokumenti i gjendjes civile që korespondon me certifikatën familjare ose njohja e atributit në mënyrë të barabartë për të dy bashkëshortët.
 - Së treti, heqja e mënyrës së identifikimit të personit vetëm nëpërmjet atësisë në të gjithë aktet administrative të administratës publike.
 - Së katërti, sidomos në aktet administrative të arsimit që lidhen direkt me fëmijët dhe i shoqërojnë ato përgjatë gjithë cikleve të arsimit (ku përfshihen certifikatat, dëftesat, diplomat), heqja e këtij elementi të bëhet në mënyrë të menjëhershme.
 - Së pesti, vendosja e të dy komponentëve, mëmësi dhe atësi në të gjithë regjistrat shtetërorë ku përmbahen identitetet e personave.
 - Së gjashti, vendosja e të dy elementëve identifikues, mëmësi dhe atësi, në kërkesat dhe aplikimet e ndryshme të personave në administratën publike, ose moskërkimi për asnjërin na komponentët. Shembull i mirë për përfshirjen e mëmësisë dhe atësisë evidentohen në depozitimin e padive nëpër Gjykata apo dhe formulari i aplikimit për ankesë pranë KMD-së; ndërsa për mospërfshirjen e asnjërit nga këto komponentë, merret si shembull formulari i ankesave pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 - Për **Gjendjen Civile** janë adresuar rekomandimet si vijojnë:
 - Përpilimi i një formulari tip mbi marrëveshjen e prindërve për mbiemrin e fëmijëve ku të rezultojnë qartë dispozitat e KF dhe shprehja e vullnetit të tyre.

- Informimi i bashkëshortëve referuar parashikimeve që lidhen me të drejtën e tyre për mbiemrin e familjes, mbiemrin e tyre dhe mbiemrin e fëmijëve.
- Deri në ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore, administrate e gjendjes civile duhet ta ndërpresë atribuimin automatik të Kryefamiljarit me komponentin mashkull në certifikatën e familjes. Ky atribuim është krejtësisht produkt i sjelljes së administratës dhe i ndikimit të mendësisë shoqërore në këtë sjellje dhe nuk ka asnjë bazë ligjore mbi gjininë e Kryefamiljarit.
- Njëkohësisht, deri në ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore, administrata e gjendjes civile të rrisë informimin e bashkëshortëve gjatë kryerjes së aktit të martesës mbi konceptin e Kryefamiljarit dhe shprehjes së vullnetit të vetë bashkëshortëve në përcaktimin e certifikatës familjare.
- Kryerja e trajnimeve efektive të punonjësve të Gj.Civile sidomos në lidhje me implikimet gjinore të veprimeve të administratës të cilat nuk urdhërohen nga dispozitat e akteve normative.

Raportime të KMD

- Dërguar Ministrisë së Europës Për Punët e Jashtme kontributi i KMD-së mbi listën e çështjeve në kuadër të Raportit të V dhe VI për Shqipërinë për të Drejtat e Fëmijëve.
- Dërguar Drejtorisë së Raportimit propozime të Drejtorise Juridike mbi Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2023-2027.
- Dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informacionin në kuadër të Progres Raportit *"Mbi hartimin e kontributit të parë të progres raportit, për Kapitullin 19, "Politikat Sociale dhe Punësimi", 15 qershor 2022-15 mars 2023"*.
- Dërguar informacion Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të hartimit të raportit të FRA, me të dhënat e disponueshme si në nivel strategjik ashtu dhe të dhëna statistikore, lidhur me antisemitizmin, sipas një Pyetesori.
- Përgatitur informacion për Takimin e 14-të të Nënkomitetit BE-Shqipëri *"Drejtësia, Liria dhe Siguria"*.
- Përgatitur informacioni në kuadër të hartimit të Raportit të zbatimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, sipas *Pyetesorit për paraqitjen e informacioneve mbi hartimin e raportit të KDKPAK, për periudhën e raportimit: 2019-Qershor 2023*.
- Dërguar kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me Raportin e Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut, për vitin 2023, drejtuar Ambasadës Amerikane.³⁶
- Dërguar informacion mbi *"Kërkohet mendim mbi Projekt-Vendimin "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024 - 2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024 - 2026"*, drejtuar Ministrisë së Brendshme.³⁷

³⁶ Dërguar informacioni në email.

³⁷ Shkresë Nr. 1251/1 Prot., datë 16.11.2023 e KMD-së.

- Raportim mbi statusin aktual të rekomandimeve të dhëna në Progres Raportin e KE për vitin 2023, në kuadër të grupit të punës GNPIE, për kapitullin 2, "Lëvizja e lirë e punëtorëve".³⁸
- Dërguar informacion lidhur me kërkesën e MEPJ për "Raportin Tematik mbi Format bashkohore të Diskriminimit Racial, racizmi, ksenofobisë, intolerancës", te OKB-së.
- Dërguar kontribut Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme mbi Projekt-Raportin e Raportuesit të Posaçëm për të Drejtën për Zhvillim, z. Saad Alfarargi.
- Dërguar informacion lidhur me Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Parandalimin e luftës ndaj dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, Konventa e Stambollit".
- Dërguar kontribut, "Kërkohej kontribut mbi listën e çështjeve respektive, në kuadër të shqyrtimit të Raportit të V dhe të VI për Shqipërinë, për të Drejtat e Fëmijëve", drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Dërguar informacion , "Mbi monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje, dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025" Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për periudhën 2- vjeçare 2020-2022 mbështetur në masat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë Plan Veprimi.
- Përcjellë informacioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për "Kërkesë për Kontribut në kuadër të raportit tematik mbi format e diskriminimit bashkohore të diskriminimit, racizmit, ksenofobisë, intolerancës".
- Përcjellë informacioni i KMD për "Kërkesë për informacion mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit i personave LGBTI 2021-2027", për periudhën 1- vjeçare Janar- Dhjetor 2022 mbështetur në masat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë Plan Veprimi.
- Përcjellë informacioni i KMD mbi Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021-2025, lidhur me programin ROMALB.
- Përcjellë informacioni i KMD lidhur me kërkesën e MEPJ lidhur me Rezolutën 43/36 të K.D.NJ .
- Dërguar informacion në kuadër të hartimit të raportit të FRA, me të dhënat e disponueshme si në nivel strategjik ashtu dhe të dhëna statistikore, lidhur me antisemitizmin, sipas një Pyetesori të dërguar nga MD.
- Dërguar kontribut lidhur me hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të Ministrisë së Drejtësisë.
- Dërguar material lidhur me kontributin e Komisionerit për Raportin e Besimit Fetar 2023 të Departamentit Amerikan të Shtetit.

³⁸ Dërguar informacioni në email, datë 20.12.2023.

Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstitucionale.

GNPIE Kapitulli 23

KMD ka dy anëtare në Grupin Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të kapitullit “Kriteri Politik” dhe Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, për të cilin institucion lider është Ministria e Drejtësisë.

- *Analizë ligjore e përputhshmërisë me acquis*

KMD është përfshirë dhe ka kontribuar në procesin e përditësimit të LGA-ve/përputhshmërisë me acquis dhe IAGA-ve, për Kapitullin 23, ne tabelat ku KMD përfshihet, konkretisht:

1. Tabela e LGA-së, Të Drejtat Themelore Racizmi dhe Ksenofobia
2. Tabela e LGA-së, Të Drejtat Themelore Barazia Gjinore
3. Tabela e LGA-së, Të Drejtat Themelore, Të Drejtat e Pakicave
4. Tabela e LGA-së, Të Drejtat Themelore, Personat me Aftësi të Kufizuara
5. Tabela e LGA-së, Të Drejtat Themelore, Romët dhe Egjiptianët
6. Tabela e IAGA-së për nënkaptullin e Të Drejtave Themelore

Kontributi i KMD:

- Informacion i dërguar në kuader të “Kontributit të Pare të Qeverisë Shqiptare për raport e KE të vitit 2023 për Kapitullin 23”.
- Dërguar informacion për Takimin e 14-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”
- Pjesëmarrje në tryezën koordinuese për hartimin e Udhërrëfyesit/Roadmap për Shtetin e së Drejtës, zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë. Gjatë këtij takimi, të drejtuar nga zv/ministrja e Ministrisë së Drejtësisë dhe z/ministri i Ministrisë së Bredshme si drejtues të GNPIE për Kapitujt 23 dhe 24, u prezantua template i *Roadmap për Shtetin e së Drejtës*, i cili duhet plotësuar me objektiva, masa ligjore dhe institucionale nga institucionet përgjegës.
- Përgatitur informacion në kuadër të draft Roadmap/Udhërrëfyesit për “Të drejtat themelore dhe anti-diskriminimi”.

GNPIE Kapitullin 19

KMD ka dy anëtarë në Grupin Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të Kapitullit 2 & 19 “Punësimi dhe Politikat Sociale”, për të cilin institucion lider është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Kontributi i KMD:

- Informacion i dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të “Hartimit të kontributit të parë të progres raportit, për Kapitullin 19, “Politikat Sociale dhe Punësimi”.

- Informacion i dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me “Hartimin e kontributit të dytë të progres raportit, për Kapitullin 19 “Politikat Sociale dhe Punësimi”.
- Përgatitja e kontributit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të *takimit bilateral screening* për Kapitullin 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi" në prezantimin e RSH si më poshte sipas pikave të draft agendes për pjesën "Non discrimination in Employment and Social Policy":
 - 18.1 Equal Treatment
 - Direktivës 2000/43/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; (Direktiva për racën)
 - Direktivës 2000/78/KE “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”; (Direktivën për barazinë në punësim) Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimi.
 - 19. Equal Treatment in employment and social policy
 - Direktiva 2006/54/KE “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimi dhe marrëdhëniet gjatë punës” (Direktivat për barazinë gjinore). Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë.
- Pjesëmarrje në takimin periodik të Grupit të Punës për Kapitullin 19 + Platforma e Partneritetit, të drejtuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Pjesëmarrje në takimin Mock, të Kapitullit 19 “Politikat Sociale dhe Punësimi” akimet Mock, të Kapitullit 19.
- Pjesëmarrje online e një specialisti në rolin e mbështetës në takimin e mbajtur në Bruksel, 22-24 Maj 2023 - Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi”.

Pjesë e Grupit Nderistitucional të punës për Strategjinë Ndersektorale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024 – 2030

Pjesë e Grupit Ndëristitucional të punës për Strategjinë Ndërsektorale e Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026.

KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë

Equinet është Rrjeti European i Organeve të Barazisë, i cili promovon barazinë në Europë duke mbështetur organet e barazisë për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar barazi për të gjithë. Nëpërmjet Equinet, anëtarët e saj, institucione kombëtare barazie, sikundër është dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndajnë dhe shkëmbejnë ekspertizën e tyre në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, në nivel evropian si dhe mësojnë nga sukseset e arritura dhe sfidat me të cilat përballen, gjatë zbatimit të mandatit të tyre në nivel kombëtar.

Objektiv kryesor i Rrjetit është mbledhja e informacionit dhe krijimi i njohurive të reja mbi barazinë dhe mosdiskriminimin që para së gjithash mund të ndihmojnë anëtarët të përmirësojnë më tej praktikën e tyre në nivel kombëtar. Kjo njohuri vjen nga vetë anëtarët dhe përvoja e zbatimit të mandatit të tyre në nivel kombëtar.

Çdo vit, organizohet Mbledhja e Përgjithshme Vjetore (AGM) e Equinet për të diskutuar dhe marrë vendime për çështje të rëndësishme si dokumentet strategjik, raportet e aktiviteteve, aderimi i anëtarëve të rinj etj.

Strukturat e Equinet, të cilave u është deleguar menaxhimi i përgjithshëm i aktiviteteve, janë Bordi Ekzekutiv dhe Sekretariati i Equinet. Bordi Ekzekutiv është organi menaxhial i rrjetit dhe konkretisht është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe udhëheqjen strategjike të Equinet. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga nëntë përfaqësues të anëtarëve të Equinet të zgjedhur për një mandat dy vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve dhe kryesohet nga një Kryetar. Ai punon për të mbështetur punën e anëtarëve të Equinet dhe pozicionimin e tyre në nivel evropian dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të planeve të punës. Ai gjithashtu synon zhvillimin e vizioneve strategjike për të garantuar fuqinë, rritjen dhe qëndrueshmërinë e Rrjetit. Ai gjithashtu mbikëqyr punën e Sekretariatit të Equinet, i cili është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara ndërmjet anëtarëve, duke kontribuar në rëndësinë unike të përvojës së organeve kombëtare të barazisë.

Gjatë vitit 2023, stafi i KMD është përfshirë në grupet e punës së Equinet, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimime të praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Evropës, konkretisht në:

- Në kuadër të Grupit të Punës "Equality Law Group" u dërguan me email propozimet e KMD-se, lidhur me studimin e EQUINET me teme: "*Equality Bodies working on cases Without an identifiable victim: Actio popularis*".
- Pjesëmarrje në takimin e grupit të punës së EQUINET "Research & Data Collection", si dhe në trajnimin për diskriminimin ndërsektorial dhe diskriminimin e shumëfishtë, zhvilluar në Bruksel.
- Sipas kërkesës së Equinet, plotësuar me të dhënat sipas ligjit shqiptar formulari me titull: "*Equality Bodies Making Recommendations*".
- Sipas kërkesës së Equinet, plotësuar me të dhënat sipas ligjit shqiptar formulari me titull: "*Questionnaire mediation/reconciliation, National Equality Bodies*".
- Equinet WG "Research and data collection".
- Pjesëmarrje në mbledhjen e Equinet lidhur me Projektin për Standartet e Organeve të Barazisë.
- Pjesëmarrje në mbledhjen e grupit të punës për Hartimin e Politikave.
- Plotësuar dhe dërguar me e-mail formulari me teme: "*Equality Bodies Making Recommendations*".
- Plotësuar dhe dërguar me e-mail, formulari me teme: "*Questionnaire mediation/reconciliation, National Equality Bodies*".

Trajnime dhe Webinare

Gjatë vitit 2023, Stafi i KMD-së ka qenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga vetë Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, apo në bashkëpunim me institucione apo OJF të ndryshme:

- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: “How can National Human Rights Institutions and Equality Bodies engage with the European Committee of Social Rights under the reporting procedure of the European Social Charter”, të organizuar nga ENNHRI dhe EQUINET.
- Pjesëmarrja në aktivitetin e organizuar nga ILO, me temë “Eliminimi i dhunës dhe ngacmimit në botën e punës-në veprim”.
- Pjesëmarrje në aktivitetet e FRA mbi zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.
- Pjesëmarrje në trajnimin për marrëveshjen e bashkëpunimit mes ISHPSHS me KMD-në, me temë: “Kuatru ligjor, standardet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare e ndërkombëtare lidhur me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin e ndërveprimit të institucioneve inspektuese/monitoruese”.
- Pjesëmarrje në aktivitetet e FRA mbi zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, lidhur me temat “Zbatimi i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së në nivel kombëtar: çështjet, potencialet, sinergjitë nga këndvështrimi i IKDNJ”, si dhe përdorimin e Kartës së BE-së në procedurat gjyqësore.
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Komisioneri pranë Shkollës së Magjistraturës.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë “Kuatru ligjor, standardet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare e ndërkombëtare lidhur me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin e ndërveprimit të institucioneve inspektuese/monitoruese”, referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KMD dhe ISHPSHS, financuar nga ILO.
- Pjesëmarrje në takimin informues zhvilluar në Hotel Plaza, Tiranë, me temë “Fenomeni i diskriminimit, dhunës e ngacmimit si çështje e sigurisë dhe e shëndetit në punë. Roli i aktorëve”, referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KMD dhe ISHPSHS, financuar nga ILO.
- Pjesëmarrje në trajnimin e zhvilluar në Pogradec, me temë: “Inspektimi dhe monitorimi me fokus dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe zbatimin e detyrimeve të ILO 190 C”, referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KMD dhe ISHPSHS, financuar nga ILO.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar në Pogradec, me temë: “Shqyrimi i ankesave lidhur me diskriminimin, ngacmimin dhe dhunën në botën e punës dhe mjetet efektive me qëllim zbatimin e nenit 10/h të Konventës 190 të ONP mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës të tilla si: autorizimi për të trajtuar dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë lëshimin e urdhrave që kërkojnë marrjen e masave me forcë ekzekutive të menjëhershme; urdhra për të ndaluar punën në rastet e një rreziku të

- afërt për jetën, shëndetin ose sigurinë, etj.”, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KMD dhe ISHPSHS, financuar nga ILO.
- Pjesëmarrje në Konferencën me temë: “Towards gender equality in Europe”, zhvilluar në Bratislavë, Sllovaki, organizuar nga Qendra Kombëtare Sllovake për të Drejtat e Njeriut.
 - Pjesëmarrje në sesionin trajnues dhe sesionin përgatitor simulues (mock session) të dialogut me komitetin e CEDAW, që do të zhvillohet në Hotel Rogner, në lidhje me Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit”, si parapërgatitje për shqyrtimin e raportit që do të mbahet në Gjenevë.
 - Pjesëmarrja në trajnimin me teme: Rritja e aksesit cilësor në sistemin e drejtësisë për individët LGBTIQ+, duke rritur ndërgjegjësimin, nivelin e njohurive dhe proaktivitetin e autoriteteve shtetërore, institucioneve të pavarura dhe organeve të tjera ligj zbatuese, organizuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI, Shqipëri dhe KMD.
 - Pjesëmarrje në Workshop mbi Aksesin në Drejtësi për personat LGBTI në Ballkanin Perëndimor, në Hotel Rogner, Tiranë.
 - Pjesëmarrje në aktivitetin (Forum i Hapur) me temë “Advokim për ndryshim: Ndhima juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupet në nevojë”, zhvilluar në ambientet “Shtëpia e Evropës” Tiranë, organizuar nga Shoqata “Të ndryshëm & të barabartë”.
 - Pjesëmarrje në Konferencën me temë: “Towards gender equality in Europe”, zhvilluar në Bratislavë, Sllovaki, organizuar nga Qendra Kombëtare Sllovake për të Drejtat e Njeriut.
 - Pjesëmarrje në konferencën vjetore me temë: “Së bashku në një bilanc vjetor të arritjeve dhe përvojave në lidhje me reduktimin dhe eliminimin e diskriminimit, dhunës e ngacmimit në botën e punës”, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KMD dhe ISHPSHS.
 - Pjesëmarrje në tryezën vjetore me rastin e ditës së të drejtave të njeriut, organizuar nga OSCE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri), në Hotel Rogner.
 - Pjesëmarrje në prezantimin e Draft Kodit Penal, në Ministrinë e Drejtësisë.
 - Pjesëmarrje në aktivitetin e nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit të rishikuar ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale dhe Komisionerit për Antidiskriminim.
 - Pjesëmarrja në aktivitetin e organizuar nga ILO, me temë “Eliminimi i dhunës dhe ngacmimit në botën e punës-në veprim”.
 - Pjesëmarrje në aktivitetin e FRA, me teme: *Charterpedia and EFRIS: FRA’s one-stop-shop on the EU Charter of Fundamental Rights and international human rights conventions.*
 - Përfaqësimi i KMD në aktivitetin **Inclusion4Schools Policy Lab**, që u zhvillua në CEU Central European University, në Budapest, Hungari. Tema e trajtuar nga ana e përfaqësueses së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishte: “*Adresimi i segregimit në arsimin përmes Komisionerit Antidiskriminim të Shqipërisë*”. Kryesisht, u evidentua roli i Komisionerit në adresimin e segregimit, vendimet dhe masat e

urdhëruara për eliminimin e segregimit në shkolla si dhe vendimi i Gjykatës së Strasburgut (GjEDNj) lidhur me çështjen *X dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, përmes të cilit është gjetur shkelje e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe është akorduar dëmshpërblimi i kërkuarve, si pasojë e segregimit.

- Pjesëmarrje në konferencën permbyllëse të KMD në kuadër të Projektit të UNDP, ku u bë prezantimi i studimit "*Gender implication on the identity of the person in the public administration activity*", Tiranë.
- Pjesëmarrje në Konferencë Rajonale mbi Krimin e Urrejtjes në Evropën Juglindore, me temë: "*Ndërlidhja midis krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes: sfidat dhe zgjidhjet*", organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.
- Përfaqësimi i KMD në Takimin e 14-të të Nënkomitetit BE-Shqipëri "*Drejtësia, Liria, Siguria*".

11. Programi i transparencës

Në përputhje me programin e transparencës, KMD ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit

www.kmd.al, vendimet për diskriminim dhe mosdiskriminim, nga ankesat individuale dhe nga hetimet kryesisht.

Në dispozicion të publikut në faqen zyrtare janë të gjitha rekomandimet e KMD-së dhe vendimet e Gjykatave.

KMD publikon në faqen zyrtare kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KMD-së dhe Zyrave Rajonale, orarin zyrtar.
- Funkcionin dhe kompetencat e KMD
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë ankesë për diskriminim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e ankesave.
- Kuadrin ligjor, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore.
- Raportet e KMD
- Aktivitetet ndërgjegjësuëse dhe informuese të organizuara nga Zyra e KMD-së,
- Takimet e Komisionerit
- Marrëveshjet e bashkëpunimit
- Strukturën organizative të KMD-së;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, orarin e punës, emrin dhe kontaktete koordinatorit për të drejtën e informimit; regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të programit të transparencës.


V. ZYRAT RAJONALE

1. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë

Gjatë vitit 2023 kjo zyrë ka organizuar ditëve të hapura me publikun me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore; Promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim. Kanë qenë të pandërprera takimet dhe bashkëpunimi me përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore, si dhe takimet e zhvilluara në terren me kategori të veçanta dhe grupe në nevojë.

Zyra Rajonale Korçë (në vijim ZR) ka pritur çdo ditë qytetarë të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me problematikat dhe diskriminimin që ata hasin kryesisht në fushën e marrjes së shërbimeve. Gjatë vitit 2023:

- 26 (njëzet e gjashtë) ankesa janë përcjellë për regjistrim në DPA
- 25 (njëzet e pesë) raste i janë referuar përfaqësueses së Avokatit të Popullit;
- 9 (nëntë) raste i janë referuar Qendrës TLAS (marrje kujdestarie; çelje numër llogarie për nxënësit përfitues të bursës pranë shkollës “Naim Frashëri” dhe “Asdreni”; regjistrim fëmije në Zyrën e Gjendjes Civile).
- 15 (pesëmbëdhjetë) raste i janë referuar Zyrës së Ndihmës Juridike Falas në Korçë&Pogradec.



Grafiku 32: Veprimtari të Zyrës Rajonale Korçë

Falë praktikës së ndërmjetësimit me institucionet lokale 65 (gjashtëdhjetë e pesë) raste janë referuar dhe kanë gjetur zgjidhje, si më poshtë:

- 10 (dhjetë) raste për lidhje të ndihmës ekonomike;
- 25 (njëzet e pesë) raste ofrim ndihme në marrjen e shërbimit pranë E-Albania, (terheqje dokumentacioni, certifikatë pranë Bashkisë etj.).
- 3 (tre) raste në rilidhjen e marrëveshjes me Ujësjiellës-Kanalizime Korçë (UKKO) dhe qytetarë debitorë pranë kësaj shoqërie.
- 1 (një) rast ofrim ndihme, plotësim dokumentacioni, ndërmjetësim për rimarrjen e nënshtetësisë shqiptare, humbur në moshë të vogël;
- 15 (pesëmbëdhjetë) raste ofruar ndihmë për regjistrim si punëkërkuar të papunë;
- 10 (dhjetë) personave që gëzojnë statusin e të verbrit janë ndihmuar duke ndërmjetësuar me institucionet për zgjidhjen e problematikave të tyre kryesisht për tërheqjen dhe plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës nga Universiteti ose shkollat e mesme, si dhe përfitimin e ndihmës ekonomike për familjarët e tyre.
- 1 (një) anëtar i komunitetit LGBT+ është mbështetur në zgjidhjen e problematikës së përfshirjes në skemën e ndihmës ekonomike; regjistrimi si punëkërkuar i papunë dhe më pas referuar dhe pranë qendrës "Streha" në Tiranë.

Pjesë e punës dhe detyrave të ZR kanë qenë:

- Emaille dhe telefonata pune me institucionet përgjegjëse për rastet e paraqitura nga qytetarë të ndryshëm.
- Ofrim asistence dhe ndihmë në plotësim dokumentacioni për ankesat e dërguara.
- Ndërmjetësime dhe referime rastesh pranë Avokatit të Popullit dhe Zyrës së Ndihmës Ligjore Falas.
- Takime me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve për rastet e paraqitura për ndërmjetësim në zgjidhjen e tyre.
- Gjatë muajit tetor-dhjetor 2023 specialisti e ZR Korçë ka kryer një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve të bashkiake, përgjegjës për zbatimin e VKM 511, datë 27.07.2022 (i ndryshuar) "Për përfitimin e bursave të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar", për shkak të ankesave të shumta që qytetarët kanë paraqitur pranë ZR Korçë. Bursa është përfituar vitin e shkuar akademik dhe nuk është aplikuar për këtë vit edhe pse VKM-ja është detyruese dhe është në fuqi.

Aktivitete të organizuara nga Zyra Rajonale Korçë**Shkurt**

- Në kuadër të javës kundër diskriminimit KMD dhe ZR zhvilluan një takim në Bashkinë Devoll për të prezantuar punën e institucionit dhe diskutuar zgjidhjen e problematikave në bashkëpunim me pushtetin lokal.
- Takim me përfaqësues të Universitetit “F.S Noli” Korçë, me synim diskutimin e problematikave të studentëve dhe zgjidhjet që mund të ofrojë ZR dhe KMD.

Mars

- Takim me përfaqësues të institucioneve dhe mësues të shkollës “NaimFrashëri”. Problematika e segregimit të kësaj shkolle dhe masat që do të duhen të merren.
- Takim me përfaqësuesit e Shoqatës së të Verbërve Korçë për të folur mbi sfidat e shumta që has kjo kategori në marrjen e shërbimeve dhe të pagesave.

Prill

- Takim me koordinatoren e ERRRC(Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve) për të folur mbi çështjen e segregimit të shkollës “Naim Frashëri”, vendimin e Gjykatës së Strasburgut, hapat që po ndërmerren nga institucionet përgjegjëse.
- Takim me vëzhgues të OSCE&ODHIR, me të cilët u diskutuan problematikat dhe diskriminimi që haset gjatë procesit zgjedhjeve.

Maj

- ZR në bashkëpunim me TLAS zhvilluan një takim me familjarë që hasin vështirësi në hapjen e një llogarie bankare për tërheqjen e bursës së fëmijëve për shkak të problematikave të shumta sociale.
- Takim me studentë të Universitetit “F.S Noli”. Aktivitet i organizuar nga Zyra e KMD Tiranë.

Qershor

- Takim me përfaqësues të Shoqatës së të Verbërve dega Korçë për të diskutuar mbi referimin e rasteve të diskriminimit në marrjen e shërbimeve.
- Takim informues dhe ndërgjegjësues me drejtues dhe prindër të shkollës “Naim Frashëri”.

Korrik

- Pritur në takim përfaqësues të OSBE me fokus diskriminimin, shkelja e të drejtave të njeriut, rastet e ndjekura nga KMD, efektiviteti i vendimeve etj.
- Pritur në takim përfaqësues të shoqatës “Unë gruaja” për të diskutuar mbi bashkëpunimin e ndërsjellë për çështje që lidhen me barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave.

Shtator

- Organizuar “Ditë e hapur” informimi dhe ndërgjegjësimi, pranë Qendrës Komunitare Bilisht, pjesëmarrjen e të rinjve dhe pjestarë të familjeve në nevojë.

Tetor

- Takim me përfaqësues të OSBE për të diskutuar mbi rastet e diskriminimit në Qarkun e Korçës, shkaqet, format dhe fushat më problematike.
- Organizuar “Ditë e hapur” informimi dhe ndërjegjësimi me banorët e lagjes nr. 10, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të OSBE.
- Takim kryetarin e Bashkisë Pustec, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të OSBE dhe Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Pogradec, për të folur mbi të drejtat e pakicave minoritare, përfshirë komunitetin maqedonas, pjesë e kësaj bashkie.
- Zhvilluar takim me përfaqësues të DRAP Korçë, për të diskutuar ecurinë e zbatimit të planiët të veprimit në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së për segregimin e shkollës “Naim Frashëri”.
- Takim me përfaqësuesen e ERRC (European Roma Rights Centre) për të diskutuar zbatimin e planit të masave për desegregimin e shkollës “Naim Frashëri”.
- Takim me drejtues të Drejtorisë së Strehimit Korçë me qëllim diskutimin e problematikave të pazgjidhura të strehimit dhe përfitimin e bonusit të qerasë për familjet në nevojë.

Nëntor

- Në kuadër të 20 nëntorit “Ditës së të drejtave të fëmijëve”, ZR dhe KMD, në bashkëpunim me shkollën e mesme të përgjithshme “Fuat Babani” në Devoll organizuan takimin me temë: “Të njohim të drejtat tona”.

Dhjetor

- Takim informues i organizuar nga ZR, në kuadër të mbylljes së fushatës “16 ditë të aktivizmit kundër dhunës” me nënat dhe fëmijët e arsimit parauniversitar.

Pjesëmarrje e Zyrës Rajonale Korçë, në aktivitete institucionale

Janar

- Aktiviteti organizuar nga AMA me temë: “Rëndësia dhe veçoritë e procesit të rishikimit të kodit të transmetimit”.
- Aktivitet i organizuar nga Dorcas me temë: “Çështjet kryesore të moshimit, instrumentat e matjes së nevojave për të moshuarit, elementet e kujdesit të integruar dhe reformat më të fundit në fushën e kujdesit për të moshuar në vendin tonë”.
- Webinarin me temë: "Ndihma juridike falas", organizuar nga ASPA.

Shkurt

- Aktivitet i organizuar nga World Vision, në kuadër të 20 shkurtit “Ditës Ndërkombëtare të Drejtësisë Sociale”, me temë: “Të drejta të barabarta - Mundësi të barabarta”.

- Takim koordinues me përfaqësues të KE-së, BE-së, Ministrisë së Arsimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatura e Shtetit etj., për të diskutuar mbi planin e veprimit në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së për segregimin e shkollës “Naim Frashëri”.

Mars

- Takim i mbështetur nga UNICEF, me Komitetin Drejtues të Arsimit Parauniversitar pranë Bashkisë Korçë për të diskutuar mbi efektshmërinë e shërbimeve për nxënësit dhe fëmijët.

Prill

- Pjesëmarrje në grupin e dialogut social, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme pranë Bashkisë Korçë, në kuadër të implementimit të planit të veprimit "Korça, bashki mike e fëmijëve", mbështetur nga UNICEF.
- Aktivitet i organizuar nga Bashkia Pogradec, në kuadër të 8 prillit “Ditës Ndërkombëtare të Romëve”.
- Aktivitet i organizuar nga Bashkia Korçë, në kuadër të 8 prillit “Ditës Ndërkombëtare të Romëve”.
- Pjesëmarrje në prezantimin e projektit për hartimin e planit të ri social, 2023-2026, organizuar nga Bashkia Korçë, me synim planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shërbimeve të mirëqënies sociale.
- Pjesëmarrje në tryezën me temë: “Takime sindikale mbi të drejtat e punëtorëve LGBTI+”, organizuar nga OMSA.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Forumi i shkollës së hapur. Eventi 3 në Korçë”, organizuar nga Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë, me mbështetjen e KE-së.

Maj

- Takim online me temë: “Të rrisim aksesin në drejtësi në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale”, organizuar nga TLAS.
- Aktivitet i organizuar nga OMSA në bashkinë Pogradec, ku merrnin pjesë përfaqësuesi i Avokatit të Popullit dhe anëtarë të sindikatave.
- Ëëbinar ASPA, me temë: “Antixhipsizmi-Diskriminim i akumuluar kundrejt Romëve dhe Egjiptianve”.
- Takim i organizuar nga Fondacioni “Misioni Emanuel”, me temë: “Rritja, fuqizimi ekonomik i grupeve vulnerabël”.
- Konferencë Kombëtare Studentore organizuar nga universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, në bashkëpunim me “Fakultetin e Shkencave Sociale, Tiranë dhe universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, me temë: “Roli i gruas në shoqëri dhe sfidat e barazisë gjinore”.

Qershor

- Takim i organizuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë, me OJF që mbrojnë të drejtat e njeriut.
- Takim me përfaqësues të Projektit “Inclusion4Schools”, lidhur me situatën e shkollave në rrezik segregimi. Rasti i shkollës Naim Frashëri.
- Ëorkshop onlinei organizuar nga Kongresi Rinor me temë: “Manifest for young people by young people to shape the European Cooperation Policy”.
- Pjesëmarrje në takim in e Dialogut Social, organizuar nga Bashkia Korçë.
- Takim mes institucioneve organizuar nga UNDP mbi hartimin e planit social të veprimit, Bashkia Korçë.
- Forum i organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim me qendrën A.L.T.R.I dhe Friends of Europe me fokus: “Krijimi i urave për rrjetëzim dhe bashkëpunim midis OSHC-ve, qytetarëve dhe aktorëve të interesit në luftën kundër korrupsionit, forcimin e shtetit të së drejtës dhe mirëqeverisjen!”.
- Aktiviteti organizuar nga Bashkia me rastin e 24 qershorit, “Dita e Egjiptianëve të Ballkanit”.
- Aktivitet i organizuar nga WorldVision. Dokumentar dhe ekspozitë fotografike ku shpalos puna dhe projekte të zbatuara ndër vite në Qarkun e Korçës.
- Aktivitet i zhvilluar në Bashkinë Devoll me OJF dhe përfaqësues të institucioneve lokale dhe ato qendrore, me fokus “Integrimi i të rikthyerve nga emigracioni”.

Korrik

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në Bashkinë Pogradec dhe Korçë, me fokus diskutimin me banorët e godinës së Alb-Miniera, Pogradec dhe banorët e zonës së njohur si “Gjeologjikia” Korçë. Ndjekja e rasteve nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë me mbështetje të ROMACTED, për të diskutuar mbi rastin e segregimit të shkollës “Naim Frashëri” dhe masat që duhet të merren për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Strasburgut.

Shtator

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga shoqata “Gruaja në Zhvillim” në Korçë, me qëllim informimin e të rinjve me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyrat Rajonale të KMD dhe misioni i tyre.
- Konferencë Rajonale në Budapest me pjesëmarrjen e vendeve Bullgari, Slloveni, Shqipëri, Hungari. Tema e trajtuar ishte “Segregimi i shkollave në nivel rajonal”.

Tetor

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Bashkia Korçë lidhur me hartimin e Planit Social të Veprimit, mbështetur nga UNDP.

- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar në Bashkinë Devoll në kuadër të fushatës ndërkombëtare "Tetori rozë", me nxënës të gjimnazit "Fuat Babani".
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Antixhopsizmi-diskriminim i akumuluar kundrejt romëve dhe egjiptianëve", organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët organizuar nga Shërbimi Ligjor Falas, TLAS, në kuadër të projektit për fëmijët që jetojnë në kushte vulnerabiliteti, të cilët duhet të përfitojnë mbështetje ligjore falas.
- Pjesëmarrje në grupin e punës për bashkërendimin e vizitave monitoruese ndërmjet ISHPSHSHS-së dhe KMD-së në rajonin e Korçës.

Nëntor

- "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave", organizuar nga Bashkia Pogradec dhe Drejtoria e Shërbimit Social.
- Pjesëmarrje në aktivitetin organizuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, në kuadër të Ditës së të Drejtave të Njeriut, me përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe OSBE.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Qyteza e Fëmijëve në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe shkollën "Raqi Qirinxhi", shoqëruar nga ekspozita e pikturës "Të drejtat në telajo", me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve.

Dhjetor

- Pjesëmarrje në seminarin me temë: "Nxitja e praktikës së arsimit gjithëpërfshirës në shkolla" organizuar nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome në bashkëpunim me Projektin e Përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian me synim shkëmbimin e ideve mbi aplikimin më efektiv të praktikave të arsimit gjithëpërfshirës dhe krijimin e një platforme bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve në qytetin e Korçës.
- Pjesëmarrje në prezantimin e modelit të Qendrës së Shërbimeve Rinore me një Ndalesë për të rinjtë në Bashkitë Korçë, Devoll, Pogradec dhe Maliq".


Pasqyrim ne media

- Në datën 8 prill ftuar në RTV Korça.
- Në dt 24 qershor ftuar në RTV Korça.
- Intervistë pranë RTSH Korca. // www.youtube.com/watch?v=umG880Bmo2s

2. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër

Zyra Rajonale Shkodër ka pritur çdo ditë qytetarë të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me problematikat dhe diskriminimin që ata hasin kryesisht në fushën e marrjes së shërbimeve. Gjatë vitit 2023:

- 29 (njëzet e nëntë) ankesa janë përcjellë për regjistrim në DPA;
- 5 (pesë) raste i janë referuar përfaqësuesit të Avokatit të Popullit;
- 4 (katër) raste i janë referuar Zyrës së Ndhmës Juridike Falas në qytetin e Shkodrës.



Grafiku 33: Veprimtari të Zyrës Rajonale Shkodër

Gjatë vitit 2023 specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka informuar/këshilluar dhe referuar në zyrat përkatëse 29 (njëzet e nëntë) qytetarë për problematikat si më poshtë:

- 1) Problematika e njohjes së viteve të punës për daljen në pension.
- 2) Tërheqja e certifikatës së pronësisë
- 3) Përgatitje shkresë drejtuar Zyrës së Përmbartimit Shkodër, për ekzekutimin e një vendimi të gjykatës.
- 4) Tërheqjen e certifikatave të vdekjes për persona të afërt dhe procedura e çeljes së trashigimisë.
- 5) Orientim mbi shkallët e ankimit në gjykatë që duhet të ndjek një qytetar, kur i janë rrëzuar pretendimet e kërkesë padisë.
- 6) Mënyrën e aplikimit online për denoncimin e humbjes së mjeteve të indentifikimit.
- 7) Mbi procedurat e regjistrimit të pronës.
- 8) Për përfitimin e ndihmës ekonomike.

- 9) Për mënyrën e marrjes së autorizimit ish-bashkëshorti, në rastet e lëvizjes me fëmijën jashtë vendit.
- 10) Këshillim mbi procedurën e rivendosjes në afat, me qëllim aplikimin për e pensionit të pleqërisë.
- 11) Procedura që duhet ndjekur për regjistrimin e pronës.
- 12) Procedurës e nxjerrjes së vërtetimit negativ të pensionit.
- 13) Mbi mënyrën e zgjidhjes së problematikës me Ujësjellës-Kanalizime Shkodër. Rasti i është referua Zyrës së Avokatit të Popullit.
- 14) Aplikimin online përmes ealbania, për përfitimin e pensionit të pleqërisë.
- 15) Zgjidhjen e problematikës së faturave të ujit.
- 16) Mbi mënyrën e ankimit kundrejt kompanisë ajrore, në rastin e shtyrjes së fluturimit.
- 17) Për procedurën e regjistrimit të fëmijëve.
- 18) Informim mbi efektshmërinë e një prokure të përgatitur jashtë vendit për të aplikuar për marrjen e pasaportës për fëmijë të mitur.
- 19) Orientim për të bërë denoncimin e humbjes së mjetit të identifikimit në E-Albania.
- 20) Mbi mënyrën e tërheqjes së shumës së kompensuar nga shteti si ish pronar. Referua Avokatit të Popullit.
- 21) Informim mbi procedurën e strehimit social. Referuar si rast drejtorisë përkatëse në Bashkinë Shkodër.
- 22) Nxjerrje vërtetimi lidhur me kontributet e derdhura ndër vite për efekt pensioni.
- 23) Orientim studentësh në lidhje me vonesat e bursave. Referuar zyrës përkatëse në Bashki.
- 24) Për ndjekje procedure gjyqësisht në lidhje me të drejtat e pronësisë.
- 25) Procedura që duhet ndjekur për privatizimin e banesës nga Enti i banesave.
- 26) Referim rasti tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit dhe të Dhënave Personale për mos marrje informacioni.
- 27) Kundërshtimi gjyqësisht për rastet e heqjes së Kempit. Referua Zyrës për Ndhimë Juridike Falas.
- 28) Informim mbi procedurën e çregjistrimit të një familjari të vdekur.
- 29) Mbi zgjidhjen e problemit të marrjes në kujdestari të fëmijës (nipit) së mitur që jeton jashtë vendit. Rast i referuar pranë Zyrës për Ndhimë Juridike Falas.

Gjatë vitit 2023 specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar detyra të ndryshme çdo ditë si më poshtë:

- Specialisti ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me ankues dhe ka realizuar takime të vazhdueshme për çdo informacion dhe asistencë që ato kanë pasur nevojë.
- Specialisti ka ndihmuar inspektorët e çështjeve pranë KMD, lidhur me çdo informacion që ato kanë pasur nevojë për shqyrtimin e ankesës.
- Specialisti ka dërguar emaile, ka bërë telefonata pune me përfaqësues të institucioneve lokale dhe të organizatave të shoqërisë civile.

- Specialisti ka referuar raste pranë Avokatit të Popullit dhe Zyrës së Ndihmës Ligjore Falas dhe ka diskutuar disa raste dhe problematika me përfaqësuesit e zyrave të sipër cituara.
- Pjese e detyrave të specialistit ka qënë dhe përgatitja e raporteve të ndryshme sipas kërkesave të institucionit që e ka kërkuar.

Zyra Rajonale Shkodër bashkëpunon dhe mban kontakte të vazhdueshme me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2023 pranë Zyrës Rajonale Shkodër kanë realizuar praktikën mësimore 3 (tre) studente të Fakultetit të Shkencave Sociale dega Punë Sociale në Universitetin Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Studentët janë përfshirë në realizimin e detyrave të ndryshme si dhe kanë marrë pjesë në disa aktivitete ku përfaqësuesi i Zyrës Rajonale ka qënë i ftuar.

Aktivitete të organizuara nga Zyra Rajonale Shkodër

Janar

- ZR ka iniciuar një vizitë me studentë praktikantë, pranë Zyrës për Ndihmës Ligjore Falas në qytetin e Shkodrës, me synim informimin e tyre për mbështetjen dhe shërbimet që ofron kjo Zyrë.

Shkurt

- Takim me përfaqësuesen e Shoqatës "Projekti Shpresa" në qytetin e Shkodrës, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e ZR në aktivitetin e datës 20 shkurt, organizuar nga kjo shoqatë.
- "Java kundër diskriminimit"-Aktivitet i organizuar në Bashkinë Malësi e Madhe, me pjesëmarrjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- "Java kundër diskriminimit"-Aktivitet i organizuar në Gjimnazin "Sherif Hoxha", në Bashkinë e Malësisë së Madhe, me nxënës të këtij gjimnazi.

Mars

- ZR në bashkëpunim me organizatën "Intelektualët e Rinj, Shpresë", ka realizuar një takim/ bashkëbisedim me nxënës të shkollës "28 Nëntori" në qytetin e Shkodrës me temë: "Parimi i Barazisë dhe Kontrata Sociale".
- ZR në bashkëpunim me organizatën "Intelektualët e Rinj, Shpresë", ka realizuar një takim/bashkëbisedim me nxënës të shkollës në shkollën "Shejnaze Juka" në qytetin e Shkodrës me temë: "Parimi i Barazisë dhe Kontrata Sociale".
- Takim prezantues i ZR Shkodër me drejtuesin e ri të OSHKSH Shkodër (Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetsor).
- Takim me drejtuesen e sektorit që mbulon rastet e dhunës në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, me synim bashkëpunimin për referimin e rasteve të diskriminimit në institucionin e KMD përmes ZR Shkodër.

- Takim me juristët e Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas ku u diskutua për referimin e rasteve të diskriminimit në institucionin e KMD përmes ZR Shkodër.

Prill

- Takim me koordinatoren e projektit “ACTIVE-Komunikim i Aksesueshëm drejt Përfshirjes së Personave të Cënueshëm dhe të Përrjashtuar në Ballkanin Perëndimor”.
- Takim me përfaqësues të organizatës “Save the Children” Shkodër për të folur mbi mundësitë e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, me fokus mbrojtjen nga diskriminimi.
- Takim informues me të rinj realizuar në bashkëpunim me organizatën “Save the Children”.

Maj

- Aktivitet i organizuar nga KMD&ZR Shkodër dhe Shkolla e Magjistraturës, me temë: “Parimi i barazisë, mosdiskriminimit dhe krimet e urrejtes”.

Qershor

- Pritur në takim përfaqësuesi i institucionit homolog të Ombudsman-it të Austrisë, në kuadër të projektit të përbashkët të bashkëpunimit me Avokatin e Popullit në vendin tonë. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i sfidave të Zyrat Rajonale të KMD-së dhe Avokatit të Popullit dhe vijueshmëria e bashkëpunimit për forcimin e kapaciteteve profesionale të këtyre zyrave.
- Organizimi aktivitetit të KMD me Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me teme: “Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit”. Leksion i hapur me studentët.

Korrik

- Takim në bashkëpunim me Zyrën për Ndihmë Ligjore Falas për të diskutuar mbi fushat ku qytetarët hasin më shumë pengesa dhe diskriminim. Diskutimi i vendimeve të KMD dhe efektshmëria e tyre.

Gusht

- Gjatë muajit gusht, Zyra Rajonale ka pritur qytetarë të interesuar për të marrë informacion mbi institucioni, si dhe dhe ankues të interesuar mbi vijueshmërinë e çështjeve të tyre në hetim administrative nga KMD.

Shtator

- Takim pune online i Drejtorisë së Pritjes së Ankesave me Zyrat Rajonale.

Tetor

- Janë zhvilluar dy takime radhazi me përfaqësuesen e shoqatës “Dimensioni human” për referimin e dy rasteve diskriminimi.

Nëntor

- Takim me drejtoreshën e DRSHSSH Shkodër për të diskutuar rreth problematikave të ndryshme të ngritura nga qytetarët si dhe ankesat e paraqitura nga Fondacioni “Së bashku” për pamundësinë e aksesueshmërisë për shkak të mungesës së rampës në godinën e këtij institucioni dhe në institucionet në varësi të tij.

Dhjetor

- Takim me përfaqësuesen e shoqatës “Hapa të lehtë” me të cilën u diskutuan sektorët ku qytetarët hasin më shumë problematika diskriminuese.

Pjesëmarrje e Zyrës Rajonale Shkodër, në aktivitete institucionale

Janar

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Kryetari i Shoqatës për të drejtat e minoritetit Malazes në Shqipëri, në kuadër të ditës përkujtimore të 107 vjetorit të tragjedisë së mbytjes së anijes me 400 shtetas të Malit të Zi në afërsi të bregdetit të Shëngjinit.

Shkurt

- Pjesëmarrje në trajnimin online të organizuar nga NHRI, pjesë e sesioneve trajnuese vjetore të organizuara nga Departamenti i Kartës Sociale Evropiane për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI) dhe Organet Kombëtare të Barazisë, me qëllim forcimin e angazhimit të tyre me Komitetin Evropian të të Drejtave Sociale.
- Pjesëmarrje në workshopin me temë: “Hapja e bisedimeve për antarësimin në BE- Përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile në strukturat kryesore dhe fazat e procesit të negociatave”, e organizuar nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Shoqata “Gruaja tek gruaja” në bashkëpunim me Shërbimin e Ndihmës Juridike Parësore, me temë: “Fuqizimi i grave si përfituese të të drejtave dhe mbështetja e tyre për akses në drejtësi”.
- Takim i organizuar nga shoqata “Projekti Shpresa” në qytetin e Shkodrës me temë: “Drejtësia Sociale”. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i shqetësimeve të personave me aftësi të kufizuara dhe çfarë mund të bëjnë institucionet për arritjen e drejtësisë sociale për të gjithë.

Mars

- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Sot flet Rozafa”, organizuar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas nga Bashkia Shkodër dhe Prefektura e Qarkut Shkodër në bashkëpunim me organizatat që mbrojnë të drejtat e grave në qytetin e Shkodrës.
- Webinar online me temë: “Gjuha e urrejtjes-Parandalimi i ndikimit në institucionet publike”, organizuar nga ASPA.

Prill

- Takim i organizuar nga Shoqata "OMSA" në bashkëpunim me Solidarity Center dhe Sindikatat e Punës në qytetin e Shkodrës, në kuadër të "Planit Kombëtar të Veprimit të Personave LGBTI+, 2021-2027", lidhur me objektivin specifik për zvogëlimin e barrierave që i mbajnë antarët e këtij komuniteti larg tregut të punës.
- Takimi organizuar nga Caritas, me temë: "Komunikimi i aksesueshëm dhe shërbimet sociale për familjet në nevojë në qytetin e Shkodrës".

Maj

- Specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në Shkodër. Takimi ishte i organizuar në formën e një dite të hapur ku morën pjesë OJF të ndryshme dhe qytetarë për të paraqitur problematikat e tyre.

Qershor

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Shoqata "Intelektualët e Rinj Shpresë" me temë: "Trauma kolektive".
- Tryezë e rrumbullakët organizuar nga shoqata "Të ndryshëm&Të barabartë", në kuadër të projektit të Ministrisë së Drejtësisë: "*Rritja e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit dhe individë të tjerë vulnerabël nëpërmjet fuqizimit të profesionistëve të ligjit dhe avokatisë "pro bono", mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD).*

Korrik

- Pjesëmarrje në Konferencën Finale të projektit "Drejt një shoqërie të barabartë në Shqipërinë e Veriut" organizuar nga qendra e gruas "Hapa të Lehtë", me synim adresim më të mirë të problematikave që shqetësojnë shoqërinë dhe komunitetet në atë zonë.

Shtator

- Takim i organizuar nga Zyra e KMD-së në Tiranë për të folur mbi "Procedurën e ankimimit pranë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi", me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.

Tetor

- Pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga shoqata "Të ndryshëm&Të barabartë", me temë: "*Rritja e kapaciteteve të avoketëve dhe juristëve për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e krimit*".
- Pjesëmarrëse në aktivitetin socio-artistike shoqatës "Projekti Shpresa": "Unë të shoh, të dëgjoj dhe të mbështes", realizuar në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, i mbështetur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia Shkodër.
- Workshop-in i organizuar nga shoqata "Gruaja tek gruaja" për të diskutuar mbi pengesat e hasura në qasjen sistemike për menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë

gjinore me synim forcimin e Mekanizmit të Referimit të Rasteve të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave.

- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Thyerja e pengesave ndaj drejtësisë gjithëpërfshirëse”, organizuar nga UNDP në qytetin e Shkodrës, në kuadër të Javës Kulturore të Kombeve të Bashkuara.
- Pjesëmarrje në takimin për prezantimin e raportit për monitorimin e Kontratës Sociale, organizuar nga shoqata “Intelektualët e Rinjë Shpresë” në kuadër të projektit “POP”.

Nëntor

- Aktivitet me temë: “Foto Za”, organizuar nga shoqata “Gruaja tek Gruaja” në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, në kuadër të hapjes së fushatës kundër dhunës ndaj grave.

Dhjetor

- Aktivitet me temë: “Letërsia feministe”, organizuar nga shoqata “Gruaja tek gruaja” në bashkëpunim me Bibliotekën “Marin Barleti” në qytetin e Shkodrës, në kuadër të “16 ditë aktivizmi kundër dhunës ndaj grave”.
- Trajnimi u organizua nga Partners Albania me temë “Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve digitale për bashkëpunim dhe komunikim efektiv”, me qëllim zhvillimin e njohurive dhe aftësive praktike për përdorimin e platformave dhe programeve kompjuterike në punën e përditshme të OJF-ve dhe institucioneve.
- Takimi i organizuar nga Zyra e Avokatit të Popullit për realizimin e studimit temë: “Ndikimi i digitalizimit të shërbimeve nga institucionet shtetërore dhe ndikimi në shtresat e ndryhme të shoqërisë”.
- Pjesëmarrje në aktivitetin informues dhe ndërgjegjësues përmes artit me temë: “Ti nuk je vetëm”, organizuar nga gjimnazi “28 Nëntori” në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Save the Children.


Pasqyrim në media

Gjatë vitit 2023 mediat lokale “Star Plus TV” dhe “TV Kopluku” kanë pasqyruar aktivitet e organizuara nga Zyra Rajonale e KMD në Shkodër, si në kuadër të “Javës kundër diskriminimit” në Bashkinë Malësi e Madhe, ashtu edhe aktivitetet e tjera në kuadër të projekteve me mbështetjen e Këshillit të Evropës.

3. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier

Zyra Rajonale Fier ka pritur çdo ditë qytetarë të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me problematikat dhe diskriminimin që ata hasin kryesisht në fushën e marrjes së shërbimeve. Gjatë vitit 2023:

- 23 (njëzet e tre) ankesa janë përcjellë për regjistrim në DPA.
- 17 (shtatëmbëdhjetë) ankesa drejtuar Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas në Fier;
- 2 (dy) ankesa drejtuar Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas në Vlorë.
- 15 (pesëmbëdhjetë) ankesa drejtuar përfaqësueses së Avokatit të Popullit në Vlorë;



Grafiku 34: Veprimtari të Zyrës Rajonale Fier

Gjatë vitit 2023 specialisti i Zyrës Rajonale Fier ka informuar/këshilluar dhe referuar në zyrat përkatëse 59 (pesëdhjetë e shtatë) qytetarë për problematikat si më poshtë:

- 1) Ndërmjetësime nga të cilat 1 në fushën e punësimit (rikthim në punë)
- 2) Në fushën e të mirave dhe shërbimeve (marrja në kohë e detyrimit të përfituar nga kempit).
- 3) Konsulencë ligjore në lidhje me aplikimin si punëkërkuese e papunë për të përfituar nga skema e banesave sociale.
- 4) Konsulencë dhe informacion në lidhje me hapsirën ligjore për pagesë me këste të detyrimeve shëndetsore në biznesin privat.
- 5) Hartim shkresë për pranimin në shtëpinë e të moshuarve në Poliçan sipas VKM. nr 518, datë 04.09.2018.
- 6) Konsulencë mbi marrjen e tokës në pronësi (ligji 7501).
- 7) Përpilimin shkresë drejtuar Njësisë Administrative Topojë për përfitimin e pronës së hequr nga pronësia.
- 8) Përpilim shkresë për informacion drejtuar AKBN (Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore).
- 9) Asistim në nxjerrjen e dokumentacioneve të mara elektronikisht për të vijuar më tej në ndjekjen e problemit pranë gjykatës.
- 10) Përpilim shkresë drejtuar ISSH Fier për mosekzekutim të vendimit të Kempit Epror.

- 11) Informacion për marrjen e dokumentit të çertifikatës së martesës të vitit 1984.
- 12) Përpilim shkresë drejtuar prokurorisë për të takuar bashkëshortin në IEVP Fier.
- 13) Përpilim shkresë drejtuar Bashkisë Fier në lidhje për problematikën e një qytetari.
- 14) Përpilim shkresë drejtuar Reifjesien Bank në Patos në lidhje me rastin e një qytetari për mbajtjen e pensionit.
- 15) Konsulencë ligjore dhe orientim për zgjidhje nëpërmjet gjykatës për mospagesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e kompanise që e kishte punësuar.
- 16) Orientuar një qytetar për marrje informacioni në lidhje me përfitimin e KEMP-it, t'i drejtohet njësisë administrative ku banonte.
- 17) Orientuar një qytetar t'i drejtohej Gjykatës Administrative në Lushnje në lidhje me një proces gjyqësor me përmbarrimin të hapur pa dijeninë e tij.
- 18) Intepretim i kontratave hipotekore dhe veprimeve bankare.
- 19) Intepretim i vendimit të gjykatës dhënë mbi ankimimin ndaj vendimit të KMD-së.
- 20) Përpilim shkresë drejtuar UK sh.a Fier në lidhje me ankesën e një qytetari për mbifaturim.
- 21) Konsulencë në lidhje me marrjen e çertifikatës së pronësisë si dhe aplikimin pranë ASHK-së.
- 22) Përpilim shkresë drejtuar Yura Corporation Albania Fier në lidhje me problematikën e një qytetari.
- 23) Përpilim shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave, Tarifrave Vendore dhe Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fier, në lidhje me kërkesë informacioni për disa detyrime dhe taksa të paspecifikuara në ngarkim të një qytetari.
- 24) Konsulencë ligjore për rivlerësim të masës së pensionit duke ngritur një padi administrative ne gjykatë.
- 25) Interpretim i vendimit gjyqësor për një qytetar.
- 26) Intepretim i kontratës së punës një qytetari.
- 27) Informacion në lidhje me sigurimet shëndetsore si dhe asistim në shkarkimin elektronik të disa dokumentave hipotekore.
- 28) Informacion dhe konsulencë në lidhje me një gjobë të vendosur nga taksat vendore të Bashkisë Dimal.
- 29) Shqyrtim i dokumentacionit për daljen në komision për përfitim KEMPI.
- 30) Asistuar në aplikimin elektronik për gjëndjen juridike të pasurisë.
- 31) Përpilim shkresë dërguar postës shqiptare në lidhje me tërheqjen e KEMP-it.
- 32) Orientuar për të zgjidhur në rrugë gjyqësore korigjimi i datës së lindjes në dëftesën e shkollës 8 vjeçare.
- 33) Konsulencë ligjore mbi procedurën e çeljes së trashëgimisë dhe regjimit pasuror.
- 34) Interpretim i vendimit të KMD-së një ankuesi.
- 35) Konsulencë qytetares në lidhje me kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe derdhjes së kontributit vullnetar.
- 36) U ndërmjetësua një qytetar për të tërhequr KEMP-in pranë postës Njësia Administrative Seman, fshati Topojë.

- 37) Asistencë ligjore në lidhje me vitet e munguara për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Orientuar për të bërë ankimim pranë KQA (Komisioni qendror i ankimit) ose t'i drejtohet Gjykatës Administrative të shkallës së parë.
- 38) Konsulencë në lidhje me marrëdhien e punës (leja e zakonshme) bazuar në Kodin e Punës dhe VKM-të përkatëse.
- 39) Konsulencë në lidhje me pagesën e raportit sipas nenit 132 të Kodit të Punës (përkujdesje për femijë).
- 40) Konsulencë në lidhje me njohjen e pronës, kompensimin financiar dhe fizik nga ana e inspektorëve përkatës të ATP-së.
- 41) Informacion në lidhje me vërtetimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- 42) Konsulencë juridike në lidhje me njohjen e viteve të pensionit.
- 43) Përpilim shkresë drejtuar prokurorisë në lidhje me pajisjen e një akt-ekspertimi mjeko-ligjor për djalin e saj të ndjerë.
- 44) Kërkuar informacion Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror mbi refuzimin e njohjes së vendimit të KMCAP epror të një qytetari.
- 45) Asistuar në përpilim shkresë drejtuar Bashkisë, në lidhje me një problematikë me Ujësjellës-Kanalizime në Fier.
- 46) Referuar pranë AP në Vlorë një qytetar të cilit me vendim gjykate i ishte hequr zotësia juridike për të vepruar dhe nuk i ishte caktuar kujdestar.
- 47) Informacion mbi përfitimin e kujdestarisë ligjore si dhe për përfitim të ndihmës ekonomike.
- 48) Asistuar një qytetare në përpilim shkresë drejtuar Bashkisë, për zgjidhjen e problematikës me Ujësjellës-Kanalizime në Fier.
- 49) Orientuar të ndjek në rrugë gjyqësore një qytetar problematikën e mosnjohjes të viteve të pensionit.
- 50) Interpretim i nenit 33 i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Udhëzimi nr. 2 i ISSH-së, datë 05.10.2005, "Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar dhe pagës neto për efekt pensioni.
- 51) Asistuar në përpilim shkresë një qytetare drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile Tepelenë për lëshim certifikatë të trungut familjar të vitit 1991.
- 52) Informacion në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për banesë sociale.
- 53) Konsulencë juridike në lidhje me një masë disiplinore të marrë nga kompania ku punonte qytetari, interpretim të nenit 37 të Kodit të Punës dhe të afateve ligjore të përcaktuara.
- 54) Përpilim shkresë drejtuar Zyrës së ASHK dhe DRSHTR Fier.
- 55) Asistuar në përpilim shkresë një qytetare, drejtuar Drejtorisë së Tatimeve Fier.
- 56) Informacion mbi procedurën e kujdestarisë së nënës.
- 57) Orientim një qytetare pranë NJMF-së, Bashkia Fier, për të marrë informacion në lidhje me refuzimin nga Qendra e Përkujdesjes së Fëmijës Elbasan, për të takuar vëllëezërit.
- 58) Informacion në lidhje me zbardhjen e viteve të humbura të pensionit.

59) Referuar dy gazetarë të TV Klan të cilët kërkuan informacion në lidhje me një qytetarë me status e dhunuar, pranë koordinatores së Mbrojtjes së Dhunës ndaj Grave pranë Bashkisë Fier.

Gjatë vitit 2023 janë kryer veprimtari në kuadër të punës së përditshme, konkretisht:

- Pritje qytetarësh çdo ditë, dhënie informacioni, asistim në plotësimin e formularit të ankesës në të gjitha rubrikat përkatëse, orientim për dokumentacionin e nevojshëm, interpretime të vendimevetë KMD-së, interpretime shkresash të ndryshme apo asistim në hartim shkresash drejtuar institucioneve përkatëse në lidhje me problematikën e qytetarit etj.
- Mbajtur kontakt i vazhdueshëm me ankuesit në çdo fazë të hetimit administrativ dhe jo vetëm.
- Mbajtur kontakt i vazhdueshëm me OJF dhe institucione të pushtetit vendor për pjesëmarrje në aktivitete, po ashtu kontakt i vazhdueshëm me Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në Vlorë, Berat dhe Sarandë si edhe me Ndihmën Juridike Parësore Falas në Fier, Lushnje, Berat, këto në kuadër të bashkëpunimit për pjesëmarrje në aktivitete apo referim rastesh.
- Shkëmbyer emalie pune me drejtorinë apo inspektorë në kuadër të detyrave të përcaktuara apo marrje dhe dhënie informacioni në varësi të rasteve.
- Pjese e detyrave të specialistit ka qënë dhe përgatitja e raporteve të ndryshme sipas kërkesave të institucionit që e ka kërkuar.
- Pritur telefonata nga publiku për informim në lidhje me procedurën e ankesës, si dhe çështje që lidhen me diskriminimin.
- Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik, promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim realizuar këto në formën e ditëve të hapura.

Aktivite të organizuara nga Zyra Rajonale Fier

Janar

- Takim në zyrë me punonjës të Policisë Fier, specialistë dhe psikologë, ku u dha informacion mbi natyrën e ankesave që trajtohen nga Komisioneri si dhe informacion në lidhje me shkresën ardhur nga KMD, për procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes për identifikimin e problematikave me të cilat përballen personat PAK në shërbimet e ofruara nga Policia Fier.

Shkurt

- Takim pune me administratorin e Njesisë Administrative Qendër me qëllim ndërmjetësimi në fushën e shërbimeve.
- Java kundër diskriminimit"-Aktivitet i organizuar në gjimnazin "Jani Nushi" në Lushnje, me pjesëmarrjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Mars

- Takim me Prefektin e Qarkut Fier në kuadër të bashkëpunimit institucional, për të qënë pjesë e aktiviteteve si dhe referim të rasteve që kanë nevojë për asistim ligjor apo mbrojtje nga diskriminimi.

- Takim me specialisten e Drejtorisë së Projekteve për të realizuar në bashkëpunim një aktivitet në kuadër të javës së BE-së.

Prill

- Takim pune me juristen e ISSH Fier.
- Takim pune me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Berat, me qëllim njohje dhe organizimi aktivitetesh të përbashkëta si dhe referim rastesh.
- Takim pune me përfaqësuesen e organizatës "Mbrojtja e të Drejtave të Grave", me qëllim trajtimi të rasteve dhe pjesëmarrjen në aktivitete.

Maj

- Aktivitet me të miturit si një prej kategorive të veçanta përfituese referuar ligjit 111/2017, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me Ndihmën Juridike Falas, në shkollën 9 vjeçare "Naim Frashëri".
- Takim pune dhe ditë të hapur në qytetin e Vlorës me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit (AP) në Vlorë. Në zyrën e Ap Vlorë u pritën qytetarë të cilët morën informacion mbi ligjin dhe kompetencat e KMD-së si dhe u trajtuan problematika e u morën ankesa.
- Në kuadër të ditës ndërkombëtare të homofobisë, transfobisë dhe bifobisë, u organizua një ditë e hapur informuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Integritimit Evropian, Hartimi i Projekteve të Huaja dhe Vendase të Diasporës, Bashkia Fier, si dhe shpërndarje publikimesh të KMD-së, në komunitet.

Qershor

- Në kuadër të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me Qendrën Juridike Falas u realizua një aktivitetit për personat me aftësi ndryshe në
- ambjentete Qendrës Multifunkionale Horizont, Bashkia Fier.

Korrik

- Aktivitet me fokus personat të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminim, në bashkëpunim me Qendrën Juridike Falas, me pjesëmarrjen e ankuesve të cilët kanë ngrit pretendim diskriminimi dhe janë ende në proces të hetimit administrativ të KMD-së.
- Takim pune me drejtorin egzekutiv të TIRC me qëllim bashkëpunimi për realizimin e një aktiviteti në zonat komunitare Seman dhe Mbrostar.
- Tryezë në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimi për personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, në bashkëpunim me Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Fier, përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Qendrës së Fëmijeve me Aftësi Ndryshe në Bashkinë Fier.

Gusht

- "Ditë të hapur" në ambjentet e zyrës me komunitetin rom ku u prezantua Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku dhe si të ankohen si dhe u shpjeguan rubrikat e formularit të ankesës.

Shtator

- Takimi pune online i Drejtorisë së Pritjes së Ankesave me Zyrat Rajonale.
- Aktivitet me temë: “Sesion informues për dhunën në familje dhe trafikimi”, me nxënës të shkollës 9-vjeçare jopublike “Flatrat e Dijes”, në bashkëpunim me Qendrën Juridike Falas.

Tetor

- Takim pune me punonjësen sociale të shkollës 9 vjeçare publike “Kristaq Shtëmbari” me qëllim dhe kërkesë nga ana e saj për realizimin e një prezantimi me temë “Drejtësia Penale për të mitur”, me qëllim njohjen e nxënësve në kuadrin dhe interpretimin ligjor jo vetëm të të drejtave por dhe detyrimeve.
- Takim pune në ambjentet e zyrës me Shërbimin e Provës Fier në kuadër bashkëpunimi, për personat nën mbikqyrje kryesisht të miturit në konflikt me ligjin, për të pasur një mbrojtës ligjor falas duke ndihmuar dhe në riintegrimin e tyre shoqëror. Gjithashtu Shërbimi Provës u njoh me Institucionin e KMD-së, kompetencat ligjore si dhe roli i Zyrës Rajonale, si dhe u diskutua për zbatimin e nenit 11 "Parimi i Mbrojtjes nga Diskriminimi" i Ligjit Nr.37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.
- Takim pune në ambjentet e zyrës me përfaqësuese të OSBE-së, në formën e diskutimit për veprimtarinë e Zyrës Rajonale, natyra e çështjeve të spikatura, prevalenca e shkakut ligjor në ankesa, një statistikë ankesash të trajtura nga Zyra rajonale, problematikat e hasura gjatë punës etj.

Dhjetor

- Intervistë në kuadër të projektit “Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në Digjitalizimin e Shërbimeve Publike në Shqipëri-SERVRIGHT”, me ekspertin nga Avokati i Popullit, me synim identifikimi të problematikës së hasur në marrjen e shërbimeve online.
- Takim pune me psikologë ligjor mbi procedurën e ankimimit, përcaktimin e shkakut ligjor dhe mbështetjen me dokumenta provues.

Pjesëmarrje e Zyrës Rajonale Fier, në aktivitete institucionale

Janar

- Pjesëmarrje në ëwebinarin me temë: “Ndihma juridike falas”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Kuatri Ndërkombëtar i Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm”, organizuar nga ASPA.

Prill

- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga Sektori i Qendrave Social-komunitare, Bashkia Roskovec, në kuadër të 8 Prillit “Ditës Ndërkombëtare të Romëve”, për të promovuar traditat dhe kulturën e këtij komuniteti.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Organizata Open Mind Spectrum Albania (OMSA) në bashkëpunim me Solidarity Center dhe Sindikatat e Punës, për të drejtat e personave LGBT+ në qytetin e Beratit.

- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Hapësira administrative Europiane dhe impakti i saj në administratë", organizuar nga ASPA.

Maj

- Pjesëmarrje në aktivitetin sensibilizues të organizuar nga Prefektura Fier në bashkëpunim me DRAP Fier dhe Nxënës të shkollave të qarkut Fier, në kuadër të Projektit "Universi jemi ne".
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkinë Fier me temë: "Aksesi në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i sigurisë së viktimave të dhunës në familje, në kuadrin e hartës së re gjyqësore dhe riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave".
- Pjesëmarrje në një takim të hapur rreth çështjeve aktuale të shkeljes së të drejtave të njeriut në Vlorë, organizuar nga Avokati i Popullit me Ndihmës- Komisionerët e Avokatit të Popullit dhe pëfaqësuesja e zyrës lokale të avokatit të Popullit, në Vlorë.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: "Parimi i barazisë, mosdiskriminimit dhe krimet e urrejtes.", organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Antixhipsizmi - Diskriminim i akumuluar kundrejt Romëve dhe Egjiptianve", organizuar nga ASPA.

Qershor

- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përafrimi me Direktivat e BE-së", organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: "Bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve vendore për zbatimin e legjislacionit dhe politikave për aksesin në drejtësi dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore", organizuar nga Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale "Vatra", në Vlorë, në kuadër të projektit: "Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe përmirësimi i shërbimeve ligjore për to".
- Tryezë diskutimi me gratë e një fasonerie në Fier, të cilat nuk e kishin marrë pagën për dy muaj, inicuar nga *Gender Alliance for Development Centre (GADC)* me pjesëmarrjen e Avokatit të Drejtësi Sociale, juristë të Koalicionit për të Drejtat në Punë, inspektorë të Inspektoriatit të Punës.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Proçedura e Ankimimit në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi", organizuar nga ASPA.

Korrik

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga shoqata Rromano Kham me synim njohjen e qytetarëve të komunitetit rom me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si edhe të Avokatit të Popullit dhe ngritjen e urave të bashkëpunimit midis qytetarëve romë dhe institucioneve.

Tetor

- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Njohja me institucionet komunitare dhe me pushtetin vendimarrës të Bashkimit Evropian”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Antixhopsizmi-diskriminim i akumuluar kundrejt romëve dhe egjiptianëve”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet përparësitë e normave juridike”, organizuar nga ASPA.

Nëntor

- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Buxheti gjinor për pakicat romë dhe egjiptiane-Reflektimi në nivel vendor”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Nocioni i Diskriminimit në Administratën Publike”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Vlerësimi i punës në zbatim të ligjit për shërbimin civil", organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Buxheti i përgjigjshëm gjinor në nivel vendor", organizuar nga ASPA.

Dhjetor

- Pjesëmarrje në marshimin sensibilizues në kuadër të fushatës "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, me pjesëmarrjen e Bashkisë Fier, Policisë dhe Shoqërisë Civile nën moton "Investo për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave".
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: "Barra e provës në rastet e diskriminimit në administratën publike", organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në webinarin me temë: “Barazia gjinore në vendimmarrje”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në takim sensibilizues në shkollën "Rakip Kryeziu", ku u realizua shpërndarja e LMD-së si dhe pati diskutime të lira për dhunën me bazë gjinore, organizuar nga Ndihma Juridike Falas në bashkëpunim me DAR, Bashkia Fier dhe Drejtoria e Policisë.

Pasqyrim në media

Gjatë vitit 2023 mediat lokale kanë pasqyruar aktivitetet e organizuara nga Zyra Rajonale e KMD në Fier, si në kuadër të “Javës kundër diskriminimit” në Bashkinë Lushnje, ashtu edhe aktivitetet e tjera në kuadër të projekteve me mbështetjen e Këshillit të Evropës.

VI. ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2023

- I. Janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve për vitin 2023, si dhe janë dorëzuar pranë ILDKPKI- së deklaratat e pasurive të subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit sipas parashikimeve ligjore për vitin 2022.
- II. Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara me anë të webinarëve nga, Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike (ASPA) dhe institucione të tjera.
- III. Në trajnimin e organizuar me webinar nga ASPA dhe institucione të tjera janë trajtuar tema si:
 - Kodi i Procedurave Administrative;
 - Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit;
 - Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
 - Planifikimi Buxhetor dhe Pasqyrat Financiare;
 - Mbrojtja nga diskriminimi i pakicave rome dhe egjiptiane;
 - Legjislacioni migrator/ të drejtat e komunitëve shqiptare në diasporë;
 - Hartimi dhe menaxhimi i projekteve;
 - Risit e plotësimit të deklaratës periodike vjetore për subjektet në funksion në sistemin elektronik;
 - Masat disiplinore në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;
 - Prokurimi Publik;
 - Siguria kibernetike;
 - Barazia gjinore në vendim-marrje/kuotat gjinore;
 - Diskriminimi dhe barra e proves në administratën publike.
- IV. Punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikat më të mira si dhe në aktivitete të ndryshme të organizuara në fushën e të drejtave të njeriut/diskriminimit me tema:
 - Padia kolektive dhe format e reja të diskriminimit;
 - Prezantimi i të rinjëve me aftësi të kufizuara me Drejtësinë Sociale;
 - Të rinjtë për gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;
 - Përgatitja e PBA 2023-2025 sipas buxhetimit të përgjithshëm gjinor;
 - Planet Sociale Vendore;
 - Parimi i Barazisë dhe Kontrata Sociale;
 - Kuadri ligjor, standartet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare e ndërkombëtare lidhur me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin e ndërveprimin e institucioneve inspektuese/monitoruese;

- Fenomeni i diskriminimit, dhunës e ngacmimit si çështje e sigurisë dhe shëndetit në punë;
 - Ndhima juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupet në nevojë;
- V. Punonjësit e Zyrës Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me tema:
- Të drejtat e punëtorëve LGBTI në Ballkanin Perëndimor.
 - Seminar EQUINET "Kornizat Strategjike Kombëtare të Romëve.
 - Mbrojtja nga diskriminimi për personat me aftësi të kufizuara.
 - Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe punësimi ".
 - Pjesëmarrje në Konferencën me temë "Towards gender equality in Europe"
 - Pjesëmarrje në takim të grupit të punës së EQUINET "Research & Data Collection", diskriminimi ndërsektorial dhe diskriminimi i shumëfishtë .
 - Konferencë me temë : " Së bashku në një bilanc vjetor të arritjeve dhe përvojave në lidhje me reduktimin dhe eliminimin e diskriminimit, dhunës e ngacmimit në botën e punës në kuadër të bashkëpunimit mes KMD-së dhe ISHPSHSH-së.
 - Tryezë vjetore me rastin e ditës së të drejtave të njeriut, organizuar nga OSCE.

2. Menaxhimi i burimeve financiare 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në zbatimin të buxhetit të vitit 2023, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar , të ligjit "Për Buxhetin e vitit 2023", ndryshuar, në vijim Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", ndryshuar.

Programi "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjeve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në zbatim të Ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2023, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar në total një fond prej 67.523,48 (në mijë lekë) për vitin 2023. Totali i vlerës së akorduar përbëhet nga:

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore:	51. 930 mijë lekë (zëri 600-601)
Fondi për Shpenzime Operative:	12. 250 mijë lekë (zëri 602-606)
Fondi për Investime:	1. 000 mijë lekë (zëri 231)
Fondi i donatorëve:	2. 343, 48 mijë lekë (zëri 602)

Nga fondi i planifikuar për 12-mujorin që është 67.523,48 (në mijë lekë), për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore 65.784,00 në mijë lekë ose 97,42 % të buxhetit të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndryshuar, numri mesatar i punonjësve është realizuar 34 nëpunës, nga 34 të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej 51.930 (në mijë lekë) për këtë periudh, është realizuar 51.220,03 (në mijë lekë) për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose 98,63 % e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2023, është planifikuar në vlerën 12.250 në mijë lekë. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej 11.535,07 (në mijë lekë) ose 94,16 %, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej 1.000 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar, është realizuar vlera prej 690,00 (në mijë lekë) ose 69,00 %, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi i Donacioneve (zëri 602); për vitin 2023, është në vlerën 2.343,48 (në mijë lekë). Për periudhën respektive është realizuar në projektin me UNDP, vlera prej 2.338,90 (në mijë lekë) ose 99.80 %, e fondit të planifikuar.